



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 220

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 26 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 129/2024, datë 19.12.2024	Për disa ndryshime në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”..... 25487
Dekret i Presidentit nr. 429, datë 26.12.2024	Për shpallje ligji..... 25487
Dekret i Presidentit nr. 405, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25488
Dekret i Presidentit nr. 406, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25488
Dekret i Presidentit nr. 407, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25488
Dekret i Presidentit nr. 408, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25488
Dekret i Presidentit nr. 409, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25489
Dekret i Presidentit nr. 410, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25489
Dekret i Presidentit nr. 411, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25489
Dekret i Presidentit nr. 412, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25490
Dekret i Presidentit nr. 413, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25490

Dekret i Presidentit nr. 414, datë 18.12.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	25490
Dekret i Presidentit nr. 415, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25491
Dekret i Presidentit nr. 416, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25491
Dekret i Presidentit nr. 417, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25491
Dekret i Presidentit nr. 418, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25491
Dekret i Presidentit nr. 419, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25492
Dekret i Presidentit nr. 420, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25492
Dekret i Presidentit nr. 421, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25492
Dekret i Presidentit nr. 422, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25493
Dekret i Presidentit nr. 423, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25493
Dekret i Presidentit nr. 424, datë 18.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	25493
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 13, datë 18.12.2024	Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024.....	25494
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 306, datë 6.12.2024	Për miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”	25499
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 644, datë 19.12.2024	Për delegim kompetence.....	25532
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1083, datë 12.12.2024	Për miratimin e modelit të vulës së mjekëve veterinarë, të cilët ushtrojnë profesionin në sektorin veterinar privat.....	25532

Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-5688 (409), datë 23.11.2023	Me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, urdhër të detyrueshëm, vendim për dënim me gjobë nr. 32, datë 17.12.2014, gjobë në masën 500.000 lekë. Kundërshtimin e veprimit përmbarimor nr. 271 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”. Kundërshtimin e veprimit përmbarimor nr. 272 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”. Kundërshtimin e veprimit përmbarimor nr. 273 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe avokatore.	25533
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 28.10.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “Albania Power Core” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	25552
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 228, datë 28.10.2024	Mbi fillimin e procedurës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SLR Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	25554
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 229, datë 28.10.2024	Mbi fillimin e procedurës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”.....	25555
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 230, datë 28.10.2024	Mbi kërkesën e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Stavec”	25556
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 247, datë 18.11.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit të investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025–2027	25558
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 248, datë 18.11.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	25560
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 6492, datë 22.10.2024	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Deda.....	25561

**LIGJ**
Nr. 129/2024**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN**
NR. 81/2020, “PËR TË DREJTAT DHE
TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME
BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4 togfjalëshi “legjislacioni për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore në zbatim të tij” zëvendësohet me togfjalëshin “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve dhe punonjësve mbështetës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë. Kriteret dhe procedurat për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve mbështetës përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe rregulloret e brendshme të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Niveli i pagave të nëpunësve dhe punonjësve mbështetës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike,

si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar.

Neni 2
Dispozitë kalimtare

Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, marrëdhëniet e punës së të cilëve aktualisht rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil, vijojnë marrëdhënien e tyre të punës sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.12.2024.

Shpallur me dekretin nr. 429, datë 26.12.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 429, datë 26.12.2024**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 129/2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat e trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 405, datë 18.12.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Klodiana Jorgo Beleri
2. Klevis Pajtim Elmazaj
3. Neraida Roland Çene

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 406, datë 18.12.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ludmilla Fatos Ormenaj
2. Admir Myzafer Begaj
3. Vidosava Marjan Zllatiçanin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 407, datë 18.12.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Juliana Bardhyl Syknej (Lipo)
2. Fatjona Pellumb Topçiu
3. Uzri Avni Halili
4. Verona Zef Bardhoku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 408, datë 18.12.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Belina Bektash Aliaj
2. Manjola Zyber Prifti (Shkurti)
3. Valbona Hamdi Köberl (Gjokola)
4. Marie Idris Simoni (Ismailaj)
5. Artan Zote Zejno

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 409, datë 18.12.2024

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Erla Astrit Leka
2. Denada Ymer Bimi
3. Katerina Theodhor Bifsha
4. Imenda Ilia Dishnica
5. Ndrek Eduard Geci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 410, datë 18.12.2024

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Klaudia Simon Velu
2. Olger Asllan Ahmetaj
3. Sarah Skënder Kögl (Kadiu)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 411, datë 18.12.2024

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Erisa Gëzim Sala



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 412, datë 18.12.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Valentina Llesh Tarazhi (Lleshi)
2. Stanko Savo Ajković
3. Elida Riza Hasa
4. Erisa Shaban Sina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 413, datë 18.12.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Xhoi Artan Wegener (Osmani)
2. Spiro Gligor Matanoviç (Mejtoja)
3. Taulant Esat Disha
4. Gerta Bani Velo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 414, datë 18.12.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Artenisa Myfit Meçollari (Sino)
2. Amarildo Elvis Meçollari
3. Helios Elvis Meçollari
4. Elvis Pëllump Meçollari
5. Nöman Muzaffer Gülen

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 415, datë 18.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Aleksander Alush Durmishi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 416, datë 18.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ramadan Rufat Hoxhaj
2. Arlind Beqë Rexha
3. Blendi Agim Kokollari
4. Naile Qamil Prekazi (Bunjaku)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 417, datë 18.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Şeydanur Faruk Saat

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 418, datë 18.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Kibret Tesfamariam Tewelde

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 419, datë 18.12.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Adelina Ibrahim Hasmeta (Morina)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 420, datë 18.12.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Vlora Nysret Bllaca Ejupi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 421, datë 18.12.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Edona Pajazit Gjonbalaj (Tahiri)



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 422, datë 18.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fetije Bashkim Hoxhaj
2. Jon Ramadan Hoxhaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 423, datë 18.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Klajdi Kolë Gjoka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 424, datë 18.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Zaim Suat Resulaj
2. Mirela Ded Gjoka (Vuçaj/Vuçaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



UDHËZIM

Nr. 13, datë 18.12.2024

**PËR PROCEDURAT E MBYLLJES SË
LLOGARIVE VJETORE TË BUXHETIT
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 62, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1 e nenit 6 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. PËRMBAJTJA DHE PUBLIKIMI I PASQYRËS FINANCIARE VJETORE TË KONSOLIDUAR TË SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME:

1. Për llogari të buxhetit të shtetit të vitit 2024, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen:

a) të gjitha të ardhurat e arkëtuara, të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (në vijim “SIFQ”) nga data 1.1.2024 deri më 31.12.2024;

b) të gjitha shpenzimet publike (përfshirë edhe shpenzimet nga kreditë e nënhuazuara të raportuara nga njësitë e zbatimit të projekteve të financimit të huaj, disbursimi i të cilave është konfirmuar nga struktura përgjegjëse për borxhin publik) të ndodhura (të dokumentuara) nga data 1.1.2024 deri më 31.12.2024 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2024, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave;

c) në aneks të veçantë të raportohen të dhënat e detajuara sipas klasifikimit ekonomik (llogaritë ekonomike 600, 601, 602 etj.) të shpenzimeve kapitale me financim të huaj (llogaria ekonomike 230), të cilat raportohen në total kundrejt planit të buxhetit të treguesve fiskalë të konsoliduar, të regjistruar në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ);

d) në aneks të veçantë të raportohen të dhënat e detajuara për shpenzimet dhe pagesat e detyrimeve të prapambetura sipas treguesve fiskalë të konsoliduar.

2. Për llogari të buxhetit të shtetit 2024, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, në seksionin e financimit të deficitit fiskal përfshihen të gjitha transaksionet e regjistruara në SIFQ si më poshtë:

a) të gjitha të ardhurat e arkëtuara nga shitja/privatizimi i aktiveve afatgjata publike gjatë vitit 2024;

b) të gjitha arkëtimet e lidhura me huamarrjen e huaj deri në fund të datës 31.12.2024;

c) të gjitha ripagesat e borxhit të jashtëm të kryera deri më datë 31.12.2024;

d) të gjitha pagesat e principalit për efekt të garancive sovraane apo garancive të tjera të brendshme të ndodhura deri më datë 31.12.2024;

e) ndryshimi i gjendjes së mjeteve monetare në llogaritë e çelura nga ministri përgjegjës për financat në Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë;

f) gjendja e likuiditeteve në udhëtim që figurojnë si të tilla në fund të datës 31.12.2024;

g) fitimi/humbja që rezulton nga transaksionet e këmbimit të mjeteve monetare ndërmjet nënlllogarive në monedhat LEK, EURO, USD dhe SDR të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë si dhe ato të zhvlerësimit/rivlerësimit periodik të gjendjes vjetore të mbartur (balanca e llogarive të planit kontabël 657, 767, 766 etj.) të raportohen në nënzërin “Balanca nga kursi i këmbimit” të zërit “Të tjera” të burimeve të brendshme të financimit të deficitit.

3. Për efekt të paraqitjes në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, fondet e planifikuara dhe të realizuara në kapitullin 08 për paga dhe sigurime, do të pasqyrohen në zërin “Shpenzime operative e mirëmbajtje”, sipas programeve dhe ministrive si më poshtë:

3.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit :

- Programi 09450 “Arsimi universitar”;

- Programi 09770 “Fonde për shkencën”.

3.2 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- Programi 07330 “Shërbimet e kujdesit dytësor”.

3.3 Akademia e Shkencave :

- Programi 01520 “Veprimtaria akademike”.

4. Për efekt të paraqitjes në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, fondet e planifikuara dhe



të realizuara për rindërtimin për qeverisjen qendrore dhe atë vendore, do të paraqiten në një zë të vetëm. (Fondi i Rindërtimit i ndarë për Grantet dhe për Shpenzimet e Rindërtimit).

5. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër harton të dhënat faktike përfundimtare të pasqyrës vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme brenda datës 17.2.2025.

6. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të njërive të qeverisjes së përgjithshme publikohet nga Ministria e Financave në muajin shkurt 2025.

7. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme e shoqëruar me raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2024, performancës makrofikale, situatës së menaxhimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm si dhe auditimit të brendshëm i paraqitet Këshillit të Ministrave brenda muajit qershor të vitit 2025.

II. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE ME BANKAT E NIVELIT TË DYTË

1. Në zbatim të marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për financat, bankat e nivelit të dytë kryejnë arkëtime të fondeve publike për llogari të vitit 2024 deri në fund të vitit 2024. Bankat e nivelit të dytë transferojnë në Bankën e Shqipërisë brenda orës 10:00 të datës së parë të punës në muajin janar 2025, të gjitha mjetet monetare të arkëtuara për buxhetin e shtetit deri në fund të vitit 2024. Llogaritë e degëve të thesarit në bankat e nivelit të dytë do të fillojnë me gjendje zero në vitin 2025.

2. Degët e Thesarit përfundojnë rakordimin me bankat e nivelit të dytë dhe raportojnë elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 10.1.2025.

3. Korrigjimet që nuk kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, do të kryhen në SIFQ nga vetë degët e thesarit dhe degët e bankave të nivelit të dytë, pa konfirmim nga struktura e thesarit në qendër.

4. Përmbledhëset për korrigjimet, të cilat kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, krahas protokollit, paraqiten elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër deri më datën 20.1.2025 dhe kryhen nëpërmjet SIFQ me urdhër të ministrit të Financave. Informacioni elektronik shoqërohet me aktrakordin e skanuar

të mbajtur midis degës së thesarit dhe degës së bankës së nivelit të dytë.

5. Bankat e nivelit të dytë, para konfirmimit përfundimtar të rakordimit vjetor me strukturën përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë dhe me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, duhet të sqarojnë më parë mosrakordimet e mundshme me subjektet që operojnë dhe mënyrën e korrigjimit të tyre.

6. Drejtoritë qendrore të bankave të nivelit të dytë rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër, sipas formatit të dërguar nga kjo e fundit, brenda datës 20.1.2025.

III. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE ME BANKËN E SHQIPËRISË

1. Ministria e Financave urdhëron kryerjen e pagesave në Bankën e Shqipërisë deri në fund të sesionit të dytë të pagesave të datës 31.12.2024.

2. Llogaria “Depozitë e qeverisë” dhe të gjitha llogaritë speciale të ministrit të Financave në Bankën e Shqipërisë, në ditën e parë të punës të muajit janar të vitit 2025, mbartin tepicën e mbylljes së këtyre llogarive në fund të vitit.

3. Procesi zyrtar i rakordimit me Bankën e Shqipërisë për arkëtimet dhe pagesat e qeverisjes së përgjithshme të kryera për vitin 2024 fillon në ditën e parë të punës të muajit janar të vitit 2025. Më datë 24.1.2025 konfirmohet aktrakordimi paraprak dhe në datën 10.2.2025 konfirmohet aktrakordimi përfundimtar midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.

4. Struktura përgjegjëse për borxhin në Ministrinë e Financave përfundon regjistrimin në SIFQ të transaksioneve të borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm për vitin 2024, brenda datës 20.1.2025.

5. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër harton raportin përfundimtar të hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare “Depozitë e qeverisë”, për të cilën merr konfirmimin zyrtar nga Banka e Shqipërisë, brenda datës 10.2.2025.

IV. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE ME NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

1. Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes së përgjithshme paraqesin urdhërshpenzimet deri më 31.12.2024 për të vijuar në muajin janar të vitit 2025 në zbatim të nenit 52 “Kryerja e shpenzimeve” të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e



sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përveç rasteve për të cilat është miratuar afat specifik nga ministri përgjegjës për financat. Struktura përgjegjëse për thesarin në degë kryen kontrollet sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vlefshmërinë e fondeve dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda datës 31.12.2024 (fatura e operatorit ekonomik duhet të jetë gjeneruar brenda vitit 2024). Dokumentacioni i paraqitur në thesar pas datës 31.12.2024, ora 13:00 procesohet për pagesë gjatë muajit janar 2025.

2. Për transfertat e fondeve buxhetore me formën e pagesës letërkredi (LC) për kontrata të rëndësisë së veçantë (në zbatim të pikës 160 dhe 161 të udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar”), nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë e qeverisë” në llogarinë bankare të veçantë të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme në një nga bankat e nivelit të dytë, në treguesit fiskalë të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme përfshihet gjendja bankare e fundit të vitit në zërin “Të tjera” të burimeve të financimit të brendshëm të deficitit.

3. Dega e Thesarit Tiranë përfundon rakordimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe raporton në strukturën përgjegjëse të Thesarit pranë Ministrisë së Financave brenda datës 16.1.2025.

4. Njësitë e projekteve me financime të huaja, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dorëzojnë raportin përfundimtar të të ardhurave e shpenzimeve në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 16.1.2025.

5. Brenda datës 27.1.2025 përfundon paraqitja dhe regjistrimi në SIFQ i shpenzimeve të konstatuara në vitin 2024. Rakordimi përfundimtar për shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2024 midis njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe degëve të thesarit kryhet në momentin që çdo njësi shpenzuese/arkëtuese përfundon regjistrimet në SIFQ, deri në fund të muajit janar 2025, më 31 janar 2025 për gjenerimin e të dhënave paraprake të treguesve fiskalë të konsoliduar 2024. Gjatë procesit, rakordohet edhe statusi i ekzekutimit të angazhimeve (kontratave) dhe kryhet mbartja e tyre në vitet në vijim, duke respektuar udhëzimin e operacioneve ditore në SIFQ brenda muajit shkurt 2025, nëse janë

regjistruar të dhënat e planit buxhetor përkatës në SIFQ nga strukturat përgjegjëse.

6. Në rastet e konstatimeve të gabimeve të regjistrimeve në sistem të shkresave të ndryshimit të planit vjetor të buxhetit të shtetit të vitit 2024, degët e thesarit i raportojnë si të tilla në strukturën përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave dhe strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër, të cilat bëjnë korrigjimet përkatëse. Për çdo mospërputhje të këtyre planeve në nivel programi, projekti, kapitulli dhe llogari ekonomike, do të bëhen korrigjimet me strukturën përgjegjëse për buxhetin, e cila përgatit aktrakordin paraprak elektronik me njësitë e qeverisjes qendrore për planin përfundimtar të vitit 2024 deri në fund të muajit janar 2025.

7. Degët e thesarit për arkëtimet e vitit 2024, në favor të njësive të qeverisjes së përgjithshme (fonde të cilat në zbatim të legjislacionit përdoren nga njësia e qeverisjes së përgjithshme dhe trashëgohen në vitin 2025), mbartin tepicën e fondeve të papërdorura të të ardhurave të vitit 2024, në strukturat buxhetore përkatëse pas përfundimit të rakordimit vjetor, ndërsa mbartja pjesore e tepicës së fondeve disponibël mund të kryhet vetëm për pagesën e pagave (e shoqëruar me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale), si dhe transfertave me destinacion pagesën e pagave, ndihmave ekonomike, papunësisë dhe paafësisë.

8. Mbartja e fondit të grantit të arsimit të lartë të papërdorur gjatë vitit 2024, bëhet sipas procedurës si më poshtë:

a) Të gjitha institucionet e arsimit të lartë rakordojnë (duke mbajtur një aktrakordim) me degët e Thesarit lidhur me fondet e papërdorura gjatë vitit 2024 për grantin e arsimit të lartë përkatësisht në strukturat:

- Grupi 11, Programi 09450, kapitulli 08, artikujt 600, 601, 602, 604, 605 dhe 606.

- Grupi 11, Programi 09770, kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605 dhe 606.

b) Kërkesa zyrtare për mbajtjen e fondeve të papërdorura së bashku me një kopje të këtij aktrakordimi paraqitet pranë nëpunësit të parë autorizues për t'u mbartur si akordim plani në të njëjtën strukturë buxhetore në vitin pasardhës.

9. Fondet e akorduara për rindërtimin (korrente dhe kapitale) për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat rezultojnë të pashpenzuara në fund të vitit



buxhetor, trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim. Mbartja e këtyre fondeve bëhet sipas procedurës si më poshtë:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore rakordojnë me degët e thesarit lidhur me fondet e rindërtimit të papërdorura (korrente dhe kapitale), gjatë vitit 2024 në strukturat buxhetore përkatëse (kodi i produktit të lidhet vetëm me fondin e rindërtimit), duke mbajtur një aktrakordim;

b) një kopje të aktrakordimit të mbajtur me thesarin për fondet e papërdorura të rindërtimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore e dërgojnë në strukturën përgjegjëse për Buxhetin, në Ministrinë e Financave, brenda muajit janar të vitit 2025.

10. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër publikon paraprakisht të dhënat faktike të detajuara në nivel njësie shpenzuese sipas strukturës buxhetore në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë së Financave, brenda muajit janar të vitit 2025. Versioni përfundimtar i të dhënave publikohet pas dërgimit të projektbuxhetit faktik në Këshillin e Ministrave për miratim.

11. Struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave rakordon me njësitë e qeverisjes qendrore, planin e buxhetit të shtetit të vitit 2024 në nivel grupi, programi, produkti, kapitulli dhe artikulli, përfshi edhe limitin e përdorimit të të ardhurave të institucioneve buxhetore. Gjithashtu, njësitë e qeverisjes qendrore, duhet të raportojnë shumën e shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat jashtë limitit.

12. Në zbatim të udhëzimit nr. 37, datë 6.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, të dhënat e detyrimeve të prapambetura (vlera e stokut, e paguar dhe krijuar rishtazi), rakordohen brenda datës 10 shkurt 2025 midis njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe degëve të thesarit, të cilat menjëherë raportojnë përkatësisht në strukturën përgjegjëse për thesarin pranë ministrisë përgjegjëse për financat sipas formatit të raportit të gjeneruar nga SIFQ për publikim paraprak më datë 14. 2.2025 dhe përfundimtar më datë 28.2.2025.

13. Në zbatim të udhëzimit nr. 37, datë 6.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, të dhënat e detyrimeve të prapambetura (vlera e stokut, e paguar dhe krijuar rishtazi), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme me

vetëfinansim, regjistrohen në SIFQ brenda muajit janar të vitit 2025 dhe rakordohen brenda datës 10 shkurt 2025 midis njërive të qeverisjes së përgjithshme me vetëfinansim dhe degëve të thesarit, të cilat menjëherë raportojnë përkatësisht në strukturën përgjegjëse për thesarin pranë ministrisë përgjegjëse për financat sipas formatit të raportit të gjeneruar nga SIFQ për publikim paraprak më datë 14.2.2025 dhe përfundimtar më datë 28.2.2025.

14. Procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgjegjëse të thesarit, borxhit dhe njërive të qeverisjes së përgjithshme përfundon brenda datës 10.2.2025.

15. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë dhe në bazë të aktrakordimit të mbajtur me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe strukturën përgjegjëse për financat vendore në Ministrinë e Financave sa më parë të jetë e mundur brenda datës 27.1.2025 për fondet e papërdorura në vitin 2024, të detajuara sipas burimeve të financimit si më poshtë:

a) nga granti i qeverisjes qendrore, në kapitullin 1 “Çelje nga buxheti”;

b) nga projektet me financim të huaj, në kapitullin 2 “Financim i huaj”;

c) nga të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së tyre, në kapitullin 5 “Të ardhurat e veta”;

d) nga të ardhurat e krijuara në zbatim të legjislacionit specifik, në kapitullin 6 “Të ardhurat jashtë limitit”.

V. RAKORDIMI DHE MBYLLJA E LLOGARIVE TË TJERA VJETORE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

1. Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimi i pasqyrave financiare vjetore kryhet në bazë të udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.2.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 ‘Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme’”.



2. Degët e thesarit gjenerojnë nga SIFQ (në varësi të afatit të përfundimit të rakordimit vjetor) informacionin financiar disponibël/pasqyra financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme brenda datës 5 shkurt 2025. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë. Të dhënat përfundimtare kontabël pasqyrohen në SIFQ (në periudhën e 13-të) nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë, në zbatim të manualeve përkatëse. Të dhënat përfundimtare të pasqyrave financiare vjetore 2024 paraqiten brenda muajit mars të vitit 2025, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë.

3. Njësitë e projekteve me financim të huaj raportojnë në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë të dhënat e munguara të pasqyrave financiare për periudhën e mëparshme deri në 31.1.2025.

4. Njësitë e projekteve me financim të huaj janë përgjegjëse për transferimin e gjendjes së papërdorur të financimit të huaj në llogarinë e unifikuar të thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) për projektet që janë mbyllur në zbatim të marrëveshjes me financuesin e huaj/konfirmimit të financuesit të huaj.

5. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër urdhëron mbylljen e llogarive speciale të financimit të huaj joaktive kundrejt kërkesës zyrtare të nëpunësit autorizues të njësisë së zbatimit të projektit që ka përfunduar.

6. Në zbatim të pikave IV-a.9 dhe V-6 të udhëzimit nr. 24, datë 29.08.2019 “Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të dhënat vjetore kontabël për të cilat ekziston mundësia e ngarkimit në web Portal ruhen në arkivën elektronike, ndërsa të dhënat për të cilat nuk ekziston mundësia e arkivimit elektronik paraqiten fizikisht me protokoll në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë, e cila i rakordon me të dhënat përfundimtare të regjistruara në SIFQ.

7. Struktura përgjegjëse për borxhin në Ministrinë e Financave raporton në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër të dhënat e pasqyrave financiare të vitit 2024 për borxhin e qeverisë qendrore brenda muajit mars të vitit 2025. Gjithashtu, struktura përgjegjëse për borxhin, brenda datës 28.03.2025 raporton në strukturën

përgjegjëse për thesarin në qendër të dhënat e vitit 2024, për nënhatë.

8. Strukturat përgjegjëse për kontabilitetin në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “online” me SIFQ të kryejnë mbylljet e proceseve dhe të periudhave në modulën përkatës lidhur me asetet jofinanciare, duke mundësuar gjenerimin e të dhënave nga SIFQ, të njëjta me të dhënat e pasqyrave financiare të paraqitura fizikisht në protokollin e degës përkatëse të Thesarit deri në 01.04.2025.

9. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë, është përgjegjëse për pranimin e pasqyrave financiare të paraqitura nga njësitë shpenzuese dhe arkëtuese të qeverisjes së përgjithshme me të dhëna të rakorduara sipas kuadraturave të përcaktuara në setin e formateve të miratuara në udhëzimin nr. 5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 ‘Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme’”.

10. Të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara të jenë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ. Në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 21.2.2022, të dhënat e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në periudhën e 13-të të SIFQ të jenë të njëjta me të dhënat e aneksit 2 “Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të njësisë raportuese”, “Shënimi III. Informacion për zërat e pasqyrave financiare”, pika 20.

11. Pagesat e faturave të periudhës paraushtrimore të kontabilizohen dhe pasqyrohen në inventarin analitik bashkëlidhur pasqyrave financiare të vitit paraushtrimor të institucioneve, të cilat verifikohen nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë.

12. Pas përfundimit të gjenerimit të të dhënave financiare vjetore 2024, struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër, në bashkëpunim me strukturat e tjera të Ministrisë së Financave, Institutin e Statistikave dhe Bankën e Shqipërisë harton dhe dërgon të dhënat e tabelave të statistikave financiare të qeverisë (GFS-Government Finance Statistics) sipas metodologjisë së Fondit Monetar Ndërkombëtar - GFSM2014 (në zbatim të memorandumit të përbashkët të mirëkuptimit).

VI. MASA ADMINISTRATIVE

1. Procesi i rakordimit përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisjes së



përgjithshme, si dhe mbyllja e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit, monitorohet nga nëpunësi i parë autorizues nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin.

2. Mosrespektimi i kërkesave të këtij udhëzimi, nga ana e punonjësve të Ministrisë së Financave të përfshirë në proces, aplikohen masa administrative, sipas shkallës së shkeljes së provuar.

3. Procedura e ndjekur dhe shpenzimet e regjistruara në SIFQ nga punonjësi i degës së thesarit sipas pikës 1, të kreut IV, të këtij udhëzimi, do të jetë objekt monitorimi nga nëpunësi i parë autorizues i Ministrisë së Financave. Për shkeljet e konstatuara merret masë administrative deri në largim nga puna të punonjësit të thesarit.

4. Mosrespektimi i kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme, nëpunësi i parë autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Mosrespektimi i kërkesave të këtij udhëzimi nga bankat e nivelit të dytë, ministri i Financave aplikon penalitetet e parashikuara në marrëveshjet me bankat.

6. Për të gjitha kthimet e pagesave elektronike që janë për shkak të:

a) udhëzimeve të gabuara për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur në thesar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pagesa e komisionit bankar bëhet nga fondet operative të këtyre të fundit, me iniciativë të strukturës përgjegjëse për thesarin, në bazë të procesverbalit të mbajtur midis njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit;

b) regjistrimit të gabuar nga specialisti i degës së thesarit, atëherë pagesa e komisionit mbahet nga paga e specialistit;

c) gabimeve nga banka e nivelit të dytë, atëherë nuk paguhet komision, por me bankën përkatëse mbahet procesverbal për mosrespektimin e kushteve të marrëveshjes.

7. Për të gjitha rastet e udhëzimeve të gabuara, banka e nivelit të dytë bën kthimin menjëherë të pagesës së gabuar në Llogarinë Unike të Thesarit,

për t’u proceduar me korrigjimin nga degët e thesarit në bashkëpunim me njësinë shpenzuese.

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave për përpilimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e të dhënave periodike të treguesve fiskalë të konsoliduar të buxhetit sipas rregullores së brendshme, të cilat do të përpilojnë raportimin periodik dhe vjetor të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 306, datë 6.12.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES,
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË DETAJUARA PËR OPERIMIN E
BALONAVE, SI DHE PËR LICENCIMIN
E EKUIPAZHIT TË FLUTURIMIT
PËR BALONAT”¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 22 dhe nenit 26 të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për

¹ Ky urdhër përaftron plotësisht Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2018/395, të datës 13 mars 2018, për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L. 71, datë

14.3.2018, të ndryshuar me Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 2020/357, të 4 marsit 2020, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 67, datë 5.3.2020, dhe nr. 2021/1874, të 25 tetorit 2021, botuar në Fletoren Zyrtare L 378, datë 26.10.2021.



balonat”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
DETAJUARA PËR OPERIMIN E
BALONAVE, SI DHE PËR LICENCIMIN E
EKUIPAZHIT TË FLUTURIMIT PËR
BALONAT

Neni 1
Lënda dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat e detajuara për operimet ajrore me balona, si dhe për lëshimin dhe mbajtjen e licencave të pilotëve dhe klasifikimeve, privilegjeve dhe certifikatave përkatëse për balona, kur avionë të tillë plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat (b)(i) dhe (ii) të nenit 2(1) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.

2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për operimet ajrore me balona me gaz me një sistem lidhës.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme dhe, përveç nëse përkufizimet përcaktohen ndryshe në këtë nen, zbatohen përkufizimet e nenit 2 të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”:

1. “Balona” nënkupton një avion më të lehtë se ajri, i cili nuk është i drejtuar nga fuqia motorike dhe mbështet fluturimin nëpërmjet përdorimit të gazit më të lehtë se ajri ose një ngrohës ajror, duke përfshirë balonat e gazit, balonat me ajër të nxehtë,

balona të përziera dhe, megjithëse me energji elektrike, *airship* të shtyrë me ajër të nxehtë.

2. “Balona me gaz” nënkupton një balonë të lirë që ngritjen e saj e kryen me anë të gazit më të lehtë se ajri.

3. “Balona me gaz të lidhura” nënkupton një balonë me gaz me një sistem lidhës (ankorimi), që vazhdimisht ankoron balonën në një pikë fikse gjatë operimit.

4. “Balona e lirë” nënkupton një balonë që nuk është vazhdimisht e ankoruar në një pikë fikse gjatë operimit.

5. “Balona me ajër të nxehtë” nënkupton një balonë të lirë që ngritjen e saj e kryen nga ajri i nxehtë.

6. “Balona e përzier” nënkupton një balonë të lirë që ngritjen e saj e kryen nga një kombinim i ajrit të nxehtë dhe një gazi të lehtë dhe jo të ndezshëm.

7. “*Airship* me ajër të nxehtë” nënkupton një balonë me ajër të nxehtë të drejtuar nga një fuqi motorike, ku motori nuk krijon asnjë pjesë ete forcës së ngritjes;

(7a) “Operim tregtar” nënkupton çdo operim i një balone, në këmbim të shpërblimit ose vlerës tjetër të vlefshme, i cili është i disponueshëm për publikun ose, kur nuk vihet në dispozicion të publikut, kryhet sipas një kontrate midis një operatori dhe një klienti, ku ky i fundit nuk ka kontroll mbi operatorin.

8. “Fluturim konkurrimi” nënkupton çdo operim ajror me një balonë të kryer për qëllime të pjesëmarrjes në garat ajrore ose konkurse, duke përfshirë praktikimin e një operimi të tillë dhe fluturimin në dhe për garat ajrore ose konkurset.

9. “Shfaqje fluturuese” nënkupton çdo operim ajror me një balonë të kryer për qëllime të ofrimit të një shfaqjeje ose argëtimi në një ngjarje të shpallur të hapur për publikun, duke përfshirë praktikimin e një operimi të tillë dhe fluturimin në dhe për eventin e shpallur.

10. “Fluturim prezantues” nënkupton çdo operim ajror kundrejt çdo shpërblimi ose vlerë tjetër të vlefshme, që përbëhet nga një udhëtim ajror i shkurtër me qëllim tërheqjen e trajnuesëve të rinj apo të anëtarëve të rinj, i ekzekutuar nga një organizatë trajnuese e përmendur në nenin 8a të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, që përafron Rregulloren e



BE-së nr. 1178/2011, ose nga një organizatë e krijuar me qëllim të promovimit të sportit ajror ose aviacionit gjatë kohës së lirë.

11. “Vendi kryesor i biznesit” nënkupton zyra qendrore ose selia e operatorit të balonës brenda së cilës ushtrohen funksionet kryesore financiare dhe kontrolli operacional i aktiviteteve të përmendura në këtë Rregullore.

12. “Marrëveshje e qirasë së thatë” nënkupton një marrëveshje ndërmjet sipërmarrjeve në bazë të së cilës balona operohet nën përgjegjësinë e qiramarrësit.

13. “Licencë kombëtare” nënkupton një licencë piloti e lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me legjislacionin kombëtar përpara datës së zbatimit të aneksit III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje ose të aneksit I (pjesa FCL) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”.

14. “Licenca pjesa-BFCL” nënkupton licencën e ekuipazhit të fluturimit që përputhet me kërkesat e aneksit III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje.

15. “Raport konvertimi” nënkupton një raport mbi bazën e të cilit një licencë mund të konvertohet në një licencë pjesa-BFCL.

Neni 3

Operimet ajrore

1. Operatorët e balonave duhet të operojnë me balonën në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nënpjesën BAS të aneksit II, të kësaj Rregulloreje.

Megjithatë, nënparagrafi i parë nuk do të zbatohet për organizatat e projektimit ose të prodhimit që janë në përputhje me nenet 8 dhe 9 të urdhrimit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, që operojnë me balona, brenda objektit të privilegjeve të tyre, për qëllimet e futjes ose modifikimit të llojeve të balonave.

2. Operatorët e balonave kanë të drejtë të angazhohen në operime të tilla tregtare vetëm pasi të kenë deklaruar tek Autoriteti i Aviacionit Civil

kapacitetin dhe mjetet e tyre për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me operimin e balonës.

Nënparagrafi i parë nuk zbatohet për operimet e mëposhtme me balona:

a) operimet me shpërndarje të kostove në katër individë ose më pak, duke përfshirë pilotin, me kusht që kostot direkte të fluturimit të balonave dhe një pjesë proporcionale të kostos vjetore për shkak të ruajtjes, sigurimit dhe mirëmbajtjes së balonës, të ndahen nga të gjithë këta individë;

b) fluturimet garuese ose shfaqjet fluturuese, me kusht që shpërblimi/pagesa ose çdo përfitim me vlerë për këto lloj fluturimesh kufizohet në mbulimin e kostove direkte të fluturimit të balonave dhe një pjesë proporcionale të shpenzimeve vjetore të bëra për ruajtjen, sigurimin dhe mirëmbajtjen e balonave dhe që çdo çmim i përfituar nuk e tejkalon vlerën e specifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

c) fluturimet e prezantimit me katër individë ose më pak, duke përfshirë pilotin dhe fluturimet për qëllimet e hedhjes me parashutë, të kryera nga një organizatë trajnuese e përmendur në nenin 8a të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, e cila ka vendin e saj kryesor të biznesit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizatë e krijuar për qëllime të promovimit të sportit ajror ose aviacionit të kohës së lirë, me kusht që organizata të operojë balonën mbi bazën e pronësisë ose të marrëveshjes së qirasë së thatë, dhe me kusht që fluturimi të mos gjenerojë fitime të shpërndara jashtë organizatës dhe se fluturime të tilla përfaqësojnë vetëm një aktivitet marginal të organizatës;

d) fluturimet e trajnimit, të kryera nga një organizatë trajnuese e përmendur në nenin 8a të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, e cila ka vendin e saj kryesor të biznesit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3a

Licenca e pilotit dhe certifikimi mjekësor

1. Pilotët e avionëve të përmendur në pikën 1 të nenit 1 të kësaj Rregulloreje duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përcaktuara në aneksin III (pjesa



BFCL) të kësaj Rregulloreje dhe në aneksin IV (pjesa MED) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”.

2. Si përjashtim nga privilegjet e mbajtësve të licencave të përcaktuara në aneksin III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje, mbajtësit e licencave të tilla mund të kryejnë fluturime të përmendura në shkronjat (a) deri (d) të pikës 2, të nenit 3 pa qenë në përputhje me pikën BFCL.215 të aneksit III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të autorizojë studentë pilotë që ndjekin një kurs trajnimi për licencën e pilotit të balonave (BPL) për të ushtruar privilegje të kufizuara pa mbikëqyrje përpara se të plotësojnë të gjitha kërkesat që janë të nevojshme për lëshimin e një BPL-je në përputhje me aneksin III (pjesa BFCL), duke iu nënshtruar të gjitha kushteve të mëposhtme:

a) qëllimi i privilegjeve të dhëna bazohet në një vlerësim të rrezikut të sigurisë të kryer nga Autoriteti i Aviacionit Civil, duke marrë parasysh masën e trajnimit të nevojshëm për arritjen e nivelit të synuar të kompetencës së pilotit;

b) privilegjet kufizohen në sa vijon:

i. të gjithë ose një pjesë të territorit kombëtar të Republikës së Shqipërisë;

ii. balonat që janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

c) mbajtësi i një autorizimi të tillë që aplikon për lëshimin e një BPL-je merr kredite për trajnimin e kryer sipas autorizimit në bazë të një rekomandimi nga një organizatë e miratuar trajnimi (“ATO”) ose një organizatë e deklaruar trajnimi (“DTO”);

d) Autoriteti i Aviacionit Civil, kur të jetë e zbatueshme, i dorëzon raporte dhe vlerësime të rrezikut të sigurisë në operim Komisionit dhe Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian çdo 3 vjet;

e) Autoriteti i Aviacionit Civil monitoron përdorimin e autorizimeve të lëshuara sipas kësaj pike për të siguruar një nivel të pranueshëm të sigurisë së aviacionit në operim dhe për të marrë masat e duhura në rast të identifikimit të një rreziku të shtuar të sigurisë në operim ose ndonjë problemi të sigurisë në operim.

Neni 3b

Licencat ekzistuese të pilotit dhe certifikatat kombëtare mjekësore

1. Licencat e pjesës-FCL për balonat dhe privilegjet, klasifikimet dhe certifikatat shoqëruese të lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil përpara datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje konsiderohen se janë lëshuar në përputhje me këtë Rregullore. Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i zëvendësojnë ato licenca me licenca që përputhen me formatin e përcaktuar në aneksin VI (pjesa ARA) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, kur rilëshojnë licenca për arsye administrative ose me kërkesë të mbajtësve të licencës.

2. Kur Autoriteti i Aviacionit Civil rilëshon licencat dhe privilegjet shoqëruese, klasifikimet dhe certifikatat në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Autoriteti i Aviacionit Civil, sipas rastit:

a) transferon të gjitha privilegjet e miratuara tashmë në licencat sipas pjesës-FCL në formatin e ri të licencës;

b) konverton privilegjet për fluturimin ose operimin tregtar të lidhur me një licencë të pjesës-FCL në një klasifikim fluturimi të lidhur ose një klasifikim operimi tregtar në përputhje me parashikimet e pikës BFCL.200 dhe BFCL.215 të aneksit III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje;

c) miraton datën e skadimit të një certifikate të instruktorit të fluturimit të lidhur me një licencë të pjesës-FCL në regjistrin e pilotit ose lëshon një dokument ekuivalent. Pas kësaj date, këta pilotë do të ushtrojnë privilegje instruktori vetëm nëse janë në përputhje me pikën BFCL.360 të aneksit III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje.

3. Mbajtësit e licencave kombëtare për balonat e lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil përpara datës së zbatimit të aneksit III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje lejohen të vazhdojnë të ushtrojnë privilegjet e licencave të tyre deri më 8 prill 2025. Deri në atë datë, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i konvertojë ato licenca në licenca të pjesës-BFCL dhe klasifikime, privilegje dhe certifikata shoqëruese në përputhje me elementet e përcaktuara në një raport konvertimi që përputhet me kërkesat e nenit 4, pika 4 dhe 5, të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për



kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”.

4. Certifikatat mjekësore kombëtare të pilotëve të lidhura me një licencë siç specifikohet në pikën 2 të këtij neni dhe të lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil përpara datës së aplikimit të aneksit III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje mbeten të vlefshme deri në datën e rivlerësimit të tyre të radhës ose deri në 8 prill 2025, cilado qoftë më e hershme. Rivlefshmëria e këtyre certifikatave mjekësore do të jetë në përputhje me kërkesat e aneksit IV (pjesa MED) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”.

Neni 3c

Krediti për trajnimin që ka filluar përpara datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje

1. Në lidhje me dhënien e licencave të pjesës BFCL dhe privilegjeve, klasifikimeve ose certifikatave të lidhura në përputhje me aneksin III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje, trajnimi që ka filluar përpara datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje në përputhje me aneksin I (pjesa FCL) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, do të konsiderohet se është në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje, me kusht që BPL të lëshohet të paktën deri më 8 prill 2025. Në atë rast, do të zbatohen sa vijon:

a) trajnimi BPL i filluar me balona që përfaqësojnë klasën e aeroplanit me ajër të nxehtë, duke përfshirë testimin përkatës, mund të kryhet në ato balona;

b) orët e trajnimit të kryera në klasën e balonave me ajër të nxehtë në balona të ndryshme nga grupi A i asaj klase të balonave do të kreditohen plotësisht në përputhje me kërkesën në pikën BFCL.130(b) të aneksit III.

2. Trajnimi që ka filluar përpara datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje ose të aneksit I (pjesa FCL) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos, kreditohet për qëllimet e nxjerrjes së licencave të pjesës BFCL në bazë të një

raporti kreditimi të krijuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

3. Raporti i kreditimit i përmendur në pikën 2 përshkruan qëllimin e trajnimit, tregon për cilat kërkesa të kreditimit Part-BFCL është dhënë dhe, nëse është e aplikueshme, cilat kërkesa duhet të përmbushin aplikantët për t’u pajisur me një licencë të pjesës BFCL. Ai përfshin kopje të të gjitha dokumenteve të nevojshme për të vërtetuar qëllimin e trajnimit, si dhe kopje të rregullores dhe procedurave kombëtare në përputhje me të cilat trajnimi filloi.

Neni 3d

Organizatat e trajnimit

1. Organizatat e trajnimit për licencat e pilotëve të përmendura në pikën 1 të nenit 1 duhet të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 8a të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”.

2. Organizatat trajnuese të përmendura në pikën 1 të këtij neni të cilat kanë një miratim të lëshuar në përputhje me aneksin VII (pjesa ORA) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, ose kanë dorëzuar një deklaratë në përputhje me aneksin VIII (pjesa D’TO) të urdhrimit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, para datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje do të përshtatin programet e tyre të trajnimit, kur është e nevojshme, të paktën deri më 8 prill 2025.

Neni 4

Njohja e certifikatave, licencave, autorizimeve apo dokumenteve të tjera të lëshuara nga shtetet anëtare të EASA-s

Autoriteti i Aviacionit Civil pranon pa kërkesa apo vlerësime të mëtejshme licencat dhe autorizimet apo dokumente të tjera të lëshuara nga autoritete kompetente të shteteve anëtare të EASA-s, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.



1095, datë 24.12.2020, “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.

ANEKSI I PËRKUFIZIMET [PJESA-DEF]:

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme dhe, përveç nëse përkufizimet përcaktohen ndryshe në këtë aneks, zbatohen përkufizimet e nenit 2 të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, si dhe të pikës FCL.010 të aneksit I (pjesa FCL) të asaj Rregulloreje:

1. “Mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC)” nënkupton standardet jodetyruese të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për të treguar mjetet për të vendosur përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Për të treguar mjetet për të vendosur përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të pranojë mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC) të miratuara nga agjencia për të treguar mjetet për të vendosur përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, që përafron rregulloren (BE) nr. 2018/1139.

2. “Mjetet alternative të përputhshmërisë (AltMoC)” nënkupton ato mjete që propozojnë një alternativë për një AMC ekzistuese ose ato që propozojnë mjete të reja për të vendosur përputhshmëri me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për të cilat nuk ka pasur AMC shoqëruese që të jenë miratuar apo pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

3. “Pilot në komandë (PIC)” nënkupton një pilot të caktuar që është në komandë dhe i ngarkuar për kryerjen e sigurt të fluturimit.

4. “Anëtari i ekuipazhit” nënkupton një person të caktuar nga një operator për të kryer detyrat në bordin e balonës ose, kur detyrat janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin e balonës, në tokë.

5. “Anëtari i ekuipazhit të fluturimit” nënkupton një anëtar të ekuipazhit të licencuar i ngarkuar me detyra thelbësore për operimin e një avionit gjatë një periudhe pune fluturimi në detyrë.

6. “Substancat psikoaktive” nënkuptojnë alkoolin, opioidet, kanabinoidet, sedatives dhe hipnotikët, kokainën, psikostimulantë të tjerë, halucinogjenët dhe tretësit e paqëndrueshëm, duke përfshirë kafën dhe duhanin.

7. “Aksidenti” nënkupton një dukuri të lidhur me operimin e një balone që ndodh ndërmjet momentit të fillimit të fryrjes së balonës dhe momentit të shfryrjes së plotë të balonës, në të cilin:

a) një person pëson lëndime fatale ose serioze si pasojë e të qenit në balonë ose si rezultat i kontaktit të drejtpërdrejtë me ndonjë pjesë të balonës, duke përfshirë pjesët të cilat janë shkëputur nga balona, por duke përfshirë çdo lëndim që lind nga shkaqe natyrore ose që janë vetëshkaktuar ose shkaktuar nga persona të tjerë;

b) balona ka dëmtimë ose deficiencë strukturore që ndikojnë negativisht në fortësinë strukturore, performancën ose karakteristikat e fluturimit dhe kërkon riparim ose zëvendësim madhor të komponentit të dëmtuar; ose

c) balona mungon ose është plotësisht e paarrtshme.

8. “Incidenti” nënkupton një ngjarje, ndryshe nga një aksidenti, e lidhur me operimin e një balone që ndikon ose mund të ndikojë në sigurinë e operimit të saj.

9. “Incidenti i rëndë” nënkupton një dukuri e lidhur me operimin e balonave që ndodh ndërmjet momentit të fillimit të fryrjes së balonës dhe momentit të shfryrjes së plotë të balonës, në të cilin ka pasur një probabilitet të lartë aksidenti.

10. “Fazat kritike të fluturimit” nënkupton ngritjen, afrimin përfundimtar, qasjen e humbur, uljen dhe çdo fazë tjetër të një fluturimi që komandanti i pilotit e përcakton si kritik për operimin e sigurt të balonës.

11. “Manuali i fluturimit të mjeteve fluturuese (AFM)” nënkupton dokumentin që përmban kufizimet dhe informacionin e aplikueshëm dhe të aprovuar në lidhje me balonën;



11a. “Koha e fluturimit” nënkupton kohën totale që nga momenti kur shporta largohet nga toka me qëllim ngritjen deri në momentin kur ajo pushon përfundimisht në fund të fluturimit.

12. “Mallrat e rrezikshme” nënkupton artikujt ose substancat të cilat janë në gjendje të paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë, pronën ose mjedisin dhe të cilat janë paraqitur në listën e mallrave të rrezikshme në udhëzimet teknike ose që do të klasifikohen si të tilla në përputhje me ato udhëzime.

13. “Udhëzime teknike” nënkupton botimin e fundit të zbatueshëm të “Udhëzimeve teknike për transportin e sigurt nga ajri, të mallrave të rrezikshme”, duke përfshirë plotësimin dhe çdo shtojcë, të botuar nga ICAO-ja në dokumentin 9284-AN/905.

14. “Vend operimi” nënkupton një vend të zgjedhur nga piloti-në-komandë ose operatori për operimet e uljes, ngritjes ose të operimeve me ngarkesë të jashtme.

15. “Mbushje me karburant” nënkupton mbushjen e cilindrave të karburantit ose të tankeve të karburantit nga një burim i jashtëm, duke përjashtuar zëvendësimin e cilindrave të karburantit.

16. “Natë” nënkupton periudhën midis fundit të muzgut të mbrëmjes civile dhe fillimit të mëngjesit civil. Muzgu civil përfundon në mbrëmje, kur qendra e diskut të diellit është 6 gradë poshtë horizontit, dhe fillon në mëngjes, kur qendra e diskut të diellit është 6 gradë poshtë horizontit.

17. “Operim i specializuar i balonave” nënkupton çdo operim, i cili mund të jetë komercial ose jokomercial, me një balonë, qëllimi kryesor i së cilës nuk është transportimi i pasagjerëve për udhëtime turistike ose eksperience, por operimet me parashutë, hedhje me varje-rrëshqitje, shfaqje fluturuese, fluturime konkurrence ose aktivitete të ngjashme të specializuara.

17a. “Klasa e balonave” nënkupton një kategorizim të balonave, duke marrë parasysh mjetet ngritëse të përdorura për të mbështetur fluturimin.

17b. “Kontrolli i aftësisë” nënkupton demonstrimin e aftësive, me qëllim të përmbushjes së kërkesave të fundit të përcaktuara në këtë Rregullore, duke përfshirë provimet me gojë, siç mund të kërkohej.

18. “Ngarkesa e trafikut” nënkupton masën totale të pasagjerëve, bagazheve dhe pajisjeve të transportit të specializuara.

19. “Balonë e zbrazët” nënkupton masën e përcaktuar nga peshimi i balonave me të gjitha pajisjet e instaluara siç është specifikuar në AFM.

20. “Marrëveshje me qira të njomë” nënkupton një marrëveshje ndërmjet operatorëve në bazë të të cilave është balona operohet nën përgjegjësinë e qiradhënësit.

21. “Fluturim tregtar me balonë i pasagjerëve” (CPB) nënkupton një formë të operimit të transportit ajror komercial me një balonë, ku pasagjerët fluturojnë për ture, shëtitje ose eksperiencë, kundrejt shpërblimeve ose konsiderata të tjera të vlefshme në vlerë monetare.

22. “Grup balonash” nënkupton një kategorizim të balonave, duke marrë parasysh madhësinë ose kapacitetin e zarfit.

23. “Test aftësie” nënkupton demonstrimin e aftësive, me qëllim të lëshimit të një licence ose vlerësimi, ose zgjerimi i një privilegji, duke përfshirë provimet me gojë, siç mund të kërkohej.

24. “Vlerësimi i kompetencës” nënkupton demonstrimin e aftësive, njohurive dhe sjelljeve për lëshimin fillestar, rivlerësimin ose rinovimin e një certifikate të instruktorit ose të ekzaminuesit.

25. “Fluturim i vetëm” nënkupton një fluturim gjatë të cilit një student pilot është i vetmi udhëtar i balonës.

26. “Fluturim i lidhur” nënkupton një fluturim me një sistem lidhës që ankoron balonën në një vend të caktuar gjatë operimit, me përjashtim të një lidhjeje që mund të përdoret si pjesë e procedurës së ngritjes.

ANEKS II

OPERIMET AJRORE TË BALONAVE

[Pjesa BOP]

NËNPJESA BAS

KËRKESAT BAZË TË OPERIMIT

Seksioni 1

Kërkesat e përgjithshme

BOP.BAS.001 Qëllimi

Në përputhje me nenin 3, kjo nënpjesë përcakton kërkesat që duhet të plotësohen nga çdo operator i balonave, përveç organizatave të projektimit ose prodhimit të përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 3(1).

**BOP.BAS.005 Autoriteti kompetent**

Autoriteti i Aviacionit Civil do të jetë autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë, kur operatori ka vendin e tij kryesor të biznesit në Republikën e Shqipërisë ose, kur operatori nuk ka vendin kryesor të biznesit, vendi ku operatori është i vendosur ose banon është Republika e Shqipërisë. Ky autoritet do t'u nënshtrohet kërkesave të nenit 3 të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore", në përputhje me nenin 1(7) të asaj Rregulloreje.

BOP.BAS.010 Demonstrimi i përputhshmërisë

a) Një operator, kur kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili verifikon përputhshmërinë e vazhdueshme nga operatori sipas pikës ARO.GEN.300(a)(2) të aneksit II (pjesa ARO) të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore", demonstrojnë përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

b) Për të demonstruar një përputhshmëri të tillë, operatori duhet t'u referohet mjeteve në vazhdim:

1. Mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC);
2. Mjetet alternative të përputhshmërisë (AltMoC).

BOP.BAS.015 Fluturimet prezantuese

Fluturimet e prezantimit duhet:

- a) të operohen sipas rregullave të fluturimit vizual (VFR) gjatë ditës; dhe
- b) të mbikëqyren për sa i përket sigurisë së tyre në operim nga një person i cili është nominuar nga organizata përgjegjëse për fluturimet e prezantimit.

BOP.BAS.020 Reagimi i menjëhershëm ndaj një problemi të sigurisë në operim

Operatori duhet të zbatojë:

- a) masat e sigurisë në operim të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me shkronjën (c) të pikës ARO.GEN.135 të aneksit II të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore"; dhe

b) direktivat e vlefshmërisë ajrore dhe informacione të tjera të detyrueshme të lëshuara nga agjencia siç përshkruhet në shkronjën (h) të pikës 1 të nenit 77 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar. Autoriteti i Aviacionit Civil do të pranojë dhe publikojë informacionin e detyrueshëm të nxjerrë nga agjencia.

BOP.BAS.025 Përcaktimi si pilot në komandë

Operatori duhet të caktojë një pilot në komandë i cili është i kualifikuar për të vepruar si pilot në komandë në përputhje me aneksin III (pjesa BFCL) të kësaj Rregulloreje.

BOP.BAS.030 Përgjegjësitë e pilotit-në-komandë

a) Piloti në komandë duhet:

1. Të jetë përgjegjës për sigurinë në operim të balonës dhe të çdo personi ose pasurie që ka në të gjatë operateve me balonë;
2. Të jetë përgjegjës për fillimin, vazhdimin ose përfundimin e një fluturimi në interes të sigurisë në operim;
3. Të sigurojë që të zbatojë të gjitha procedurat e aplikueshme operationale dhe listat e kontrollit;
4. Të fillojë një fluturim vetëm nëse ai ose ajo bindet se të gjitha kufizimet operationale janë në përputhje me sa vijon:
 - i. balona është e vlefshme për fluturim në aspektin teknik;
 - ii. balona është regjistruar siç duhet;
 - iii. instrumentet dhe pajisjet e kërkuara për ekzekutimin e fluturimit mbahen në bordin e balonës dhe janë operative;
 - iv. masa e balonës është e tillë që fluturimi të mund të bëhet brenda kufijve të përcaktuar nga AFM-ja;
 - v. të gjitha pajisjet dhe bagazhet janë ngarkuar dhe siguruar siç duhet; dhe
 - vi. kufizimet operative të balonave siç janë specifikuar në AFM nuk do të tejkalohen në asnjë kohë gjatë fluturimit;
5. Të sigurojë që inspektimi para fluturimit është kryer siç kërkohet nga aneksi I i urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra";



6. Të jetë përgjegjës për informimin para fluturimit të personave që ndihmojnë në fryrjen dhe shfryrjen e balonës;

7. Të sigurojë që personat që ndihmojnë në fryrjen dhe shfryrjen e balonës kanë veshje të përshtatshme mbrojtëse;

8. Të jetë i kënaqur që pajisjet përkatëse emergjente mbeten lehtësisht të arritshme për përdorim të menjëhershëm;

9. Të sigurohet që asnjë person të mos pijë duhan në bord ose brenda distancës së drejtpërdrejtë të balonës;

10. Të mos lejojë që një person të hipë në balonë, i cili duket se është nën ndikimin e substancave psikoaktive në masën që siguria në operim e balonës ose e çdo personi ose pronësie të ngarkuar në të ka të ngjarë të rrezikohet;

11. Të mbetet në kontroll gjatë gjithë fluturimit të balonës në çdo kohë, përveç nëse një pilot tjetër merr kontrollin;

12. Të ndërmarrë çdo veprim në një situatë emergjente që kërkon vendim të menjëhershëm dhe veprime që ai ose ajo e konsideron të nevojshme sipas rrethanave. Në raste të tilla ai ose ajo mund të devijojë nga rregullat, procedurat operacionale dhe metodat në masën e nevojshme në interes të sigurisë në operim;

13. Të mos vazhdojë një fluturim përtej zonës më të afërt të lejuar nga moti, kur aftësia e tij ose saj për të kryer detyrat e tij zvogëlohet ndjeshëm, për shkak të sëmundjes, lodhjes, mungesës së oksigjenit ose ndonjë arsye tjetër;

14. Të regjistrojë të dhënat e përdorimit dhe të gjitha defektet e njohura ose të dyshuara në balonë gjatë përfundimit të fluturimit, ose serive të fluturimeve, në regjistrin e balonës;

15. Të njoftojë autoritetin e hetimit të sigurisë së shtetit në territorin e të cilit ndodh ngjarja dhe shërbimet emergjente të atij shteti pa vonesë me mjetet më të shpejta në dispozicion për çdo incident ose aksident serioz që përfshin balonën;

16. Të paraqesë një raport të një akti të ndërhyrjes së paligjshme pa vonesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil dhe të informojë autoritetin lokal të caktuar nga shteti në territorin e të cilit ndodhi ndërhyrja e paligjshme; dhe

17. Të raportojë në Ofruesin e Shërbimeve të Trafikut Ajror për Republikën e Shqipërisë (ATS), pa vonesë, çdo kusht të rrezikshëm të motit ose të

fluturimit që haset që ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë në operim të avionëve të tjerë.

b) Piloti në komandë nuk duhet të kryejë detyra në një balonë në një nga situatat e mëposhtme:

1. Kur ai ose ajo është i paaftë të kryejë detyrat e tij ose të saj nga ndonjë shkak, përfshirë lëndimin, sëmundjen, mjekimin, lodhjen ose efektet e ndonjë substance psikoaktive ose ndryshe ndihet i papërshtatshëm;

2. Nëse nuk plotësohen kushtet mjekësore të aplikueshme.

c) Sa herë që anëtarët e ekuipazhit janë të përfshirë në operimin e balonave, piloti në komandë duhet:

1. Të sigurojë që gjatë fazave kritike të fluturimit ose kurdo që konsiderohet e nevojshme në interes të sigurisë në operim, të gjithë anëtarët e ekuipazhit janë në stacionet e tyre të caktuara dhe nuk kryejnë asnjë veprimtari tjetër përveç atyre që kërkojnë për operimin e sigurt të balonës;

2. Të mos fillojë një fluturim nëse ndonjë anëtar i ekuipazhit është i paaftë të kryejë detyrat e tij ose të saj për ndonjë shkak, duke përfshirë lëndimet, sëmundjet, mjekimin, lodhjen ose efektet e ndonjë substance psikoaktive ose ndryshe ndjehet i papërshtatshëm;

3. Të mos vazhdojë një fluturim përtej zonës operative më të afërt të lejuar nga moti, kur aftësia e çdo anëtari të ekuipazhit për të kryer detyrat është zvogëluar dukshëm, për shkak të sëmundjes, lodhjes ose mungesës së oksigjenit ose ndonjë arsyeje tjetër; dhe

4. Të sigurojë që të gjithë anëtarët e ekuipazhit të mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në një gjuhë të përbashkët.

BOP.BAS.035 Autoriteti i pilotit-në-komandë

Piloti-në-komandë ka autoritetin:

a) të japë të gjitha komandat dhe të ndërmarrë veprime të duhura me qëllim garantimin e sigurisë në operim të balonës dhe të çdo personi ose pronësie të ngarkuar në të; dhe

b) të refuzojë imbarkimin ose transportimin e ndonjë personi ose bagazhi që mund të paraqesë një rrezik potencial për sigurinë në operim të balonës ose të çdo personi ose pronësie të ngarkuar në të.

**BOP.BAS.040 Përgjegjësitë e anëtarëve të ekuipazhit**

a) Çdo anëtar i ekuipazhit është përgjegjës për ekzekutimin e duhur të detyrave të tij ose të saj në lidhje me operimin e balonës;

b) Anëtarët e ekuipazhit nuk do të kryejnë detyra në një balonë kur janë të paaftë për ndonjë shkak, përfshirë lëndimet, sëmundjet, mjekimin, lodhjen ose efektet e ndonjë substance psikoaktive, ose nëse ai ose ajo ndryshe ndihet i papërshtatshëm;

c) Anëtarët e ekuipazhit duhet t'i raportojnë pilotit në komandë në të dyja prej këtyre rasteve:

1. Çdo gabim, dështim, mosfunksionim ose defekt, të cilin ai ose ajo beson se mund të ndikojë në vlefshmërinë ajrore ose në operimin e sigurt të balonës, duke përfshirë sistemet emergjente;

2. Çdo incident.

d) Çdo anëtar i ekuipazhit të fluturimit, i cili merr përsipër detyra për më shumë se një operator duhet:

1. Të mbajë të dhënat individuale të tij ose të saj në lidhje me kohën e fluturimit dhe periudhat e pushimit, nëse është e aplikueshme; dhe

2. T'i sigurojë secilit operator të dhënat e nevojshme për të planifikuar aktivitetet në përputhje me kufizimet e zbatueshme të kohës së fluturimit, të punës dhe kërkesat e pushimit.

BOP.BAS.045 Përputhshmëria me ligjet, rregulloret dhe procedurat

a) Piloti në komandë dhe të gjithë anëtarët e tjerë të ekuipazhit duhet të jenë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat e atyre shteteve ku zhvillohen operimet.

b) Pilotin në komandë duhet të jetë i njohur me ligjet, rregulloret dhe procedurat, që lidhen me kryerjen e detyrave të tij ose të saj, të përshkruara për zonat që do të kalohen, vendet operative që do të përdoren dhe objektet e lidhura me lundrimin ajror.

BOP.BAS.050 Dokumentet, manualët dhe informacioni që duhen mbajtur

a) Të gjitha dokumentet, manualët dhe informacionet e mëposhtme mbahen në çdo fluturim, si origjinale ose kopje:

1. Kufizimet e operimit, procedurat normale, anormale dhe emergjente dhe informacione të tjera përkatëse specifike për karakteristikat e operimit të balonës;

2. Detajet e planit të fluturimit ATS të dorëzuar, kur kërkohet në përputhje me seksionin 4 të aneksit të urdhrin të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave

të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operationale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror";

3. Tabelat aktuale dhe të përshtatshme aeronautike për zonën e fluturimit të planifikuar.

b) Të gjitha dokumentet, manualët dhe informacionet e mëposhtme mbahen në çdo fluturim ose mbahen në mjetin e tërheqjes, si origjinale ose kopje:

1. Certifikata e regjistrimit;

2. Certifikata e vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë anekset;

3. AFM -ja ose dokumenti/et ekuivalent/e;

4. Licenca e radios së avionit, kur balona është e pajisur me pajisje radiokomunikacioni në përputhje me pikën (a) të pikës BOP.BAS.355;

5. Certifikata/t e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palës së tretë;

6. Regjistri i balonës ose dokumenti/et ekuivalent/e;

7. Çdo dokumentacion tjetër që mund të jetë i përshtatshëm për fluturimin ose kërkohet nga shteti ose shtetet e përfshira në fluturim.

c) Kur kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, piloti në komandë ose operatori i vë në dispozicion atij, dokumentacionin origjinal brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili nuk duhet të jetë më pak se 24 orë.

BOP.BAS.055 Mallrat e rrezikshme

a) Transporti i mallrave të rrezikshme në bordin balonave duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e paraqitura në urdhrin e ministrit nr. 78, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores për transportin ajror të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë", harmonizuar me aneksin 18 të Konventës së Çikagos, të përditësuar dhe të përforcuar së fundmi me udhëzimet teknike.

b) Piloti në komandë do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të parandaluar që mallrat e rrezikshme të mbahen në bordin e balonave pa dashje.

c) Sasitë e arsyeshme të artikujve dhe substancave të cilat përndryshe do të klasifikoheshin si mallra të rrezikshme dhe që përdoren për të lehtësuar sigurinë e operimit në fluturim, kur transportimi në bordin e balonave është i këshillueshëm për të siguruar disponueshmërinë e tyre në kohën e duhur për qëllime operationale, konsiderohen të autorizuar sipas pikës 2.2.1 a) të pjesës 1 të udhëzimeve teknike, pavarësisht nëse artikuj dhe substanca të tilla



kërkohen ose jo të transportohen ose synohen të përdoren në lidhje me një fluturim të caktuar. Piloti në komandë duhet të sigurojë që paketimi dhe ngarkimi në bordin e balonës i këtyre artikujve dhe substancave të kryhet në mënyrë të tillë që të minimizojë rreziqet që u vijnë anëtarëve të ekuipazhit, pasagjerëve dhe balonës gjatë operimit.

d) Piloti në komandë ose, operatori kur piloti në komandë është i paaftë, duhet të raportojë pa vonesë çdo aksident ose incident që përfshin mallra të rrezikshme tek autoriteti i hetimit të sigurisë të shtetit në territorin e të cilit ka ndodhur ngjarja, shërbimet emergjente të atij shteti, çdo autoritet tjetër të caktuar nga ai shtet dhe autoriteti kompetent.

BOP.BAS.060 Lëshimi i mallrave të rrezikshme

a) Piloti në komandë nuk do të lëshojë mallra të rrezikshme kur operon një balonë mbi zonat të mbipopulluara të qyteteve, qytezave ose vendbanimeve ose mbi një grumbull personash në ajër të hapur.

b) Pavarësisht nga shkronja (a), parashutistët mund të dalin nga balona me qëllim të shfaqjes së parashutës mbi ato zona të mbipopulluara ose mbi atë grup personash në ajër të hapur, ndërsa mbajnë pajisje të shtigjeve të tymit që janë prodhuar për këtë qëllim.

BOP.BAS.065 Regjistri i balonave

Për secilin fluturim ose seri fluturimesh, veçorinë e balonës, ekuipazhit të saj dhe të çdo udhëtimi mbahen në formën e një ditari udhëtimi të balonës ose të një dokumenti ekuivalent.

Seksioni 2

Procedurat e operimit

BOP.BAS.100 Përdorimi i vendeve të operimit

Piloti në komandë duhet të përdorë vetëm vende operimi të përshtatshme për llojin e balonës dhe operimeve përkatëse.

BOP.BAS.105 Procedurat e zvogëlimit të zhurmës

Piloti në komandë duhet të marrë parasysh procedurat e operimit për të minimizuar efektin e zhurmës së sistemit të ngrohjes, megjithatë duke siguruar se siguria në operim ka përparësi ndaj zvogëlimit të zhurmës.

BOP.BAS.110 Furnizimi dhe planifikimi i karburantit dhe kundër pesha

Piloti në komandë duhet të fillojë një fluturim vetëm nëse karburanti ose kundër pesha rezervë që mbahen në bordin e balonës është i mjaftueshëm për të siguruar një ulje të sigurt.

BOP.BAS.115 Informimi i udhëtarëve

Piloti në komandë duhet të sigurojë që para dhe, kur është e përshtatshme, gjatë fluturimit, udhëtarëve t'u jepet një informacion mbi procedurat normale, anormale dhe emergjente.

BOP.BAS.120 Transporti i kategorive të veçanta të pasagjerëve

Piloti në komandë duhet të sigurojë që personat që kërkojnë kushte, asistencë ose pajisje të veçanta, kur mbahen në bordin e një balone, të transportohen në kushte që garantojnë sigurinë në operim të balonës dhe të çdo personi ose pronësie të ngarkuar në të.

BOP.BAS.125 Paraqitja (dorëzimi) e planit të fluturimit të shërbimit të trafikut ajror

a) Nëse një plan i fluturimit i shërbimit të trafikut ajror (ATS) nuk paraqitet, për shkak se nuk kërkohet në përputhje me shkronjën (b) të pikës SERA.4001 të aneksit të urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror", që përafron rregulloren e BE-së nr. 923/2012, piloti në komandë duhet të dorëzojë informacionin korrekt për të lejuar aktivizimin e shërbimeve të sinjalizimit nëse kërkohet.

b) Kur vepron nga një vend operimi ku është e pamundur të paraqitet një plan fluturimi ATS, megjithëse kërkohet në përputhje me shkronjën (b) të pikës SERA.4001 të aneksit të urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror", që përafron Rregulloren e BE-së nr. 923/2012, piloti në komandë duhet të dorëzojë planin ATS të fluturimit pas ngritjes.

BOP.BAS.130 Përgatitja e fluturimit

Para fillimit të fluturimit, piloti në komandë duhet të jetë i njohur me informacionin meteorologjik dhe aeronautik në dispozicion, të përshtatshëm për fluturimin e synuar, i cili përfshin të dyja sa vijon:



a) një studim i raporteve dhe parashikimeve aktuale të motit në dispozicion;

b) planifikimi i një kursi alternativ të veprimit për të parashikuar mundësinë që fluturimi të mos mund të përfundojë siç ishte planifikuar.

BOP.BAS.135 Pirja e duhanit në bord

Asnjë person nuk duhet të pijë duhan në një balonë gjatë çdo faze të fluturimit ose brenda afërsisë së drejtpërdrejtë të një balone.

BOP.BAS.140 Transporti dhe përdorimi i armëve

a) Piloti në komandë siguron që asnjë person të mos mbajë dhe të përdorë armë në bordin e balonës.

b) Me përjashtim të shkronjës (a), piloti në komandë mund të lejojë transportimin dhe përdorimin e armëve në një balonë kur kërkohet për sigurinë e anëtarëve të ekuipazhit ose pasagjerëve. Në raste të tilla piloti në komandë duhet të sigurojë që armët të jenë të siguruara kur nuk janë në përdorim.

BOP.BAS.145 Kushtet meteorologjike

Piloti në komandë duhet të fillojë ose vazhdojë një fluturim VFR vetëm nëse informacioni më i fundit meteorologjik i disponueshëm tregon se kushtet e motit përgjatë rrugës dhe në destinacionin e synuar në kohën e parashikuar të përdorimit janë si më poshtë:

a) në ose mbi minimumin operativ të VFR; dhe

b) brenda kufizimeve meteorologjike të përcaktuara në AFM.

BOP.BAS.150 Kushtet e ngritjes

Piloti në komandë duhet të jetë i bindur përpara se të nisë ngritjen e balonës se, sipas informacionit më të fundit të disponueshëm, moti në vendin e operimit lejon një ngritje dhe nisje të sigurt.

BOP.BAS.155 Kushtet e afrimit dhe uljes

Përveç situatave emergjente, piloti në komandë duhet të jetë i bindur para se të fillojë një afrim në tokë, me informacionin më të fundit në dispozicion, që kushtet e motit në vendin e lejuar operativ të synuar lejojnë të kryhet një afrim dhe ulje e sigurt.

BOP.BAS.160 Situatat e simuluar gjatë fluturimit

a) Piloti në komandë nuk do të simulojë situata që kërkojnë zbatimin e procedurave anormale ose emergjente kur mbajnë pasagjerët.

b) Përjashtimisht nga shkronja (a), piloti në komandë mund të simulojë situata të tilla, gjatë operimeve të ndryshme përveç nga operimet tregtare të balonave, kur kryen fluturime trajnimi ose

me pilotë studentë ose me pasagjerë, me kusht që pasagjerët të jenë informuar siç duhet dhe kanë rënë dakord për simulimin paraprakisht.

BOP.BAS.165 Menaxhimi i karburantit në fluturim

Piloti në komandë duhet të kontrollojë në intervale të rregullta gjatë fluturimit që sasia e karburantit të përdorshëm ose kundër peshave të përdorshme, që mbetet në fluturim nuk është më pak se karburanti ose balast që nevojiten për të përfunduar fluturimin e synuar dhe rezervën e planifikuar për ulje.

BOP.BAS.170 Furnizimi me karburant me personat në bord

a) Furnizimi me karburant i balonave nuk duhet të bëhet kur personat janë në bord.

b) Me përjashtim të shkronjës (a), furnizimi me karburant i motorit të *airship*-eve me ajër të nxehtë mund të kryhet me pilotin në komandë në bord.

BOP.BAS.175 Përdorimi i sistemit të shtërngimit të rripave të sigurimit

Kur kërkohet një sistem lidhjeje në përputhje me pikën BOP.BAS.320, piloti në komandë duhet të përdorë sistemin të paktën gjatë uljes.

BOP.BAS.180 Përdorimi i oksigjenit shtesë

Piloti në komandë duhet të sigurojë që:

a) të gjithë anëtarët e ekuipazhit të angazhuar në kryerjen e detyrave thelbësore për operimin e sigurt të balonës të përdorin oksigjenin shtesë vazhdimisht kurdo që ai ose ajo të përcaktojë se në lartësinë e fluturimit të synuar, mungesa e oksigjenit mund të rezultojë në dëmtim të aftësive të anëtarëve të ekuipazhit; dhe

b) oksigjeni shtesë është në dispozicion të pasagjerëve kur mungesa e oksigjenit mund t'i ndikojë ata në mënyrë të dëmshme.

BOP.BAS.185 Kufizimet operacionale gjatë natës

a) Balona me ajër të nxehtë:

1. Nuk do të ulet gjatë natës, përveç në situata emergjente; dhe

2. Mund të niset gjatë natës, me kusht që të mbahen karburante ose kundërpesha të mjaftueshme për një ulje gjatë ditës.

b) Balonat e gazit dhe balonat e përziera:

1. Nuk do të ulen gjatë natës, përveç në situata emergjente ose si ulje parandalimi; dhe

2. Mund të nisen gjatë natës, me kusht që të mbahen karburante ose kundërpesha të mjaftueshme për një ulje gjatë ditës.



c) *Airship*-et me ajër të nxehtë duhet të operohen në përputhje me kufizimet dhe informacionin e tyre të miratuar të VFR gjatë natës.

BOP.BAS.190 Operimet e specializuara të balonave – Vlerësimi i riskut dhe lista e kontrollit

a) Para fillimit të një operimi të specializuar të balonave, piloti në komandë kryen një vlerësim të riskut, duke vlerësuar kompleksitetin e aktivitetit, me qëllim të përcaktimit të rreziqeve dhe të risqeve të lidhura me veprimin e synuar dhe vendosjen e masave mitiguese kur është e nevojshme.

b) Një operim i specializuar i balonave kryhet në përputhje me një listë kontrolli. Piloti në komandë duhet të përcaktojë listën e kontrollit dhe të sigurojë që është e përshtatshme për veprimtarinë e specializuar dhe balonën e përdorur, bazuar në vlerësimin e riskut dhe duke marrë parasysh të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë nënpjesë. Lista e kontrollit duhet të jetë lehtësisht e arritshme dhe e përdorshme për çdo fluturim për pilotin në komandë dhe anëtarët e tjerë të ekuipazhit, aty ku është e aplikueshme për kryerjen e detyrave të tyre.

c) Piloti në komandë rishikon dhe përditëson rregullisht listën e kontrollit aty ku është e nevojshme për të marrë në konsideratë në mënyrë të saktë vlerësimin e riskut.

Seksioni 3

Performanca dhe kufizimet e operimit

BOP.BAS.200 Kufizimet e operimit

Piloti në komandë siguron se, gjatë çdo faze të operimit, balona të mos tejkalojë asnjë nga kufizimet e përcaktuara në AFM ose tek një dokument/e ekuivalent.

BOP.BAS.205 Peshimi

a) Peshimi i balonës duhet të kryhet nga prodhuesi i balonës ose në përputhje me aneksin I të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”;

b) Operatori duhet të sigurojë që masa e balonës është përcaktuar nga peshimi aktual përpara hyrjes fillestare të saj në shërbim. Efektet e akumuluar të modifikimeve dhe riparimeve në masë do duhet të merren në konsideratë dhe të

dokumentohen siç duhet. Një informacion i tillë duhet t'i vihet në dispozicion pilotit në komandë. Balona do të ripeshohet nëse nuk dihen efektet e modifikimeve ose riparimeve në masë.

BOP.BAS.210 Performanca–Të përgjithshme

Piloti në komandë duhet të operojë me balonë vetëm nëse performanca e balonës është e përshtatshme për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në aneksin e urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, dhe çdo kufizim tjetër të zbatueshëm për fluturimin, hapësirën ajrore ose vendet operative të përdorura, duke siguruar që çdo tabelë ose hartë e përdorur është botimi më i fundit në dispozicion.

Seksioni 4

Instrumentet dhe pajisjet

BOP.BAS.300 Instrumentet dhe pajisjet – Të përgjithshme

a) Instrumentet dhe pajisjet e kërkuara nga ky seksion duhet të miratohen në përputhje me aneksin I të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

1. Ato përdoren për të përmbushur pikat BOP.BAS.355 dhe BOP.BAS.360;

2. Ata janë instaluar në mënyrë të përhershme në balonë.

b) Me përjashtim të shkronjës (a), të gjitha instrumentet ose pajisjet e mëposhtme, kur kërkohet nga ky seksion, nuk kanë nevojë për miratim:

1. Instrumentet ose pajisjet e përdorura nga ekuipazhi i fluturimit për të përcaktuar rrugën e fluturimit;

2. Dritat portative të pavarura;

3. Një mekanizëm ore i saktë;

4. Kutia e ndihmës së parë;

5. Pajisjet e mbijetesës dhe sinjalizimit;

6. Aparatet për ruajtjen dhe shpërndarje të oksigjenit shtesë;



7. Burimi alternativ i ndezjes;

8. Batanija (kundër) zjarrit ose mbulesa zjarrduruese;

9. Zjarrfikëset e dorës;

10. Litari që lëshohet për të zbritur;

11. Thika.

c) Instrumentet dhe pajisjet që nuk kërkohen nga ky seksion, si dhe çdo pajisje tjetër që nuk kërkohet nga ky Aneks, por që mbahen në bordin e një balone gjatë një fluturimi, duhet të jenë në përputhje me të dyja kushtet e mëposhtme:

1. Informacioni që sigurohet nga këto instrumente ose pajisje nuk duhet të përdoret nga ekuipazhi i fluturimit për të përmbushur kërkesat thelbësore për vlefshmërinë ajrore të përcaktuara në aneksin I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.

2. Instrumentet dhe pajisjet nuk do të ndikojnë në vlefshmërinë ajrore të balonës, edhe në rast të dështimeve ose mosfunksionimit.

d) Instrumentet dhe pajisjet duhet të jenë lehtësisht të përdorshme ose të arritshme nga stacioni ku është caktuar anëtar i ekuipazhit të fluturimit, që ka nevojë ta përdorë atë;

e) Të gjitha pajisjet e nevojshme të emergjencës duhet të jenë lehtësisht të arritshme për përdorim të menjëhershëm.

BOP.BAS.305 Instrumentet dhe pajisjet minimale për fluturim

Një fluturim me balonë nuk do të fillojë kur ndonjë nga instrumentet dhe pajisjet e kërkuara për fluturimin e synuar me balonë mungon, nuk funksionon ose nuk i përmbush funksionet e kërkuara.

BOP.BAS.310 Dritat operuese

Balonat që operojnë gjatë natës pajisen me të gjitha këto që vijnë:

a) një dritë për mënjanimin e përplasjes;

b) një mjet për të siguruar ndriçim të përshtatshëm për të gjitha instrumentet dhe pajisjet e nevojshme për operimin e sigurt të balonës;

c) një dritë portative e pavarur.

BOP.BAS.315 Instrumentet dhe pajisjet e fluturimit dhe lundrimit

Balonat që operohen në VFR ditën duhet të pajisen me të dy lloj mjetesh si në vijim:

a) një mjet për shfaqjen e drejtimit të rrëshqitjes;

b) një mjet për matjen dhe paraqitjen:

1. Kohës në orë, minuta dhe sekonda;

2. Shpejtësisë vertikale, nëse kërkohet nga AFM-ja; dhe

3. Presionit sipas lartësisë nëse kërkohet nga AFM-ja, kur kërkohet nga kërkesat e hapësirës ajrore ose kur lartësia duhet të bëhet e ditur për përdorimin e oksigjenit.

BOP.BAS.320 Sistemet e shtrëngimit të rripave

Balonat duhet të pajisen me një sistem shtrëngimi për pilotin në komandë kur balona është e pajisur me njërën nga këto që vijnë:

a) një ndarje të veçantë për pilotin në komandë;

b) ndenjës të lëvizshme/rrotullueshme.

BOP.BAS.325 Oksigjeni shtesë

Balonat që operohen kur kërkohet një furnizim me oksigjen në përputhje me pikën BOP.BAS.180 duhet të pajisen me aparate për ruajtjen dhe shpërndarjen e oksigjenit, të aftë për të ruajtur furnizimet e nevojshme të oksigjenit shtesë.

BOP.BAS.330 Kutia e ndihmës së parë

a) Balonat duhet të pajisen me një kuti të ndihmës së parë.

b) Kutia e ndihmës së parë do të jetë:

1. Lehtësisht e arritshme për përdorim; dhe

2. Duhet të mbahet e përditësuar.

BOP.BAS.335 Zjarrfikëset e dorës

Përveç balonave të gazit, balonat duhet të pajisen me të paktën një zjarrfikës dore.

BOP.BAS.340 Pajisjet e shpëtimit dhe sinjalizimit - Fluturimet mbi ujë

Piloti në komandë i një balone që operohet mbi ujë duhet të përcaktojë, para fillimit të fluturimit, risqet për mbijetesën e personave të transportuar në balonë në rast të uljes mbi/në ujë. Bazuar në këto risqe, ai ose ajo duhet të përcaktojë nëse ka nevojë të mbajë pajisjet për shpëtimin e jetës dhe ato të sinjalizimit.

BOP.BAS.345 Pajisjet e shpëtimit dhe sinjalizimit – Vështirësitë në kërkim dhe në shpëtim

Balonat që operojnë mbi zonat në të cilat kërkimi dhe shpëtimi (SAR) do të ishte veçanërisht i vështirë duhet të pajisen me pajisje të tilla të shpëtimit dhe sinjalizimit të përshtatshme për zonën e fluturimit.

BOP.BAS.350 Pajisje të ndryshme:

a) Balonat duhet të pajisen me doreza mbrojtëse për secilin anëtar të ekuipazhit.

b) Balonat e përziera, balonat me ajër të nxehtë dhe *airship*-et me ajër të nxehtë duhet të pajisen me të gjitha këto që vijnë:



1. Një burim alternativ dhe i pavarur i ndezjes;
2. Një mjet për matjen dhe tregimin e sasisë së karburantit;
3. Një batanije kundër zjarri ose një mbulesë kundër zjarrit;
4. Një vijë rënie (litar të lëshuar) prej të paktën 25 m në gjatësi.

c) Balonat e gazit duhet të pajisen me të dyja mjetet si në vijim:

1. Një thikë;
2. Një litar tërheqës/ankorimi prej të paktën 20 m në gjatësi të bërë nga fibra natyrale ose materiale elektrostاتيke përçuese.

BOP.BAS.355 Pajisjet e komunikimit me radio

a) Balonat duhet të kenë pajisje radiokomunikimi për të lejuar komunikimin e kërkuar në përputhje me shtojcën 4 të aneksit të urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, dhe, nëse fluturimi zhvillohet në hapësirën ajrore të një vendi tjetër, ligjin e atij vendi.

b) Pajisjet e radiokomunikimit duhet të sigurojnë komunikim në frekuencën e emergjencës aeronautike 121,5 MHz.

BOP.BAS.360 Transponderi

Balona duhet të ketë një transponder sekondar të radarëve të mbikëqyrjes (SSR) me të gjitha aftësitë e kërkuara në përputhje me pikën (b) të pikës SERA.6005 të aneksit të urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, që përafron rregulloren e BE-së nr. 923/2012, dhe nëse fluturimi zhvillohet në hapësirën ajrore i një vendi tjetër, sipas ligjit të atij vendi.

NËNPJESA ADD KËRKESAT SHITESË PËR OPERIMET TREGTARE

Seksioni 1

Kërkesat e organizimit të përgjithshëm

BOP.ADD.001 Fushëveprimi

Në përputhje me nenin 3 të kësaj Rregulloreje, kjo nënpjesë përcakton kërkesat që duhet të

plotësohen, përveç kërkesave të nënpjesës BAS, nga çdo operator i angazhuar në operime tregtare me balona, përveç operatorëve të referuar në nënparagrafin e fundit të pikës 2, të nenit 3 të kësaj Rregulloreje.

BOP.ADD.005 Përgjegjësitë e operatorit

a) Operatori është përgjegjës për operimin e balonës në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin IV të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, me kërkesat e kësaj nënpjese dhe me deklaratën e tij;

b) Çdo fluturim duhet të bëhet në përputhje me dispozitat e manualit të operimeve;

c) Operatori duhet të sigurojë që balona të jetë e pajisur dhe të gjithë anëtarët e ekuipazhit të jenë të kualifikuar sipas nevojës për fushën dhe llojin e operimit;

d) Operatori duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët e ekuipazhit të caktuar ose të përfshirë drejtpërsëdrejti në operimet e fluturimit përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Ata janë të trajnuar dhe udhëzuar siç duhet;
2. Ata janë në dijeni të rregullave dhe procedurave që lidhen me detyrat e tyre të veçanta;
3. Ata kanë demonstruar aftësitë e tyre në detyrat e tyre të veçanta;
4. Ata janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe marrëdhënien e këtyre detyrave me operimin e balonës në tërësi.

e) Operatori duhet të përcaktojë procedurat dhe udhëzimet për operimin e sigurt të çdo lloji të balonave, që përmbajnë detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të ekuipazhit, për të gjitha llojet e operimeve. Këto procedura dhe udhëzime nuk do të kërkojnë që anëtarët e ekuipazhit të kryejnë ndonjë aktivitet gjatë fazave kritike të fluturimit, përveç atyre që kërkohen për funksionimin e sigurt të balonës;

f) Operatori duhet të marrë masa për mbikëqyrjen e anëtarëve të ekuipazhit dhe personelit të përfshirë në operimin e balonës nga individë me përvojë dhe aftësi të përshtatshme për të siguruar arritjen e standardeve të përcaktuara në manualin e operimeve;

g) Operatori duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët e ekuipazhit dhe personeli i përfshirë në operimin e balonave të jenë të vetëdijshëm se duhet të jenë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe



procedurat e shteteve në të cilat kryhen operimet që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave të tyre;

h) Operatori duhet të specifikojë procedurat e planifikimit të fluturimit për të siguruar drejtimin e sigurt të fluturimit, në bazë të konsideratave të performancës së balonave, kufizimeve të tjera operative dhe kushteve përkatëse të pritshme në itinerarin që do të ndiqet dhe në vendet operative në fjalë. Këto procedura duhet të përfshihen në manualin e operimeve.

BOP.ADD.010 Njoftimi i mjeteve alternative të përputhshmërisë

Operatori, kur bën deklaratën në përputhje me pikën BOP.ADD.100, njofton Autoritetin e Aviacionit Civil për listën e mjeteve alternative të përputhshmërisë (AltMoC), kur ai synon të përdorë AltMoC për të demonstruar pajtueshmërinë, kur kërkohet në përputhje me pikën BOP.BAS.010. Kjo listë përmban referenca për mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC) të cilat ata zëvendësojnë në rast se AMC-ja e lidhur është miratuar nga agjencia dhe pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

BOP.ADD.015 Aksesi

a) Me qëllim të përcaktimit të përputhshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje, operatori do të lejojë aksesin e çdo personi të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në çfarëdo kohë për çdo objekt, balonë, dokument, shënime, të dhëna, procedura ose ndonjë material tjetër që lidhet me veprimtarinë e operatorit, që hyn në objektin e kësaj Rregulloreje, pavarësisht nëse aktiviteti është kontraktuar ose jo.

b) Aksesi në balonë, në rastin e fluturimeve tregtare të pasagjerëve, duhet të përfshijë mundësinë për të hyrë dhe qëndruar në balonë gjatë operimeve të fluturimit, përveç rasteve kur kjo do të rrezikonte fluturimin.

BOP.ADD.020 Gjetjet

Pas marrjes së njoftimit të gjetjeve të ngritura nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me pikat ARO.GEN.350, ARO.GEN.355 dhe ARO.GEN.360 të aneksit II të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, operatori duhet të bëjë të gjitha sa vijon:

a) të identifikojë shkaktarin kryesor të mospërputhjes;

b) të përcaktojë një plan veprimi korrigjues;

c) të demonstrojë zbatimin e planit të veprimit korrigjues, në përputhje me kërkesën e autoritetit kompetent brenda periudhës kohore të përcaktuar nga ai autoritet në përputhje me pikën ARO.GEN.350 të aneksit II të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”.

BOP.ADD.025 Raportimi i ngjarjeve

a) Operatori zbaton, si pjesë të sistemit të tij të menaxhimit, një skemë të raportimit të ngjarjeve e cila siguron një raportim të detyrueshëm dhe vullnetar në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë”.

b) Pa cenuar shkronjën (a), operatori duhet të raportojë tek Autoriteti i Aviacionit Civil dhe organizata përgjegjëse për projektimin e balonave për ndonjë mosfunksionim të balonave, defekt teknik, tejkalim i kufizimeve teknike ose dukurive që do të theksonin informacionin e pasaktë, jo të plotë ose të paqartë të të dhënave hartuara sipas aneksit I të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”.

c) Operatori merr masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me nenin 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 739, datë 3.12.2021, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil”, nga piloti në komandë, çdo anëtar tjetër i ekuipazhit dhe i gjithë personeli i tij në lidhje me ndonjë incident ose aksident serioz të lidhur me operimin e një balone.

BOP.ADD.030 Sistemi i menaxhimit

a) Operatori krijon, zbaton dhe mirëmban një sistem të menaxhimit që përfshin të gjitha sa vijon:

1. Linja të përcaktuara qartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies gjatë gjithë organizimit të operatorit, duke përfshirë një përgjegjësi të drejtpërdrejtë të sigurisë të menaxherit përgjegjës;



2. Një përshkrim të filozofisë dhe parimeve të përgjithshme të operatorit në lidhje me sigurinë në operim, i cili do të njihet si politika e sigurisë në operim;

3. Identifikimin e rreziqeve të sigurisë në operim së aviacionit që vijnë nga aktivitetet e operatorit, vlerësimin e atyre rreziqeve dhe menaxhimin e rreziqeve të ndërlidhura, duke përfshirë veprimet për të zbutur ato rreziqe aty ku është e nevojshme dhe verifikimin e efektivitetit të këtyre veprimeve;

4. Mirëmbajtjen e personelit të trajnuar dhe kompetent për të kryer detyrat e tyre;

5. Dokumentimin e të gjitha proceseve kryesore të sistemit të menaxhimit, duke përfshirë procesin për ndërgjegjësimin e personelit në përgjegjësitë e tyre dhe procedurën për ndryshimin e dokumentacionit;

6. Një funksion për të monitoruar përpunshmërinë e operatorit me kërkesat e këtij aneksi. Një monitorim i tillë i pajtueshmërisë do të përfshijë një sistem reagimi të gjetjeve për menaxherin përgjegjës të operatorit për të siguruar zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese sipas nevojës;

7. Proceset e nevojshme për të siguruar përpunshjen me kërkesat e neneve 4, 5, 6 dhe 13 të urdhrin të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë”.

b) Sistemi i menaxhimit duhet të korrespondojë me madhësinë e operatorit dhe natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tij, duke marrë parasysh rreziqet dhe risqet që lidhen me ato aktivitete.

BOP.ADD.035 Aktivitetet e kontraktuara

Kur kontraktin ndonjë pjesë të aktivitetit të tij që mbulon fushëveprimin e kësaj Rregulloreje, operatori është përgjegjës për të siguruar që organizata e kontraktuar kryen aktivitetin në përpunshje me kërkesat themelore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje. Operatori duhet, gjithashtu, të sigurojë që Autoritetit të Aviacionit Civil t’i jepet akses në organizatën e kontraktuar për të përcaktuar nëse operatori është në përpunshje me këto kërkesa.

BOP.ADD.040 Kërkesat e personelit

a) Operatori emëron një menaxher përgjegjës i cili ka autoritetin për të siguruar që të gjitha

aktivitetet që mbulojnë fushëveprimin e kësaj Rregulloreje mund të financohen dhe të kryhen në përpunshje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje. Menaxheri përgjegjës është përgjegjës për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi efektiv të menaxhimit.

b) Operatori duhet:

1. Të identifikojë përgjegjësitë e personelit të tij për të gjitha detyrat dhe aktivitetet që duhet të kryhen;

2. Të ketë personel të mjaftueshëm të kualifikuar për të kryer këto detyra dhe aktivitete; dhe

3. Të mbajë të dhëna të përshtatshme për përvojën, kualifikimin dhe trajnimin e personelit të tij.

c) Operatori emëron një ose më shumë persona përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha fushave në vijim:

1. Operimet në fluturimit;

2. Operimet në tokë;

3. Vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, në përpunshje me urdhrin e ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”.

BOP.ADD.045 Kërkesat për objektin

Operatori duhet të ketë mjete/objekte të mjaftueshme për të lejuar kryerjen dhe menaxhimin e të gjitha detyrave dhe aktiviteteve të kërkuara për të siguruar përpunshjen me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

Seksioni 2

Deklarata, vlefshmëria ajrore dhe qiraja e njomë dhe e thatë

BOP.ADD.100 Deklarata

a) Në deklaratën e përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 3(2), operatori duhet të konfirmojë që operatori respekton dhe do të vazhdojë të përmbushë kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.



1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje;

b) Operatori duhet të përfshijë në deklaratë të gjitha informacionet e mëposhtme:

1. Emrin e operatorit;

2. Vendin ku operatori ka vendin e tij kryesor të biznesit;

3. Emrin dhe detajet e kontaktit të menaxherit përgjegjës të operatorit;

4. Datën e fillimit të operimit tregtar dhe, sipas rastit, datën në të cilën ndryshimi i një operimi ekzistues tregtar hyn në fuqi;

5. Në lidhje me të gjitha balonat e përdorura për veprimtarinë tregtare, llojin e balonës, regjistrimin, bazën kryesore, llojin e operimit dhe organizatën e menaxhimit të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore.

c) Kur është e zbatueshme, operatori duhet t'i bashkëngjisë deklaratës listën e mjeteve alternative të përputhshmërisë (AltMoC), në përputhje me pikën BOP.ADD.010;

d) Gjatë kryerjes së deklaratës, operatori duhet të përdorë formularin që gjendet në shtojcën e këtij aneksi.

BOP.ADD.105 Ndryshimet në deklarimin dhe ndërprerjen e operimeve tregtare

a) Operatori duhet të njoftojë pa vonesë Autoritetin e Aviacionit Civil për çdo ndryshim në rrethanat që ndikojnë në përputhjen e tij me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje, siç është deklaruar tek autoriteti përkatës dhe të çdo ndryshimi në lidhje me informacionin referuar pikës BOP.ADD.100(b) dhe listën e AltMoC-ve të referuara në pikën BOP.ADD.100 (c), siç janë përfshirë ose bashkangjitur deklaratës.

b) Operatori duhet të njoftojë pa vonesë Autoritetin e Aviacionit Civil kur nuk është më i angazhuar në operime tregtare me balona.

BOP.ADD.110 Kërkesat e vlefshmërisë ajrore

Balonat duhet të kenë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore të lëshuar në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit

mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, ose, në rastin e një balone të regjistruar në një vend tjetër, do të jetë subjekt i një marrëveshje qiraje të njomë ose një marrëveshje qiraje të thatë, në përputhje me pikën BOP.ADD.115.

BOP.ADD.115 Qiraja e njomë dhe qiraja e thatë e një balone të regjistruar në një vend tjetër

a) Operatori duhet të njoftojë Autoritetin e Aviacionit Civil për çdo marrëveshje qiraje të njomë ose marrëveshje të qirasë së thatë, në lidhje me një balonë të regjistruar në një vend tjetër.

b) Kur një balonë e regjistruar në një vend tjetër i nënshtrohet një marrëveshjeje qiraje të njomë, operatori duhet të sigurojë që niveli i sigurisë në operim që rezulton nga zbatimi i standardeve të sigurisë në lidhje me vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore dhe operimet ajrore, të cilat operatori i vendit tjetër të balonës i zbaton, është të paktën ekuivalent me atë që rezulton nga zbatimi i kërkesave të aneksit I të urdhrin të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”. Një operator i BE-së nuk ka nevojë të demonstrojë ekuivalencën e nivelit të sigurisë.

c) Kur një balonë e regjistruar në një vend tjetër i nënshtrohet një marrëveshjeje të qirasë së thatë, operatori duhet të sigurojë përputhjen me kërkesat thelbësore që lidhen me vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të përcaktuara në anekset II dhe V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje. Një operator i BE-së nuk ka nevojë të demonstrojë ekuivalencën e nivelit të sigurisë.

Seksioni 3

Manualet dhe dokumentet

BOP.ADD.200 Manuali i operimeve

a) Operatori duhet të krijojë një manual operimesh.

b) Përmbytja e manualit të operimit duhet të pasqyrojë kërkesat të përcaktuara në këtë aneks dhe



nuk duhet të bjerë ndesh me asnjë informacion të përfshirë në deklaratën e operatorit.

c) Manuali i operimeve mund të krijohet si pjesë e veçantë.

d) I gjithë personeli i operatorit duhet të ketë një lehtësi përdorimi në pjesët e manualit të operimeve që kanë lidhje me detyrat e tyre.

e) Manuali i operimeve duhet të jetë i përditësuar. I gjithë personeli i operatorit do të njoftohet për çdo ndryshim të manualit të operimeve që është i rëndësishëm për kryerjen e detyrave të tyre.

f) Operatori duhet të sigurojë që çdo informacion i përdorur si bazë për përmbajtjen e manualit të operimeve dhe çdo ndryshim i tyre të pasqyrohet në mënyrë korrekte në manualin e operimeve.

g) Operatori duhet të sigurojë që i gjithë personeli të jetë në gjendje të kuptojë gjuhën në të cilën janë shkruar ato pjesë të manualit të operimeve që kanë lidhje me detyrat e tyre. Përmbajtja e manualit të operimeve duhet të paraqitet në një formë që mund të përdoret pa vështirësi.

BOP.ADD.205 Regjistrimi i të dhënave

a) Operatori duhet të krijojë një sistem të mbajtjes së të dhënave që lejon ruajtjen e saktë dhe gjurmueshmërinë e besueshme të aktivitetëve të tij.

b) Format i regjistrimeve duhet të përcaktohet në procedurat ose manualet e operatorit.

Seksioni 4

Ekuipazhi i fluturimit

BOP.ADD.300 Përbërja e ekuipazhit të fluturimit

a) Përbërja e ekuipazhit të fluturimit duhet të jetë, minimalisht, siç specifikohet në AFM ose kufizimet operative të përshkruara për balonat.

b) Ekuipazhi i fluturimit duhet të përfshijë anëtarë shtesë të ekuipazhit të fluturimit kur kërkohet nga lloji i operimit. Numri i ekuipazhit të fluturimit nuk duhet të jetë më i vogël se numri i specifikuar në manualin e operimeve.

c) Të gjithë anëtarët e ekuipazhit të fluturimit duhet të kenë një licencë dhe kategorizime të lëshuara ose pranuar në përputhje me aneksin III të kësaj Rregulloreje dhe të përshtatshme për detyrat që u janë caktuar atyre.

d) Anëtarët e ekuipazhit të fluturimit gjatë fluturimit mund të zëvendësohen në detyrat e tyre,

nga një anëtar tjetër i ekuipazhit përshtatshëmish i kualifikuar.

e) Gjatë angazhimit të shërbimeve të anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit të cilët punojnë në baza të pavarura ose me orar të pjesshëm, operatorit duhet të verifikojë nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat e mëposhtme:

1. Kërkesat e kësaj nënpyese;

2. Aneksi III i kësaj Rregulloreje duke përfshirë kërkesat për përvojën e fundit;

3. Kufizimet kohore dhe kërkesat e pushimit dhe të kufizimit të orëve të punës të fluturimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë, si legjislacioni i vendit ku operatorit ka vendin kryesor të biznesit, duke marrë parasysh të gjitha shërbimet e kryera nga anëtarët e ekuipazhit të fluturimit tek operatorët e tjerë.

BOP.ADD.305 Përcaktimi si pilot në komandë

a) Operatori duhet të caktojë një pilot në mesin e ekuipazhit të fluturimit si pilot në komandë.

b) Operatori duhet të caktojë vetëm një pilot për të vepruar si pilot në komandë nëse ai:

1. Është i kualifikuar për të vepruar si pilot në komandë në përputhje me aneksin III të kësaj Rregulloreje;

2. Ka nivelin minimal të përvojës të specifikuar në manualin e operimeve; dhe

3. Ka njohuri të përshtatshme për zonën ku do të fluturojë.

BOP.ADD.310 Ofrimi i trajnimit dhe kontrollit

Të gjitha trajnimet dhe kontrollet e anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit të kërkuara sipas pikës BOP.ADD.315 duhet të sigurohen si më poshtë:

a) Në përputhje me programet e trajnimit dhe programet e përcaktuara nga operatorit në manualin e operimeve;

b) Nga personat e kualifikuar dhe, për sa i përket trajnimit dhe kontrollit të fluturimit, nga personat e kualifikuar në përputhje me aneksin III të kësaj Rregulloreje.

BOP.ADD.315 Trajnimi dhe kontrolli periodik

a) Çdo anëtar i ekuipazhit të fluturimit duhet të përfundojë çdo 2 vjet trajnime të përsëritura në fluturimit dhe në tokë që lidhen me klasën e balonës në të cilën ai/ajo operon, duke përfshirë trajnimin për vendndodhjen dhe përdorimin e të gjitha pajisjeve emergjente dhe të sigurisë në operim.



b) Çdo anëtar i ekuipazhit të fluturimit duhet të kryejë kontrollet e aftësisë së operatorit për të demonstruar kompetencën e tij në kryerjen e procedurave normale, anormale dhe emergjente, duke mbuluar aspektet përkatëse që lidhen me detyrat e specializuara të përshkruara në manualin e operimeve. Gjatë kryerjes së këtyre kontrolleve, duhet të merren parasysh anëtarët e ekuipazhit të cilët ndërmarrin operime nën VFR gjatë natës.

c) Kontrolli i aftësisë së operatorit duhet të jetë i vlefshëm për 24 muaj kalendarikë, duke llogaritur nga fundi i muajit gjatë së cilës kontrolli është kryer ose, në rast se kontrolli kryhet brenda 3 muajve të fundit të periudhës së vlefshmërisë së kontrollit të mëparshëm, nga dita e fundit e periudhës së vlefshmërisë së atij kontrolli të mëparshëm.

Seksioni 5

Kërkesat e përgjithshme të operimit

BOP.ADD.400 Përgjegjësitë e pilotit në komandë

Piloti në komandë duhet të përmbushë të dyja këto pika që vijojnë:

a) Kërkesat përkatëse të skemës së raportimit të ngjarjes së operatorit të referuar në pikën BOP.ADD.025;

b) Të gjitha kufizimet kohore të fluturimit dhe të punës dhe kërkesat e pushimit të zbatueshme për aktivitetet e tij ose të saj në përputhje me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë, si legjislacioni i vendit ku operatori ka vendin kryesor të operimit.

BOP.ADD.405 Autoriteti i pilotit në komandë

Pavarësisht nga pika BOP.BAS.035, operatori duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar që të gjithë personat e transportuar në balonë t'u binden të gjitha komandave të ligjshme të dhëna nga piloti në komandë me qëllim të garantimit të sigurisë në operim të balonës, ose mallrave të ngarkuar në të, apo të ndonjë personi ose pronësie në tokë.

BOP.ADD.410 Anëtar i shtesë i ekuipazhit të balonës

Kur një balonë mbart më shumë se 19 pasagjerë, duhet të jetë së paku një anëtar shtesë i ekuipazhit, përveç ekuipazhit të fluturimit siç kërkohet në përputhje me shkronjat (a) dhe (b) të pikës BOP.ADD.300 për të ndihmuar pasagjerët në rast

emergjence. Ky anëtar shtesë i ekuipazhit duhet të ketë përvojë dhe trajnim të përshtatshëm.

BOP.ADD.415 Përshtatshmëri fizike në lidhje me zhytjen në thellësi në ujë dhe dhurimin e gjakut

Anëtarët e ekuipazhit nuk do të kryejnë asnjë detyrë në balonë kur gjendja e tyre fizike mund të jetë dëmtuar pas zhytjes në thellësi të ujit ose pas dhurimit të gjakut.

BOP.ADD.420 Gjuha e përbashkët

Operatori duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët e ekuipazhit mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në një gjuhë të përbashkët.

BOP.ADD.425 Substancat psikoaktive

Operatori duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar që asnjë person nuk do të hyjë ose nuk është në një balonë kur është nën ndikimin e substancave psikoaktive në masën që siguria në operim e balonës, e çdo personi ose pronësie të transportuar aty ose të ndonjë personi apo pronësie në terren mund të rrezikohet nga prania e atij personi.

BOP.ADD.430 Rrezikimi

Operatori duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar që asnjë person, me dashje, pa dashje ose me pakujdesi, të veprojë ose të mos veprojë me një nga pasojat e mëposhtme:

a) të rrezikojë një balonë ose person në të ose në tokë;

b) të shkaktojë ose lejojë një balonë të rrezikojë çdo person ose pronësi.

BOP.ADD.435 Dokumentet, manualët dhe informacioni që do të mbahen

a) Të gjitha dokumentet, manualët dhe informacionet e mëposhtme mbahen në çdo fluturim si origjinale ose kopje:

1. Deklarata e bërë nga operatori;

2. Informacioni në lidhje me shërbimet e kërkim-shpëtimit për zonën e fluturimit të synuar;

3. Plani operacional i fluturimit.

b) Të gjitha dokumentet, manualët dhe informatat vijuese duhet të mbahen në një vend të sigurt, jo në balonë gjatë fluturimit, si origjinale:

1. Dokumentet, manualët dhe informacionet e përmendura në shkronjën (a), kur kopjet e tyre mbahen në bordin e balonës gjatë një fluturimi;

2. Pjesët aktuale të manualit të operimeve ose procedurat standarde të operimit (SOP) që kanë të bëjnë me detyrat e anëtarëve të ekuipazhit, të cilat duhet të jenë lehtësisht të arritshme për ta;



3. Listat e pasagjerëve, kur transportohen pasagjerët;

4. Dokumentacioni lidhur me masën e llogaritur të përmendur në shkronjën (c) të pikës BOP.ADD.600.

c) Kur kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, piloti në komandë ose operatori duhet t'i vërë në dispozicion atij dokumentet origjinale, manualët dhe informacionin brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, që nuk duhet të jetë më pak se 24 orë.

BOP.ADD.440 Mallrat e rrezikshme

Operatori duhet:

a) Të vendosë procedurat për të siguruar që të gjitha masat e arsyeshme janë marrë për të parandaluar që mallrat e rrezikshme të transportohen pa dashje në bordin e balonës; dhe

b) T'u sigurojë anëtarëve të ekuipazhit informacionin e nevojshëm që u mundëson atyre që të kryejnë në mënyrë adekuate detyrat e tyre, në lidhje me mallrat e rrezikshme të transportuara ose që synojnë të mbahen në bordin e balonave.

Seksioni 6

Procedurat e operimit

BOP.ADD.500 Llogaritjet e karburantit ose balastit

Operatori duhet të sigurojë që llogaritjet në lidhje me karburantin rezervë ose kundërpeshat janë të dokumentuara në një plan fluturimi operacional.

BOP.ADD.505 Transporti i kategorive të veçanta të pasagjerëve

Operatori duhet të përcaktojë procedurat për transportimin e personave që kërkojnë kushte, ndihmë ose pajisje të posaçme kur mbahen në një balonë nën kushte të cilat garantojnë sigurinë e balonës dhe të çdo personi ose pronësie të transportuar në të.

BOP.ADD.510 Operimet e specializuara të balonave tregtare – Procedurat standarde të operimit

Pavarësisht nga pika BOP.BAS.190:

a) Para fillimit të një operimi të specializuar të balonave tregtare, operatori duhet të kryejë një

vlerësim të riskut, duke vlerësuar kompleksitetin e operimit të synuar, në mënyrë që të përcaktojë rreziqet dhe risqet që lidhen me operimin dhe të vendosë masat mitiguese kur është e nevojshme.

b) Bazuar në vlerësimin e riskut, operatori duhet, përpara fillimit të operacionit të specializuar të balonave tregtare, të vendosë procedurat standarde të operimit (SPO) të përshtatshme për operimin e synuar dhe balonën e përdorur. SPO-të ose do të jenë pjesë e manualit të operateve, ose do të shtjellohen në një dokument të veçantë. Operatori do të rishikojë dhe do të përditësojë rregullisht SPO-të kur është e nevojshme, për të marrë në konsideratë në mënyrë adekuate vlerësimin e riskut.

c) Operatori duhet të sigurojë që operimet e specializuara të balonave komerciale të kryhen në përputhje me SPO-të.

Seksioni 7

Performanca dhe kufizimet e operimit

BOP.ADD.600 Sistemi për përcaktimin e masës

a) Operatori duhet të krijojë një sistem që specifikon se si të gjitha pikat e mëposhtme janë përcaktuar saktë për secilin fluturim, në mënyrë që piloti në komandë të mund të verifikojë se kufizimet e AFM-së janë në përputhje me:

1. Peshën/masën e balonës së zbrazët;
2. Masën e ngarkesës së trafikut;
3. Masën e ngarkesës së karburantit ose peshat e balastit;
4. Masën e ngritjes;
5. Ngarkimin e balonës, të kryer nën mbikëqyrjen e pilotit në komandë ose personelit të kualifikuar;
6. Përgatitjen dhe disponimin e të gjithë dokumentacionit.

b) Llogaritja e masës e bazuar në llogaritjet elektronike duhet të jetë e rëprodhueshme nga piloti në komandë.

c) Dokumentacioni i masës, duke specifikuar pikat e renditura në shkronjën (a), duhet të përgatitet para çdo fluturimi dhe të dokumentohet në një plan fluturimi operacional.



SHTOJCË

DEKLARATA

Në përputhje me urdhrin e ministrit nr.____, datë _____.2024, për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”

Operatori

Emri:

Vendi ku operatori ka vendin kryesor të biznesit:

Emri dhe detajet e kontaktit të menaxherit përgjegjës:

Operimi me balonë

Data e fillimit të operimit tregtar dhe, sipas rastit, data e ndryshimit në operimin ekzistues tregtar

Informacioni mbi balonat e përdorura, operimin/et tregtar dhe menaxhimin e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore: (¹)

Lloji i balonave	Regjistrimi i balonave	Baza kryesore	Lloji/et i operimit (²)	Organizata e menaxhimit të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore (³)

Aty ku është e zbatueshme, lista e AltMoC-ve me referenca në AMC-në e lidhur (shtojca e kësaj deklarate):

Deklarata

☐ Operatori është në përputhje dhe do të vazhdojë të jetë në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e urdhrin të ministrit nr.____, datë _____.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”. Në veçanti, operatori kryen operimet e tij tregtare në përputhje me kërkesat e mëposhtme të nënpjesës ADD të aneksit II të urdhrin të ministrit nr.____, datë _____.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”.

☐ Dokumentacioni i sistemit të menaxhimit, duke përfshirë manualin e operimeve, përputhet me kërkesat e nënpjesës ADD dhe të gjitha fluturimet do të kryhen në përputhje me dispozitat e manualit të operimeve, siç kërkohet nga pika BOP.ADD.005(b) e nënpjesës ADD.

☐ Të gjitha balonat e operuara ose kanë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore të lëshuar në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, ose plotësojnë kërkesat specifike të vlefshmërisë ajrore të zbatueshme për balonat që janë të regjistruar në një vend të tretë dhe janë subjekt i një marrëveshjeje qiraje të njomë ose i një marrëveshjeje qiraje të thatë, siç kërkohet nga pikat BOP.ADD.110 dhe BOP.ADD.115(b) dhe (c) të nënpjesës ADD.

☐ Të gjithë anëtarët e ekuipazhit të fluturimit kanë një licencë dhe vlerësime të lëshuara ose të pranuar në përputhje me aneksin III të urdhrin të ministrit nr.____, datë _____.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”, siç kërkohet nga pika BOP.ADD.300(c) e nënpjesës ADD.

☐ Operatori njofton Autoritetin e Aviacionit Civil për çdo ndryshim në rrethana që ndikojnë në pajtueshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e urdhrin të ministrit nr.____, datë _____.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”, siç janë deklaruar tek



Autoriteti i Aviacionit Civil nëpërmjet kësaj deklarate dhe çdo ndryshimi në informacionin dhe listat e AltMoC-ve të përfshira dhe të aneksuara në këtë deklaratë, siç kërkohet nga pika BOP.ADD.105(a) e nënpjesës ADD.

☐ Operatori konfirmon që të gjitha informacionet e përfshira në këtë deklaratë, duke përfshirë anekset e saj, janë të plota dhe të sakta.

Data, emri dhe nënshkrimi i menaxherit përgjegjës

(¹)

Plotësoni tabelën. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të renditur informacionin, ai do të renditet në një shtojcë të veçantë. Shtojca do të përmbajë datën dhe do të nënshkruhet.

(²)

“Lloji/et i operimit” i/u referohet llojit/eve të operimeve tregtare të kryera me balonën.

(³)

Informacioni rreth organizatës përgjegjëse për menaxhimin e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore duhet të përfshijë emrin e organizatës, adresën dhe referencën e miratimit.

ANEKSI III KËRKESAT PËR LICENCIMIN E EKUIPAZHIT TË FLUTURIMIT ME BALONA [PART-BFCL]

NËNPJESA GEN KËRKESAT E PËRGJITHSHME

BFCL.001 Fushëveprimi

Ky aneks përcakton kërkesat për lëshimin e licencës së pilotit të balonave (“BPL”) dhe privilegjet, klasifikimet dhe certifikatat përkatëse, si dhe kushtet për vlefshmërinë dhe përdorimin e tyre.

BFCL.005 Autoriteti kompetent

Kur Republika e Shqipërisë është vendi në të cilin një person aplikon për lëshimin e një BPL-je ose privilegjeve, klasifikimeve ose certifikatave të lidhura me to, për qëllimin e këtij aneksi, autoritet kompetent do të jetë Autoriteti i Aviacionit Civil.

BFCL.010 Klasat dhe grupet e balonave

Për qëllime të këtij aneksi, balonat do të kategorizohen në klasat dhe grupet e mëposhtme:

a) Klasa e “balonave me ajër të nxehtë”:

1. Grupi A: kapaciteti i zarfit deri në 3 400 m³ (120 069 ft³);

2. Grupi B: kapaciteti i zarfit midis 3 401 m³ (120 070 ft³) dhe 6 000 m³ (211 888 ft³);

3. Grupi C: kapaciteti i zarfit midis 6 001 m³ (211 889 ft³) dhe 10 500 m³ (370 804 ft³);

4. Grupi D: kapaciteti i zarfit më shumë se 10 500 m³ (370 804 ft³);

b) Klasa “balonë me gaz”;

c) Klasa “balonë e përzier”;

d) Klasa “balonë me ajër të nxehtë”.

BFCL.015 Aplikimi për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e një BPL-je, si dhe privilegjeve, vlerësimeve dhe certifikatave të lidhura

a) Një aplikim do t'i dorëzohet Autoritetit të Aviacionit Civil në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ai për sa vijon:

1. Lëshimin e një BPL-je dhe vlerësimet përkatëse;

2. Zgjerimin e privilegjeve të një BPL-je;

3. Lëshimin e një certifikate instruktori fluturimi (për balonat) (FI(B));

4. Lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e një certifikate të ekzaminuesit të fluturimit (për balonat) (FE(B)); dhe

5. Çdo ndryshim në BPL dhe privilegjet përkatëse, certifikatat e vlerësimit.

b) Një aplikim i specifikuar në shkronjën (a) duhet të shoqërohet me dëshmi që aplikanti përmbush kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë aneks dhe në aneksin IV (pjesa MED) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”.

c) Çdo kufizim ose zgjerim i privilegjeve të dhëna nga një licencë, klasifikim ose certifikatë miratohet në licencë ose certifikatë nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

d) Një person nuk duhet të mbajë në asnjë moment më shumë se një BPL të lëshuar në përputhje me këtë aneks.

e) Një mbajtës i licencës duhet t'i paraqesë aplikimet siç specifikohet në shkronjën (a) tek Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili ka lëshuar ndonjë nga licencat e tij/të saj, në përputhje me këtë aneks



(pjesa BFCL) ose aneksin I (pjesa FCL) të urdhrat të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, ose aneksit III (pjesa SFCL) të rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave, në përputhje me rregulloren bazë mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një agjencie evropiane të sigurisë së aviacionit”, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së BE-së nr. 2018/1976, sipas rastit.

f) Kur është e zbatueshme, një mbajtës i BPL-së mund të aplikojë për një ndryshim të autoritetit kompetent tek autoriteti kompetent i caktuar nga një shtet anëtar i BE-së, por në këtë rast autoriteti i ri kompetent do të jetë i njëjtë për të gjitha licencat e mbajtura.

g) Aplikantët aplikojnë për lëshimin e një BPL-je dhe vlerësimet, privilegjet ose certifikatat përkatëse jo më vonë se 6 muaj, pasi të kenë përfunduar me sukses testin e aftësive ose vlerësimin e kompetencës.

BFCL.030 Testi praktik i aftësive

Me përjashtim të testit të aftësive për vlerësimin e operimeve tregtare siç specifikohet në pikën BFCL.215, një aplikant për një test aftësie duhet të rekomandohet për testin nga ATO ose DTO që është përgjegjëse për trajnimin e ndërmarrë nga aplikantët, pasi trajnimi të ketë përfunduar. Të dhënat e trajnimit i vihen në dispozicion ekzaminuesit nga ATO ose DTO.

BFCL.035 Kreditimi i kohës së fluturimit

Aplikantët për një BPL ose një privilegj, vlerësim ose certifikatë të lidhur kreditohen plotësisht me të gjitha udhëzimet solo, dyshe ose kohën e fluturimit PIC në balona në lidhje me kërkesën e një kohe totale fluturimi për licencën, privilegjin, vlerësimin ose certifikatën.

BFCL.045 Detyrimi për të mbajtur dhe paraqitur dokumente

a) Kur ushtrojnë privilegjet e licencës BPL, mbajtësit e BPL-së duhet të mbajnë të gjitha sa vijon:

1. Një BPL të vlefshme;
2. Një certifikatë të vlefshme mjekësore;
3. Një dokument identifikimi personal që përmban fotografinë e tij;
4. Të dhëna të mjaftueshme të regjistrat/ditarit për të demonstruar përputhjen me kërkesat e këtij aneksi.

b) Studentët pilotë duhet të mbajnë në të gjitha fluturimet solo:

1. Dokumentet e specifikuara në paragrafët (a) (2) dhe (a) (3); dhe

2. Dëshmi të autorizimit të kërkuar nga pika BFCL.125(a).

c) Mbajtësit e BPL-së ose pilotët studentë do të paraqesin pa vonesë të panevojshme dokumentet e specifikuara në shkronjën (a) ose (b) për inspektim me kërkesë të një përfaqësuesi të autorizuar të Autoritetit të Aviacionit Civil.

BFCL.050 Regjistrimi i kohës së fluturimit

Mbajtësit e BPL-së dhe pilotët studentë duhet të mbajnë një regjistër të besueshëm të detajeve të të gjitha fluturimeve të kryera në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

BFCL.065 Reduktimi i privilegjeve të mbajtësve të BPL-së të moshës 70 vjeç e lart në fluturimin tregtar me balonë të pasagjerëve

Mbajtësit e BPL-së që kanë mbushur moshën 70 vjeç nuk do të veprojnë si pilotë të një balone të angazhuar në operimet tregtare të balonave me pasagjerë.

BFCL.070 Kufizimi, pezullimi ose revokimi i licencave, privilegjeve, klasifikimeve dhe certifikatave

a) Një BPL, si dhe privilegjet, klasifikimet dhe certifikatat përkatëse të lëshuara në përputhje me këtë aneks mund të kufizohen, pezullohen ose revokohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në aneksin VI (pjesa ARA) të urdhrat të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, nëse një mbajtës BPL nuk përputhet me kërkesat thelbësore të përcaktuara në Aneksin IV të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, ose me kërkesat e këtij aneksi, si dhe të aneksit II (pjesë BOP) të kësaj Rregulloreje ose të aneksit IV (pjesa MED) të urdhrat të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”.

b) Mbajtësit e BPL-së duhet t’ia kthejnë menjëherë licencën ose certifikatën Autoritetit të Aviacionit Civil, nëse licenca, privilegji, klasifikimi



ose certifikata e tyre është kufizuar, pezulluar ose revokuar.

NËNPJESA BPL LICENCA E PILOTT TË BALONËS (BPL)

BFCL.115 BPL – Privilegjet dhe kushtet

a) Privilegjet e një mbajtësi BPL janë të veprojë si PIC në balona:

1. Pa shpërblim në operimet jotregtare;
2. Në operimet tregtare nëse ai zotëron një vlerësim të operimit tregtar në përputhje me pikën BFCL.215 të nënpjesës ADD të këtij aneksi.

b) Me përjashtim të paragrafit (a) (1), një mbajtës BPL që ka privilegje instruktori ose ekzaminuesi mund të marrë shpërblim për:

1. Ofrimin e instruksioneve të fluturimit për BPL-në;
2. Kryerjen e testeve të aftësive dhe kontrolleve të aftësisë për BPL-në;
3. Trajnimin, testimin dhe kontrollin për privilegjet, vlerësimet dhe certifikatat e bashkangjitura me një BPL-je.

c) Mbajtësit e BPL-së do të ushtrojnë privilegjet e BPL-së vetëm nëse janë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të kohëzgjatjes dhe vetëm nëse certifikata e tyre mjekësore, e përshtatshme për privilegjet e ushtruara, është e vlefshme.

BFCL.120 BPL – Mosha minimale

Aplikantët për një BPL duhet të jenë të paktën 16 vjeç.

BFCL.125 BPL – Studenti pilot

a) Studentët pilot nuk duhet të fluturojnë solo, përveç kur autorizohen për ta bërë këtë dhe mbikëqyrën nga një instruktor fluturimi për balona (FI(B)).

b) Studentët pilot duhet të jenë të paktën 14 vjeç për t'u lejuar në fluturime solo.

BFCL.130 BPL – Kërkesat për kursin e trajnimit dhe përvojën

Aplikantët për një BPL duhet të përfundojnë një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO. Kursi do të përshtatet me privilegjet e kërkuara dhe do të përfshijë:

a) njohuritë teorike, siç specifikohet në pikën BFCL.135(a);

b) të paktën 16 orë instruksion fluturimi në balona me ajër të nxehtë që përfaqësojnë grupin A të asaj klase, ose balona me gaz, duke përfshirë të paktën:

1. 12 orë instruksion fluturimi dyshe;
2. 10 fryrje dhe 20 ngritje dhe ulje; dhe
3. Një fluturim i vetëm/solo të mbikëqyrur me një kohë fluturimi prej të paktën 30 minutash.

BFCL.135 BPL – Provimi i njohurive teorike

a) Njohuritë teorike

Aplikantët për një BPL duhet të demonstrojnë një nivel njohurish teorike që është i përshtatshëm për privilegjet e kërkuara përmes provimeve në sa vijon:

1. Lëndë të përbashkëta:

- i. ligji i ajrit;
- ii. performanca njerëzore;
- iii. meteorologjia;
- iv. komunikimet; dhe

2. Tema specifike në lidhje me balonat:

- i. parimet e fluturimit;
- ii. procedurat operative;
- iii. performanca dhe planifikimi i fluturimit;
- iv. njohuri të përgjithshme të avionit në lidhje me balonat; dhe
- v. lundrimi.

b) Përgjegjësitë e aplikantit:

1. Aplikanti do të marrë të gjithë grupin e provimeve të njohurive teorike për BPL-në nën përgjegjësinë e Autoritetit të Aviacionit Civil.

2. Aplikanti do të marrë provimin e njohurive teorike vetëm nëse rekomandohet nga ATO ose DTO që është përgjegjëse për trajnimin e tij dhe pasi ai të ketë përfunduar elementet e duhura të kursit të trajnimit të udhëzimit të njohurive teorike në një standard të kënaqshëm.

3. Rekomandimi nga ATO ose DTO do të jetë i vlefshëm për 12 muaj. Nëse aplikanti ka dështuar të marrë të paktën provimin e njohurive teorike brenda kësaj periudhe vlefshmërie, nevoja për trajnim të mëtejshëm do të përcaktohet nga ATO ose DTO, bazuar në nevojat e aplikantit.

c) Standardet kaluese:

1. Një kalim me sukses i provimit të njohurive teorike do t'i jepet aplikantit nëse ai ka arritur të paktën 75% të pikëve të caktuara për atë provim. Nuk do të aplikohet penalitet.

2. Nëse nuk specifikohet ndryshe në këtë aneks, një aplikant konsiderohet se ka përfunduar me sukses provimin e njohurive teorike të kërkuara për BPL-në, nëse ai ose ajo ka kaluar të gjitha provimet e kërkuara të njohurive teorike brenda një periudhe prej 18 muajsh të llogaritur nga fundi i muajit



kalendari, kur aplikanti u përpoq për herë të parë të merrte provimin.

3. Nëse një aplikant ka dështuar të kalojë një nga provimet e njohurive teorike brenda katër përpjekjeve ose ka dështuar të kalojë të gjitha provimet brenda periudhës së përmendur në pikën 2, ai duhet të rimarrë të gjitha provimet e njohurive teorike.

4. Përpara rimarrjes së provimeve të njohurive teorike, aplikanti do të kryejë trajnime të mëtejshme në një ATO ose një DTO. ATO-ja ose DTO-ja do të përcaktojnë shtrirjen dhe qëllimin e trajnimit, bazuar në nevojat e aplikantit.

d) Periudha e vlefshme

Provimi i njohurive teorike do të jetë i vlefshëm për një periudhë prej 24 muajsh të llogaritur nga dita kur aplikanti ka përfunduar me sukses provimin e njohurive teorike, në përputhje me paragrafin (c) (2).

BFCL.140 BPL – Kreditimi i njohurive teorike

Aplikantët për lëshimin e një BPL do të kreditohen për kërkesat e njohurive teorike për lëndët e zakonshme, siç specifikohet në pikën BFCL.135(a)(1) nëse ata:

a) mbajnë një licencë në përputhje me aneksin I (pjesa FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, ose aneksin III (pjesa SFCL) të rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave, në përputhje me rregulloren bazë mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një agencie evropiane të sigurisë së aviacionit, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së BE-së nr. 2018/1976; ose

b) kanë kaluar provimet e njohurive teorike për një licencë siç përcaktohet në shkronjën (a), për sa kohë që kjo bëhet brenda periudhës së vlefshmërisë të përcaktuar në pikën BFCL.135(d).

BFCL.145 BPL – Testi praktik i aftësive

a) Aplikantët për një BPL duhet të demonstrojnë përmes përfundimit të një testi aftësie aftësinë për të kryer, si PIC në një balonë, procedurat dhe manovrat përkatëse me kompetencë të përshtatshme për privilegjet e kërkuara.

b) Aplikantët duhet të kryejnë testin e aftësive në të njëjtën klasë të balonave në të cilën është përfunduar kursi i trajnimit në përputhje me pikën BFCL.130 dhe, në rastin e balonave me ajër të

nxehtë, në një balonë që përfaqëson grupin A të asaj klase.

c) Për të marrë një test aftësie për lëshimin e një BPL-je, aplikanti së pari duhet të kalojë provimin e kërkuar të njohurive teorike.

d) Standardet kaluese:

1. Testi i aftësisë do të ndahet në seksione të ndryshme, që përfaqësojnë të gjitha fazat e ndryshme të një fluturimi me balonë.

2. Dështimi në ndonjë artikull të një seksioni do të bëjë që aplikanti të dështojë të gjithë seksionin. Nëse aplikanti dështon vetëm në një seksion, ai ose ajo do të përsërisë vetëm atë pjesë. Dështimi në më shumë se një seksion do të kërkojë që aplikanti të ribëjë të gjithë testin.

3. Nëse aplikanti duhet të bëjë përsëri testin, në përputhje me pikën 2 dhe dështon në ndonjë seksion, duke përfshirë ato seksione që kanë kaluar në një përpjekje të mëparshme, aplikanti duhet të rimarrë të gjithë testin.

e) Nëse aplikanti nuk arrin të kalojë në të gjitha seksionet e testit brenda dy përpjekjeve, ai do të marrë trajnim të mëtejshëm praktik.

BFCL.150 BPL – Shtrirja e privilegjeve në një klasë ose grup tjetër të balonave

a) Privilegjet e BPL-së kufizohen në klasën e balonave në të cilën është kryer testi i aftësisë siç specifikohet në pikën BFCL.145, dhe, në rastin e balonave me ajër të nxehtë, në grupin A të asaj klase.

b) Në rastin e balonave me ajër të nxehtë, privilegjet e BPL-së shtrihen në një grup tjetër brenda klasës së balonave me ajër të nxehtë pas aplikimit nëse një pilot ka plotësuar të paktën:

1. Dy fluturime udhëzuese me një FI(B) në një balonë të grupit përkatës;

2. Sasia e mëposhtme e orëve të kohës së fluturimit si PIC në balona:

i. të paktën 100 orë, nëse kërkohen privilegje për balonat e grupit B;

ii. të paktën 200 orë, nëse kërkohen privilegje për balonat e grupit C;

iii. të paktën 300 orë, nëse kërkohen privilegje për balonat e grupit D.

c) Me përjashtim të klasës së balonave të përzier, privilegjet e BPL shtrihen në një klasë tjetër të balonave, ose, nëse kërkohen privilegje për klasën e balonave me ajër të nxehtë, në grupin A të klasës së balonave me ajër të nxehtë, me aplikim nëse një pilot ka përfunduar në klasën dhe grupin përkatës të balonave:



1. Një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO, duke përfshirë të paktën:

- i. pesë fluturime dyfshe udhëzuese; ose
- ii. në rastin e një zgjatjeje nga balonat me ajër të nxehtë në ato me ajër të nxehtë, pesë orë kohë dyshe instruksioni; dhe

2. një test aftësie gjatë të cilit piloti i ka demonstruar FE(B) një nivel adekuat të njohurive teorike për klasën tjetër në lëndët e mëposhtme:

- i. parimet e fluturimit;
- ii. procedurat operative;
- iii. performanca dhe planifikimi i fluturimit;
- iv. njohuri të përgjithshme të avionit në lidhje me klasën e balonave për të cilën kërkohet zgjerimi i privilegjeve.

d) Përfundimi i trajnimit siç specifikohet në paragrafët (b) (1) dhe (c) (1) regjistrohet në ditarin/regjistrin e pilotit dhe nënshkruhet nga:

1. Në rastin e paragrafit (b)(1), instruktori që është përgjegjës për fluturimet instruksionale; dhe

2. Në rastin e paragrafit (c)(1), drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose të DTO-së që është përgjegjës për trajnimin.

e) Një mbajtës BPL ushtron privilegjet e tij në klasën e balonave të përziera vetëm nëse ai ka privilegje si për klasën e balonave me ajër të nxehtë ashtu edhe për klasën e balonave me gaz.

BFCL.160 BPL – Kërkesat e kohëve të fundit

a) Një mbajtës BPL ushtron privilegjet e licencës së tij vetëm nëse ai ka përfunduar në klasën përkatëse të balonave:

1. Ose:

i. brenda 24 muajve të fundit përpara fluturimit të planifikuar, të paktën gjashtë orë kohë fluturimi si PIC, duke përfshirë 10 ngritje dhe ulje, si PIC ose fluturime dyshe ose solo nën mbikëqyrjen e një FI(B)-je; dhe

ii. brenda 48 muajve të fundit përpara fluturimit të planifikuar, të paktën një fluturim stërvitor me një FI(B); ose

2. Brenda 24 muajve të fundit përpara fluturimit të planifikuar, një kontroll aftësie në përputhje me shkronjën (c).

b) Përveç kërkesave në shkronjën (a), në rastin e një piloti i cili është i kualifikuar për të fluturuar më shumë se një klasë balonash, për të ushtruar privilegjet e tij në klasën tjetër të balonave ose në klasat e tjera të balonave, ai duhet të ketë kryer të paktën tri orë kohë fluturimi, si PIC ose fluturim dyshe ose solo nën mbikëqyrjen e një FI(B)-je, në

çdo klasë shtesë të balonave brenda 24 muajve të fundit.

c) Një mbajtës BPL, i cili nuk përmbush kërkesat në paragrafin (a) (1) dhe, nëse është e aplikueshme, (b), përpara se të rifillojë ushtrimin e privilegjeve të tij, duhet të kalojë një kontroll aftësie me një FE(B) në një balonë që përfaqëson klasën përkatëse.

d) Pas pajtueshmërisë me shkronjat (a), (b) ose (c), sipas rastit, një mbajtës BPL me privilegje për të fluturuar me balona me ajër të nxehtë do të ushtrojë privilegjet e tij vetëm në balona me ajër të nxehtë që përfaqësojnë:

i. të njëjtin grup balonash me ajër të nxehtë në të cilin është përfunduar fluturimi stërvitor siç specifikohet në paragrafin (a) (1) (ii) ose kontrolli i aftësisë siç specifikohet në shkronjën (c), sipas rastit, ose një grup me një madhësi më të vogël të zarfit; ose

ii. grupin A të balonave me ajër të nxehtë në rastet kur një pilot, në përputhje me paragrafin (b), ka përfunduar fluturimin stërvitor siç specifikohet në paragrafin (a)(2) në një klasë balonash të ndryshme nga balonat me ajër të nxehtë.

e) Përfundimi i fluturimeve dyshe, fluturimet nën mbikëqyrje dhe fluturimi stërvitor, siç specifikohet në paragrafin (a) (1) dhe (b), si dhe kontrolli i aftësisë, siç specifikohet në shkronjën (c) regjistrohen në ditarin/regjistrin e pilotit dhe nënshkruhen nga, në rastin e paragrafëve (a)(1) dhe (b), FI(B) përgjegjës dhe, në rastin e shkronjes (c), FE(B) përgjegjës.

f) Një mbajtës BPL, i cili gjithashtu ka privilegjet për operimet tregtare siç specifikohet në pikën BFCL.215 të nënpjesës ADD të këtij aneksi, konsiderohet se është në përputhje me kërkesat e:

1. Shkronjës (a) dhe, nëse është e zbatueshme, (b), në rast se ai ka kryer një kontroll aftësie në përputhje me pikën BFCL.215(d)(2)(i) në klasën ose klasat përkatëse të balonave brenda 24 muajve të fundit; ose

2. Paragrafit (a)(1)(ii), në rast se ai ka përfunduar fluturimin stërvitor, siç specifikohet në pikën BFCL.215(d)(2)(ii) në klasën përkatëse të balonave.

Në rastin e klasës së balonave me ajër të nxehtë, kufizimet e specifikuara në shkronjën (d), në lidhje me privilegjet për të përdorur klasa të ndryshme të balonave, zbatohen, në varësi të klasës së balonave të përdorura për përputhjen me paragrafët (f) (1) ose (f)(2).

NËNPJESA ADD
VLERËSIMET SHITESË**BFCL.200 Vlerësimi i fluturimit me balonë të lidhur me ajër të nxehtë**

a) Një mbajtës BPL do të ndërmarrë fluturime me balonë të lidhur me ajër të nxehtë vetëm nëse ai ka një klasifikim të fluturimit me balonë të lidhur me ajër të nxehtë në përputhje me këtë pikë.

b) Për të aplikuar për vlerësimin e fluturimit me balonë të lidhur me ajër të nxehtë, aplikanti duhet:

1. Të ketë privilegje për klasën e balonave me ajër të nxehtë;

2. Së pari të kryejë të paktën dy fluturime udhëzuese për balonë të lidhur me ajër të nxehtë.

c) Përfundimi i trajnimit me balonë të lidhur me ajër të nxehtë duhet të shënohet në ditar dhe të nënshkruhet nga FI(B) i cili është përgjegjës për trajnimin.

d) Një pilot që ka një klasifikim të fluturimit me balonë të lidhur me ajër të nxehtë ushtron privilegjet e tij vetëm nëse ai ka kryer të paktën një fluturim me balonë të lidhur me ajër të nxehtë gjatë 48 muajve para fluturimit të planifikuar, ose nëse ai ka pa kryer një fluturim të tillë, piloti ushtron privilegjet e tij nëse ka kryer një fluturim me balonë të lidhur me ajër të nxehtë duke fluturuar dyshe ose solo nën mbikëqyrjen e një FI(B)-je. Përfundimi i një fluturimi të tillë dyshe ose solo nën mbikëqyrje regjistrohet në ditarin/regjistrin e pilotëve dhe nënshkruhet nga FI(B).

BFCL.210 Vlerësimi gjatë natës

a) Një mbajtës BPL ushtron privilegjet e licencës së tij në kushte VFR gjatë natës vetëm nëse ai ka një vlerësim nate në përputhje me këtë pikë.

b) Një aplikant për vlerësimin gjatë natës duhet të ketë kryer të paktën dy fluturime udhëzuese gjatë natës me të paktën një orë secili.

c) Përfundimi i trajnimit të vlerësimit gjatë natës duhet të shënohet në ditar/regjister dhe të nënshkruhet nga FI(B) i cili është përgjegjës për trajnimin.

BFCL.215 Vlerësimi i operimit tregtar

a) Një mbajtës BPL ushtron privilegjet e licencës së tij gjatë operimeve tregtare me balona vetëm nëse ai mban një vlerësim të operimit tregtar në përputhje me këtë pikë.

b) Një aplikant për një vlerësim të operimit tregtar duhet:

1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;

2. Të ketë përfunduar 50 orë kohë fluturimi dhe 50 ngritje dhe ulje si PIC në balona;

3. Të ketë privilegjet për klasën e balonave në të cilën do të ushtrohen privilegjet e klasifikimit të operimeve tregtare; dhe

4. Të ketë kaluar një test aftësie në klasën përkatëse të balonave gjatë së cilës ai duhet t'i demonstrojë një FE(B)-je kompetencën e kërkuar për operimet tregtare të balonave.

c) Privilegjet e klasifikimit të operimit tregtar kufizohen në klasën e balonës në të cilën është përfunduar testi i aftësisë në përputhje me paragrafin (b) (3). Privilegjet shtrihen me aplikim në një klasë tjetër balonash nëse, në atë klasë tjetër, aplikanti është në përputhje me paragrafin (b) (3) dhe (b) (4).

d) Një pilot që ka një vlerësim të operimit tregtar ushtron privilegjet e atij klasifikimi në balonat tregtare të pasagjerëve vetëm nëse ai ka plotësuar:

1. Brenda 180 ditëve para fluturimit të planifikuar:

i. të paktën tri fluturime si PIC në balona, nga të cilat të paktën një do të jetë në një balonë të klasës përkatëse; ose

ii. një fluturim si PIC në një balonë të klasës përkatëse nën mbikëqyrjen e një FI(B)-je që është kualifikuar në përputhje me këtë pikë; dhe

2. Brenda 24 muajve para fluturimit të planifikuar:

i. një kontroll aftësie, në një balonë të klasës përkatëse, gjatë së cilës ai duhet t'i demonstrojë një FE(B)-je kompetencën e kërkuar për fluturimin me balonë tregtare të pasagjerëve; ose

ii. një kurs rifreskimi në një ATO ose një DTO, i përshtatur me kompetencën e kërkuar për operimet tregtare të balonave, duke përfshirë të paktën gjashtë orë instruksione të njohurive teorike dhe një fluturim trajnimi në një balonë të klasës përkatëse me një FI(B), i cili është i kualifikuar për operimet tregtare të balonave në përputhje me këtë pikë.

e) Për të ruajtur privilegjet e klasifikimit të operimit tregtar për të gjitha klasat e balonave, një pilot që ka një vlerësim të operimit tregtar me privilegje të shtrira në më shumë se një klasë balonash, duhet të jetë në përputhje me kërkesat në paragrafin (d)(2) në të paktën një klasë të balonave.

f) Një pilot që pajtohet me shkronjën (d) dhe ka një vlerësim tregtar operimi për klasën e balonave me ajër të nxehtë, ushtron privilegjet e atij klasifikimi



në klasën e balonave me ajër të nxehtë vetëm në balona që përfaqësojnë:

i. të njëjtin grup të balonës me ajër të nxehtë në të cilin është përfunduar kontrolli i aftësisë, siç specifikohet në paragrafin (d)(2)(i) ose fluturimi stërvitor siç specifikohet në paragrafin (d)(2)(ii); ose

ii. një grup balonash me ajër të nxehtë me një madhësi më të vogël zarfi.

g) Përfundimi i fluturimit nën mbikëqyrje, siç specifikohet në paragrafin (d)(1)(ii), kontrolli i aftësisë, siç specifikohet në paragrafin (d)(2)(i) dhe kursi i trajnimit rifreskues, siç specifikohet në paragrafin (d)(2)(ii) shënohet në ditarin/regjistrin e pilotit dhe nënshkruhet nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së, ose FI(B)-së ose FE(B)-së që është përgjegjës për kursin e trajnimit, mbikëqyrjen ose kontrollin e aftësisë, sipas rastit.

h) Një pilot që ka kryer një kontroll të aftësisë së operatorit në përputhje me pikën BOP.ADD.315 të aneksit II (pjesa BOP) të kësaj rregulloreje konsiderohet se është në përputhje me paragrafin (d)(2)(i).

NËNPJESA FI INSTRUKTORËT E FLUTURIMIT

Seksioni 1 Kërkesat e përgjithshme

BFCL.300 Certifikatat e instruktorit të fluturimit

a) Të përgjithshme

Një instruktor do të kryejë instruksione fluturimi në një balonë, vetëm nëse ai:

1. Mban:

i. një BPL duke përfshirë privilegjet, vlerësimet dhe certifikatat për të cilat duhet të sigurohen instruksionet e fluturimit; dhe

ii. një certifikatë të instruktorit të fluturimit me balonë (FI(B)) e përshtatshme për instruksionin e kryer dhe e lëshuar në përputhje me këtë nënpjesë; dhe

2. Ka të drejtë të veprojë si PIC në balonë gjatë instruksionit të fluturimit.

b) Instruksionet e ofruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Me përjashtim të nënparagrafit (a)(1), në rastin e instruksioneve të fluturimit të ofruara gjatë një kursi trajnimi të miratuar në përputhje me këtë aneks (pjesa BFCL) jashtë territorit për të cilin Republika e

Shqipërisë është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i lëshojë një certifikatë instruktori fluturimi një aplikanti që zotëron një licencë pilotimi me balonë që është në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos, me kusht që aplikanti:

i. zotëron të paktën një licencë, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, privilegje, vlerësime ose certifikata të barasvlershme me ato për të cilat ai ose ajo është i autorizuar të udhëzojë;

ii. përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë nënpjesë për lëshimin e certifikatës FI(B) me privilegjet përkatëse udhëzuese; dhe

iii. i tregon Autoritetit të Aviacionit Civil një nivel të mjaftueshëm njohurish për rregullat në fuqi të sigurisë së operimeve të aviacionit për të qenë në gjendje të ushtrojë privilegjet e tij të instruksionit në përputhje me këtë aneks.

2. Certifikata do të kufizohet në ofrimin e instruksioneve të miratuara të fluturimit:

i. jashtë territorit për të cilin Shqipëria është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos; dhe

ii. për një student pilot që ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës në të cilën jepet instruksioni për fluturim.

Seksioni 2 Certifikata e instruktorit të fluturimit për balona – FI(B)

BFCL.315 Certifikata FI(B) – Privilegjet dhe kushtet

a) Në varësi të pajtueshmërisë së aplikantëve me pikën BFCL.320 dhe me kushtet e mëposhtme, një certifikatë FI(B) lëshohet me privilegje për të kryer instruksione fluturimi për:

1. Një BPL;

2. Shtirjen e privilegjeve në klasat dhe grupet e mëtejshme të balonave me kusht që aplikanti të ketë kryer të paktën 15 orë kohë fluturimi si PIC në secilën klasë përkatëse;

3. Një vlerësim gjatë natës ose një vlerësim fluturimi të lidhur, me kusht që aplikanti të ketë marrë trajnim specifik në ofrimin e instruksioneve për vlerësimin përkatës në një ATO ose në një DTO; dhe

4. Një certifikatë FI(B), me kusht që aplikanti:

i. të ketë kryer të paktën 50 orë instruksione fluturimi në balona; dhe



ii. në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ketë kryer të paktën një orë instruksion fluturimi për certifikatën FI(B) nën mbikëqyrjen dhe bindjen e një FI(B)-je i cili është kualifikuar në përputhje me këtë nënparagraf dhe emërohet nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së.

b) Privilegjet e renditura në shkronjën (a) përfshijnë privilegjet për të kryer instruksione fluturimi për:

1. Lëshimin e licencës, privilegjeve, vlerësimeve ose certifikatës përkatëse; dhe

2. Rivlerësimin, rinovimin ose përputhjen me kërkesat përkatëse të kohëzgjatjes së këtij Aneksi, sipas rastit.

BFCL.320 FI(B) – Parakushtet dhe kërkesat

Aplikantët për një certifikatë FI(B) duhet:

a) të jenë së paku 18 vjeç;

b) të jenë në përputhje me kërkesat e nënparagrafëve (a) (1) (i) dhe (a) (2) të pikës BFCL.300;

c) të kenë përfunduar 75 orë kohë fluturimi me balonë si PIC;

d) të kenë përfunduar një kurs trajnimi për instruktorë në përputhje me pikën BFCL.330 në një ATO ose një DTO; dhe

e) të kenë kaluar vlerësimin e kompetencës në përputhje me pikën BFCL.345.

BFCL.325 FI(B) kompetencat dhe vlerësimi

Aplikantët për një certifikatë FI(B) trajnohen për të arritur kompetencat e mëposhtme:

a) përgatitjen e burimeve;

b) krijimin e një klime të favorshme për të mësuar;

c) njohuritë aktuale;

d) integrimi i menaxhimit të kërcënimeve dhe gabimeve (TEM) dhe menaxhimit të burimeve të ekuipazhit (CRM);

e) menaxhimi i kohës për të arritur objektivat e trajnimit;

f) lehtësimi i mësimi;

g) vlerësimi i performancës së praktikantit;

h) monitorimi dhe rishikimi i progresit;

i) vlerësimi i seancave të trajnimit; dhe

j) raportimi i rezultatit.

BFCL.330 FI(B) – Kursi i trajnimit

a) Aplikantët për një certifikatë FI(B), së pari duhet të kalojnë një vlerësim specifik para hyrjes në një ATO ose një DTO brenda 12 muajve para

fillimit të kursit të trajnimit, për të vlerësuar aftësinë e tyre për të ndjekur kursin.

b) Kursi i trajnimit FI(B) përfshin të paktën:

1. Elementet e specifikuar në pikën BFCL.325;

2. 25 orë mësimdhënie dhe mësimnxënie;

3. 12 orë mësim të njohurive teorike, duke përfshirë testet e progresit; dhe

4. 3 orë instruksion fluturimi, duke përfshirë tri ngritje dhe ulje.

c) Aplikantët që tashmë kanë një certifikatë instruktori në përputhje me aneksin III (pjesa SFCL) të rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave në përputhje me rregulloren bazë mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një agjencie evropiane të sigurisë së aviacionit, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së BE-së nr. 2018/1976,

ose me aneksin I (pjesa FCL) të urdhrat të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, kreditohen plotësisht për kërkesa në paragrafin (b) (2).

BFCL.345 FI(B) – Vlerësimi i kompetencës

a) Aplikantët për lëshimin e një certifikate FI(B) duhet të kalojnë një vlerësim të kompetencës në një balonë për t’i demonstruar një ekzaminuesi të kualifikuar, në përputhje me pikën BFCL.415(c) aftësinë për të udhëzuar një student pilot në nivelin e kërkuar për lëshimin e një BPL-je.

b) Vlerësimi do të përfshijë:

1. Demonstrimin e kompetencave të përshkruara në pikën BFCL.325 gjatë mësimi para fluturimit, pas fluturimit dhe njohurive teorike;

2. Provimet teorike me gojë në tokë, informime/*briefings* para dhe pas fluturimit, dhe demonstrime gjatë fluturimit në klasën e duhur të balonave;

3. Ushtrime adekuate për të vlerësuar kompetencat e instruktorit.

Certifikata BFCL.360 FI(B) – Kërkesat për nivelin e përditësimit

a) Një mbajtës i certifikatës FI(B) do të ushtrojë privilegjet e certifikatës së tij, vetëm nëse ai ka plotësuar:

1. Brenda tre vjetëve të fundit përpara ushtrimit të planifikuar të këtyre privilegjeve:

i. trajnimin për rifreskimin e instruktorëve në një ATO, një DTO, ose një autoritet kompetent gjatë të



cilit mbajtësi do të marrë udhëzime teorike të njohurive për rifreskimin dhe përditësimin e njohurive të rëndësishme për instruktorët e balonave;

ii. të paktën 6 orë instruksione fluturimi në balona si FI(B); dhe

2. Brenda nëntë vjetëve të fundit dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim nga Autoriteti i Aviacionit Civil, një fluturim udhëzues në një balonë si FI(B) nën mbikëqyrjen dhe bindjen e një FI(B)-je, i cili është kualifikuar në përputhje me pikën BFCL.315(a)(4) dhe emërohet nga drejtuesi i trajnimit të një ATO-je ose një DTO-je.

b) Orët e fluturimit si FE(B) gjatë testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë ose vlerësimeve të kompetencës do të kreditohen plotësisht në përputhje me kërkesën në paragrafin (a) (1) (ii).

c) Nëse një mbajtës i certifikatës FI(B) ka dështuar në përfundimin e fluturimit udhëzues nën mbikëqyrjen dhe bindjen e FI(B)-së në përputhje me paragrafin (a)(2), ai nuk do të ushtrojë privilegjet e certifikatës FI(B) derisa ai të ketë përfunduar me sukses një vlerësim të kompetencës në përputhje me pikën BFCL.345.

d) Për të rifilluar ushtrimin e privilegjeve të certifikatës FI(B), një mbajtës i certifikatës FI(B) që nuk përmbush të gjitha kërkesat e shkronjës (a) do të përmbushë kërkesat e paragrafit (a) (1) (i) dhe të pikës BFCL.345.

NËNPJESA FE EKZAMINUESIT E FLUTURIMIT

Seksioni 1 Kërkesat e përgjithshme

BFCL.400 Certifikatat e ekzaminuesit të fluturimit me balona

a) Të përgjithshme

Një ekzaminues do të kryejë teste aftësish, kontrolle të aftësisë ose vlerësime të kompetencës në përputhje me këtë ANEKS vetëm nëse ai:

1. Mban:

i. një BPL që përfshin privilegjet, vlerësimet dhe certifikatat për të cilat ai është i autorizuar të kryejë teste aftësish, kontrolle të aftësisë ose vlerësime të kompetencës, dhe privilegjet për t'i instruktuar ato;

ii. një certifikatë FE(B) që përfshin privilegjet e përshtatshme për testin e aftësive, kontrollin e

aftësisë ose vlerësimin e kompetencës të kryer, të lëshuar në përputhje me këtë nënpjesë;

2. Ka të drejtë të veprojë si PIC në një balonë gjatë testit të aftësive, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës.

b) Provimet e kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Me përjashtim të paragrafit (a) (1), në rastin e testeve të aftësive dhe kontrolleve të aftësisë të kryera jashtë territorit për të cilin Republika e Shqipërisë është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i lëshojë një certifikatë ekzaminuesi një aplikanti që zotëron një licencë pilotimi me balonë që është në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos, me kusht që aplikanti:

i. zotëron të paktën një licencë, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, privilegje, vlerësime ose certifikata të barasvlershme me to për të cilat ai është i autorizuar të kryejë teste aftësish ose kontrolle aftësie;

ii. përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë nënpjesë për lëshimin e certifikatës përkatëse të ekzaminuesit;

iii. i tregon Autoritetit të Aviacionit Civil një nivel të mjaftueshëm njohurish për rregullat evropiane të sigurisë së aviacionit për të qenë në gjendje të ushtrojë privilegjet e ekzaminuesit në përputhje me këtë aneks.

2. Certifikata e përmendur në pikën 1 kufizohet në kryerjen e testeve të aftësive dhe kontrolleve të aftësisë:

i. jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; dhe

ii. për një pilot që ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës në të cilën ofrohet testi/kontrolli.

BFCL.405 Kufizimi i privilegjeve në rast të interesave të fituara

Ekzaminuesi i balonave nuk duhet të kryejë:

a) një test aftësie ose vlerësim të kompetencës së një aplikanti për lëshimin e një licence, vlerësimi ose certifikate, të cilit ai i ka dhënë më shumë se 50% të instruksioneve të kërkuara të fluturimit për licencën, vlerësimin ose certifikatën për të cilën testi i aftësive ose vlerësimi i kompetencës është marrë; ose

b) një test aftësie, kontroll aftësie ose vlerësim të kompetencës sa herë që ai mendon se objektiviteti i tij mund të ndikohet.

**BFCL.410 Kryerja e testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë dhe vlerësimeve të kompetencës**

a) Gjatë kryerjes së testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë dhe vlerësimeve të kompetencës, një ekzaminues i balonës duhet të bëjë të gjitha sa vijon:

1. Të sigurojë që komunikimi me aplikantin të mund të vendoset pa pengesa gjuhësore;

2. Të verifikojë që aplikanti përmbush të gjitha kërkesat e kualifikimit, trajnimit dhe përvojës të këtij aneksi për lëshimin, rivlerësimin ose rinovimin e licencës, privilegjeve, vlerësimit ose certifikatës për të cilën është kryer testi i aftësisë, kontrolli i aftësisë ose vlerësimi i kompetencës; dhe

3. Të ndërgjegjësojë aplikantin për pasojat e dhënies së informacionit jo të plotë, të pasaktë ose të rremë në lidhje me përvojën e tij të trajnimit dhe fluturimit.

b) Pas përfundimit të testit të aftësive, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës, ekzaminuesi i balonës duhet:

1. Të informojë aplikantin për rezultatet e testit të aftësive, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës;

2. Në rast të kalimit në një vlerësim të kompetencës për rivlerësimin ose rinovimin, të miratojë datën e re të skadencës në licencën ose certifikatën e aplikantit, nëse autorizohet në mënyrë specifike për këtë qëllim nga autoriteti kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit;

3. T'i sigurojë aplikantit një raport të nënshkruar të testit të aftësisë, të kontrollit të aftësisë ose të vlerësimit të kompetencës dhe t'i dorëzojë pa vonesë të panevojshme kopjet e raportit autoritetit kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit dhe autoritetit kompetent që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit. Raporti përfshin:

i. një deklaratë se ekzaminuesi i balonave ka marrë informacion nga aplikanti, në lidhje me përvojën dhe instruktimin e tij dhe ka konstatuar se përvoja dhe instruktimi përputhen me kërkesat e zbatueshme të këtij Aneksi;

ii. konfirmimin se janë kryer të gjitha manovrat dhe ushtrimet e kërkuara, si dhe informacionin për provimin me gojë të njohurive teorike, kur është e mundur; nëse një pjesë ka dështuar, ekzaminuesi regjistron arsyet për këtë vlerësim;

iii. rezultatet e testit të aftësive, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës;

iv. një deklaratë se ekzaminuesi i balonës ka shqyrtuar dhe zbatuar procedurat kombëtare dhe kërkesat e autoritetit kompetent të aplikantit nëse autoriteti kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit;

v. një kopje të certifikatës së ekzaminuesit të balonave që përmban fushëveprimin e privilegjeve të tij si ekzaminues i balonës në rastin e testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë ose vlerësimeve të kompetencës së një aplikanti, autoriteti kompetent i të cilit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit;

c) Ekzaminuesi i balonave do të mbajë të dhënat për pesë vjet me detaje të të gjitha testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë dhe vlerësimeve të kompetencës së kryer dhe rezultateve të tyre.

d) Me kërkesë të autoritetit kompetent që është përgjegjës për certifikatën e ekzaminuesit të balonave, ose autoritetit kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit, ekzaminuesi i balonave duhet të dorëzojë të gjitha shënimet dhe raportet, si dhe çdo informacion tjetër, sipas nevojës, për aktivitetet e mbikëqyrjes.

Seksioni 2**Certifikata e ekzaminuesit të fluturimit për balona – FE(B)****Certifikata BFCL.415 FE(B) – Privilegjet dhe kushtet**

Në varësi të pajtueshmërisë së aplikantit me pikën BFCL.420 dhe me kushtet e mëposhtme, një certifikatë FE(B) lëshohet pas aplikimit me privilegje për të kryer:

a) Testet e aftësive dhe kontrollet e aftësisë për BPL dhe testet e aftësive për shtrirjen e privilegjeve në një klasë tjetër balonash, me kusht që aplikanti të ketë kryer 250 orë kohë fluturimi si pilot në balona, duke përfshirë 50 orë instruksionesh të fluturimit që mbulojnë planprogramin e plotë të një kursi trajnimi BPL;

b) Testet e aftësive dhe kontrollet e aftësisë për vlerësimin e operimit tregtar siç specifikohet në pikën BFCL.215, me kusht që aplikanti të përmbushë kërkesat e përvojës të përcaktuara në paragrafin (a) dhe të ketë marrë trajnim specifik gjatë një kursi standardizimi ekzaminues në përputhje me pikën BFCL.430;



c) Vlerësimet e kompetencës për lëshimin e një certifikate FI(B), me kusht që aplikanti të ketë:

1. Përfunduar 350 orë kohë fluturimi si pilot në balona, duke përfshirë 5 orë instruktim për një aplikant për certifikatën FI(B);

2. Marrë trajnim specifik gjatë një kursi standardizimi ekzaminues në përputhje me pikën BFCL.430.

Certifikata BFCL.420 FE(B) – Parakushtet dhe kërkesat

Aplikantët për një certifikatë FE(B) duhet:

a) të jenë në përputhje me kërkesat e nënparagrafëve (a) (1) (i) dhe (2) të pikës BFCL.400;

b) të kenë përfunduar kursin e standardizimit FE(B) në përputhje me pikën BFCL.430;

c) të kenë përfunduar një vlerësim të kompetencës në përputhje me pikën BFCL.445;

d) të demonstrojnë historikun përkatës në lidhje me privilegjet e certifikatës FE(B); dhe

e) të demonstrojnë se ata nuk u janë nënshtruar asnjë sanksioni, duke përfshirë pezullimin, kufizimin ose revokimin e ndonjë prej licencave, klasifikimeve ose certifikatave të tyre të lëshuara në përputhje me këtë aneks, me aneksin I (pjesa FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, ose me aneksin III (pjesa SFCL) të rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave, në përputhje me rregulloren bazë mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një agjencie evropiane të sigurisë së aviacionit”, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së BE-së nr. 2018/1976, për mospërputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të tij gjatë tre vjetëve të fundit.

BFCL.430 Certifikata FE(B) – Kursi i standardizimit

a) Aplikantët për një certifikatë FE(B) do të ndjekin një kurs standardizimi, i cili ofrohet ose nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga një ATO ose një DTO dhe miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Kursi i standardizimit i përshtatet privilegjeve të kërkuara të ekzaminuesit të fluturimit me balonë dhe do të përbëhet nga udhëzime teorike dhe praktike, duke përfshirë të paktën:

1. Kryerjen e të paktën një testi aftësie, kontrolli të aftësisë ose vlerësimi të kompetencës për BPL-në ose vlerësimet ose certifikatat përkatëse;

2. Udhëzimet për kërkesat e zbatueshme të këtij aneksi dhe kërkesat e zbatueshme të operimeve ajrore, kryerjen e testeve të aftësive, kontrollin e aftësisë dhe vlerësimet e kompetencës, si dhe dokumentacionin dhe raportimin e tyre;

3. Një përmbledhje për sa vijon:

i. procedurat administrative kombëtare;

ii. kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale;

iii. përgjegjësinë e ekzaminuesit;

iv. sigurimin e aksidentit të ekzaminuesit;

v. tarifatat kombëtare; dhe

vi. informacionin mbi mënyrën e aksesit në informacionin e përfshirë në pikat (i) deri (v) gjatë kryerjes së testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë ose vlerësimeve të kompetencës së një aplikanti, autoriteti kompetent i të cilit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit.

c) Një mbajtës i certifikatës FE(B) nuk do të kryejë teste aftësish, kontrole aftësie ose vlerësime të kompetencës së një aplikanti, autoriteti kompetent i të cilit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit, përveç nëse ai ka shqyrtuar informacionin më të fundit të disponueshëm që përmban procedurat përkatëse kombëtare të autoritetit kompetent të aplikantit.

BFCL.445 Certifikata FE(B) – Vlerësimi i kompetencës

Një aplikant për lëshimin fillestar të një certifikate FE(B) duhet të demonstrojë kompetencat e tij si FE(B) te një inspektor nga Autoriteti i Aviacionit Civil, ose te një ekzaminues i lartë i autorizuar në mënyrë specifike për ta bërë këtë nga Autoriteti i Aviacionit Civil që është përgjegjës për certifikatën FE(B). Gjatë vlerësimit të kompetencës, aplikanti do të kryejë një test aftësie, kontroll të aftësisë ose vlerësim të kompetencës, duke përfshirë informimin, zhvillimin e testit të aftësisë, kontrollin e aftësisë ose vlerësimin e kompetencës dhe vlerësimin e personit të cilit i bëhet testi, kontrollin ose vlerësimin, raportimin dhe regjistrimin e dokumentacionit.

Certifikata BFCL.460 FE(B) – Vlefshmëria, rivlerësimi dhe rinovimi

a) Një certifikatë FE(B) është e vlefshme për pesë vjet.

b) Një certifikatë FE(B) rivlerësohet nëse mbajtësi i saj:



1. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës FE(B), ka përfunduar një kurs rifreskues të ekzaminuesit, i cili ofrohet ose nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga një ATO ose një DTO dhe i miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil gjatë të cilit mbajtësi do të marrë udhëzime teorike të njohurive për rifreskim dhe përditësimin e njohurive të rëndësishme për ekzaminuesit e balonave; dhe

2. Brenda 24 muajve të fundit para përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës, ka kryer një test aftësie, kontroll të aftësisë ose vlerësim të kompetencës nën mbikëqyrjen dhe bindjen e një inspektori nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose një ekzaminuesi i autorizuar posaçërisht për ta bërë këtë nga Autoriteti i Aviacionit Civil që është përgjegjës për certifikatën FE(B).

c) Një mbajtës i certifikatës FE(B) i cili gjithashtu zotëron një ose më shumë certifikata ekzaminuesi për kategori të tjera avionësh në përputhje me aneksin I (pjesa FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, ose me aneksin III (pjesa SFCL) të rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave në përputhje me rregulloren bazë mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një agjencie evropiane të sigurisë së aviacionit”, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së BE-së nr. 2018/1976, mund të arrijë rivalidimin e kombinuar të të gjitha certifikatave të ekzaminuesit të mbajtura, në marrëveshje me Autoritetin e Aviacionit Civil.

d) Nëse një certifikatë FE(B) ka skaduar, mbajtësi i saj duhet të përmbushë kërkesat e paragrafit (b)(1) dhe të pikës BFCL.445 përpara se ai të rifillojë ushtrimin e privilegjeve të certifikatës FE(B).

e) Një certifikatë FE(B) rivlerësohet ose rinovohet vetëm nëse aplikanti demonstroi pajtueshmëri të vazhdueshme me kërkesat e pikës BFCL.410, si dhe me kërkesat e pikës BFCL.420(d) dhe (e).

URDHËR

Nr. 644, datë 19.12.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datën 20.12.2024 te z. Tedi Dobi, zëvendësministër i Drejtësisë.

2. Ngarkohet zëvendësministër i Drejtësisë, z. Tedi Dobi për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR

Nr. 1083, datë 12.12.2024

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË VULËS SË MJEKËVE VETERINARË, TË CILËT USHTROJNË PROFESIONIN NË SEKTORIN VETERINAR PRIVAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 2, të nenit 109, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të vulës për mjekët veterinarë, të cilët ushtrojnë profesionin në sektorin veterinar privat, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në aneksin I, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar Shqiptar.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

ANEKS I
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË VULËS
SË MJEKËVE VETERINARË,
TË CILËT USHTROJNË PROFESIONIN NË
SEKTORIN VETERINAR PRIVAT

1. Emri i plotë i mjekut veterinar me përmasa 3.15 mm

[Emër, Mbiemër]

2. Profesioni me përmasa 3 mm

[Mjek veterinar privat]

3. Numri i certifikatës për ushtrim profesioni me përmasa 2.5 mm

[Nr. i certifikatës lëshuar nga Urdhëri Profesional i Mjekut Veterinar]

4. Togëfjalëshi Republika e Shqipërisë me përmasa 4 mm;

[Republika e Shqipërisë]

5. Togëfjalëshi UPMVSH i pozicionuar sipër logos, me përmasa 2.2 mm

[UPMVSH]

6. Logo me përmasa 86 x103 mm;

[Logoja e Urdhërit Profesional të Mjekut Veterinar Shqiptar]



7. Forma dhe madhësia e vulës

[Vula ka formë drejtkëndëshe dhe madhësia e vulës me përmasa 460 x 220 mm]

8. Teksti i përdorur brenda vulës

[Teksti i shkruar në gjuhën shqipe dhe në Fontin ROBOTO (BOLD)]

VENDIM

Nr. 00-2023-5688 (409), datë 23.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Sadushi	kryesues;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Gentian Medja	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar,

më datë 23.11.2023, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative nr. 31003-00003-00-2023, që u përket palëve:

PADITËS: Bilbil Behari.

I PADITUR: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor Privat me Përmbarrues Gjyqësor Altin Vako.

OBJEKTI: Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, urdhër të detyrueshëm, vendim për dënim me gjobë nr. 32, datë 17.12.2014, gjobë në masën 500.000 lekë.

Kundërshtimin e veprimit përmbarrimor nr. 271 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”.

Kundërshtimin e veprimit përmbarrimor nr. 272 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”.

Kundërshtimin e veprimit përmbarrimor nr. 273 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”.

Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe avokatore.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 153 e në vijim dhe nenet 517, 518, 519, 609, 610 të Kodit të Procedurës Civile.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS
SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Sokol Ngresi, shpjegimet e përfaqësueses të palës paditëse, Avokate Eda Grimci, shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore publike dhe bisedoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Ka rezultuar e provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat e faktit se prej Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (këtu e në vijim “IKMT”), me vendimin nr. 32, datë 17.12.2014, është marrë ndaj paditësit Bilbil Behari masa administrative gjobë në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, për kundërvajtjen administrative “Ndërtim tende me konstruksion druri e ndërtuar në hapësirë publike pa leje përkatëse”.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1508 akti, datë 11.11.2015, ka vendosur pranimin e kërkesës, lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin nr. 32, datë 17.12.2014, të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK, aktualisht IKMT) për subjektin fizik Bilbil Behari dhe urdhërimin e shërbimit përbarimor për zbatimin e këtij vendimi.

3. Pranë shoqërisë përbarimore, nga ana e palës së paditur IKMT është depozituar kërkesa për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendimi për dënimin me gjobë nr. 32 prot., datë 17.12.2014, së bashku me urdhrin e ekzekutimit nr. 1508 akti, datë 11.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Nga përmbajtja e shkresës nr. 160 prot., datë 19.2.2016 “Lajmërim për ekzekutimin vullnetar të detyrimit”, rezulton se përbaruesi gjyqësor privat Altin Vako ka njoftuar paditësin për përmbushjen dhe ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit kundrejt kreditorit IKMT. Për marrjen dijeni të kësaj shkrese ka nënshkruar shtetasja Lubjana Muça.

5. Më datë 7.3.2016, shoqëria përbarimore ka vijuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv dhe ka urdhëruar me urdhrin nr. 273 prot., datë 7.3.2016 vendosjen e sekuestros mbi llogaritë bankare të paditësit, me urdhrin nr. 271 prot., datë 7.3.2016, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë dhe me urdhrin nr. 272 prot., datë 7.3.2016 ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, QKR Tiranë.

6. Pala paditëse, në datë 15.3.2016 i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me padinë objekt gjykimi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, urdhër të detyrueshëm, vendim nr. 32, datë 17.12.2014, për

dënim me gjobë në masën 500.000 lekë dhe ka kundërshtuar veprimet e mësipërme përbarimore, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi nga ana e IKMT-së, në marrjen e këtij vendimi nuk është respektuar forma dhe procedura e kërkuar nga ligji, e cila, kur konstatohet, prek në thelb vendimmarrjet e shprehura në aktet administrative të nxjerra respektivisht nga IKMT-ja. Po kështu, edhe nga përbaruesi gjyqësor është tejkaluar procedura e njoftimit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit pasi nuk ka ndjekur procedurat ligjore të çështjes objekt gjykimi.

7. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2383, datë 23.3.2016, ka vendosur: “Shpalljen e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e akteve për kompetence Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

8. Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3492, datë 4.7.2016, ka vendosur: “*Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova [...]*”.

9. Gjykata ka arsyetuar në vendimin e saj se, [...]veprimi përbarimor i kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga pala paditëse Bilbil Behari, është pikërisht fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm me urdhrin nr. 271 prot., datë 7.3.2016 për vënien e sekuestros konservative drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, me urdhrin nr. 272 prot., datë 7.3.2016 për vënien e sekuestros konservative drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit QKR Tiranë dhe me urdhrin nr. 273 prot., datë 7.3.2016 për vendosjen e sekuestros mbi llogaritë bankare të paditësit prej përbaruesit gjyqësor privat Altin Vako. Nga sa më sipër rezulton se, që të jemi përpara kërkesave të nenit 610 të KPC-së për kundërshtimin e veprimeve përbarimore si një nga mjetet mbrojtëse kundër ekzekutimit të titullit ekzekutiv, duhet të plotësohen tri kushte: vetëm palët mund të bëjnë ankim kundër veprimeve të përbaruesit gjyqësor; ankimi duhet të paraqitet dhe të shqyrtohet në gjykatën e vendit të ekzekutimit; ankimi kundër veprimeve të përbaruesit gjyqësor duhet të paraqitet në gjykatën e vendit të ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit të përbaruesit gjyqësor i cili kundërshtohet, kur pala ka qenë e pranishme në kohën e kryerjes së veprimit ose brenda 5 ditëve nga dita e marrjes dijeni për veprimin e përbaruesit



gjyqësor i cili kundërshtohet, kur pala që e kundërshton atë, nuk ka qenë e pranishme në kohën e kryerjes së veprimit nga ana e përmbaruesit gjyqësor.

9.1 Nga sa më sipër, gjykata vlerëson se pala paditëse Bilbil Behari legjitimohet në paraqitjen e padisë për kundërshtim të veprimeve përmbarimore, si palë debitore në këtë procedurë ekzekutimi; padia është paraqitur më datë 15.3.2016 brenda afatit ligjor. Gjykata evidenton se veprimet përmbarimore, fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm me anë të urdhrave nr. 271, 272 dhe 273 prot., datë 7.3.2016 të përmbaruesit gjyqësor privat Altin Vako, sipas të cilave është urdhëruar vendosja e sekuestros konservative mbi llogaritë, depozitat apo kreditë e debitorëve, si dhe bllokimi i çdo dokumentacioni të pronësisë së automjeteve, nga përmbajtja e tyre janë bazuar në urdhrin e ekzekutimit nr. 1508 akti, datë 11.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9.2 Gjykata, nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit nr. 1508 akti, datë 11.11.2015 ka çmuar se vendimi i dënimit me gjobë nr. 32 prot., datë 17.12.2014 të palës së paditur IKMT është titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij përmbaruesi gjyqësor ka proceduar për lajmërimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar dhe më pas, për ekzekutimin e detyrueshëm sipas neneve 510 e vijues të KPC-së. Për sa kohë titulli ekzekutiv nuk është deklaruar i pavlefshëm me vendim gjyqësor, ai prodhon të gjitha efektet juridike dhe është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga përmbaruesi gjyqësor, ashtu siç edhe në rastin konkret ka ndodhur. Nga analiza e provave të shqyrtuara në gjykim, nuk rezultoi asnjë provë që të mbështesë pretendimet e sipërcituara të palës paditëse. Gjykata evidenton se pretendimi i palës paditëse se nuk ka njoftim për lajmërimin për ekzekutim vullnetar nuk merret në konsideratë, për shkak se njoftimi quhet i kryer sipas nenit 131 të KPC-së edhe në kushtet që nuk nënshkruhet personalisht nga paditësi, por nga rrethi i personave që kjo dispozitë parashikon.

9.3 Së fundmi, Zyra e Përmbarimit Gjyqësor Privat me përmbarues gjyqësor Altin Vako ka vepruar në përputhje me parashikimet e KPC-së për sa i përket radhës së kryerjes së veprimeve përmbarimore. Kjo pasi, referuar këtyre parashikimeve, pala e paditur, pas regjistrimit të çështjes, me kërkesë të kreditorit, i ka dërguar palës paditëse lajmërim për ekzekutim vullnetar. Pas

kalimit të afatit të parashikuar në ligj dhe pasi paditësi nuk ka vepruar për të ekzekutuar vullnetarisht titullin ekzekutiv sipas përmbajtjes e tij, atëherë ka marrë vendim për kalimin në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vijuar më pas me kryerjen e veprimeve të tjera të parashikuara në ligj dhe që mundësojnë vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv në mënyrë të detyrueshme. Ndjekja e këtyre procedurave është e detyrueshme dhe ndikon në vlefshmërinë e veprimeve të kryera. Në rastin konkret, veprimet përmbarimore objekt padie janë kryer sipas parashikimeve ligjore.

10. Kundër vendimit nr. 3492, datë 4.7.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse, Bilbil Behari, i cili ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë.

11. **Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 360, datë 12.10.2022**, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 3492 (80-2016-3490, datë 4.7.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë [...]”*.

12. Gjykata ka arsyetuar në vendimin e saj se drejt ka vlerësuar Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, kur ka konstatuar faktin se titulli ekzekutiv, vendimi nr. 32, datë 17.12.2014 i IKMT-së është një titull ekzekutiv i vlefshëm dhe se nuk jemi në asnjë prej rasteve të parashikuara nga ligji kur një titull ekzekutiv është i pavlefshëm. Ndryshe nga sa pretendon pala ankuese në ankimin e saj, vendimi i dënimit me gjobë të IKMT-së i sipërpërmendur, i është njoftuar palës paditëse dhe kjo e fundit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj atij vendimi brenda afatit kohor ligjor. Ky fakt provohet nga vendimi i datës 11.11.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet të cilit është lëshuar urdhri i ekzekutimit për këtë titull ekzekutiv. Ndryshe nga sa pretendon pala ankuese në ankimin e saj drejtuar kësaj gjykate, procesverbali nr. 1, datë 12.12.2014, “Për konstatimin e kundërvajtjes”, rezulton t’i jetë komunikuar paditësit Bilbil Behari, por ky i fundit ka refuzuar nënshkrimin e marrjes dijeni. Me refuzimin e nënshkrimit, pala paditëse konsiderohet e njoftuar dhe nuk mund të pretendojë në këto rrethana se nuk është njoftuar. Pretendimi në ankim i paditësit se akti administrativ vendimi nr. 32, datë 17.12.2014 i IKMT-së është një akt absolutisht i pavlefshëm, për shkak se është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij, pasi nxjerrija e këtij



akti ishte kompetencë e INUV-së, është një pretendim i pabazuar në ligj.

12.1 Referuar ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, nenet 9, 10/1, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, midis të tjerave, ushtron edhe përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimore e urbanistik të bashkisë, në rastet kur këta të fundit nuk i kanë ushtruar kompetencat e tyre kontrolluese në bazë të ligjit. Në të tilla rrethana, ky akt administrativ ka dalë nga organi kompetent dhe se nuk jemi në asnjë prej rasteve të pavlefshmërisë absolute të këtij akti administrativ. Pretendimi i palës ankuese se gjykata duhet të kishte patur parasysh rrethanat dhe provat e paraqitura, se arsyetimi i bërë është në interpretim totalisht të gabuar të ligjit specifik, janë pretendime të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë i ka bazuar konkluzionet e saj në provat shqyrtuara gjatë procesit gjyqësor, si dhe në ligjin specifik të cilin e ka interpretuar në mënyrë të drejtë.

13. Kundër vendimit nr. 360, datë 12.10.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, Bilbil Behari, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë. Në rekurs ndër të tjera pretendohet:

- Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë në kundërshtim me ligjin;

- Nga përmbaruesi gjyqësor privat Altin Vako është tejkualuar procedura ligjore e njoftimit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit;

- Paditësi, si rrjedhojë e moslajmërimit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, ka kërkuar pavlefshmërinë e ekzekutimit. Nga përmbaruesi gjyqësor nuk janë ndjekur procedurat ligjore sipas radhës, por është tejkualuar procedura duke kaluar në sekuestro. Për këtë arsye ne e kundërshtojmë atë si një veprim jo të ligjshëm;

- Duke iu referuar provave shkresore që na janë dhënë nga përmbaruesi gjyqësor më datë 7.3.2016, një ndër provat është dhe vendimi nr. 32, datë 17.12.2014, për dënimin me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë vendosur nga IKMT-ja (ish-INUK). Duke iu referuar dhe procesverbalit të datës 1.12.2014, i cili na është vënë në dispozicion më datë 7.3.2016 për konstatimin e kundërvajtjes, nuk kemi njoftim për këtë procesverbal nga punonjësit e INUK-ut dhe INUV, pavarësisht se në procesverbal figuron emri Bilbil Behari dhe në fund të emrit është shkruar *refuzon*, gjë që nuk është e vërtetë, pasi paditësi lokalit e ka dhënë me qira, në bazë të

kontratës së qirasë nr. 61 rep, dhe nr. 18/2 kol, lëshuar më datë 13.1.2014 para noteres Adelina K. Kareco;

- Punonjësit e IKMT-së janë paraqitur pranë lokalit më datë 12.12.2014 dhe kanë komunikuar me qiramarrësen Arta Kovaçi, duke i thënë se tenda duhet të hiqet brenda asaj dite, tendë të cilën paditësi e ka hequr po atë datë 12.12.2014. Gjatë ditës që është bërë heqja e tendës në mënyrë vullnetare dhe as në ditët në vazhdim, punonjësit e IKMT-së nuk janë paraqitur në lokal. Ndërsa, sipas vendimit, gjoba është vendosur pesë ditë më vonë dhe konkretisht më datë 17.12.2014, për të cilën jam vënë në dijeni më datë 7.3.2016 nga përmbaruesi gjyqësor privat Altin Vako;

- E drejta për t’u dëgjuar është një nga parimet kryesore që karakterizon rregullshmërinë e ekzistencës së një procesi të rregullt ligjor dhe ky parim kushtetues shtrihet në të gjitha procedurat ligjore, përfshirë edhe ato administrative;

- Në rastin konkret është vërtetuar se në nxjerrjen e këtyre akteve administrative nga palët e paditura nuk është respektuar forma dhe procedura e kërkuar nga ligji, e cila, kur konstatohet, prek në thelb vendimmarrjet e shprehura në aktet administrative të nxjerra respektivisht nga IKMT-ja;

- Akti absolutisht i pavlefshëm, që nga momenti i nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as nuk mund të krijojë pasojat juridike për të cilat është nxjerrë. Një akt i pavlefshëm nuk është akt, ai është në nulitet të plotë, aq sa nuk hyn kurrë në fuqi. Një akt i tillë nuk ka fuqi detyruese ndaj personave apo subjekteve të cilëve iu drejtohet dhe, si rrjedhojë, këta persona, ose çdo organ tjetër, mund të refuzojë drejtpërdrejt plotësimin e veprimeve që rrjedhin nga akti;

- Duke qenë të tilla dhe aktet administrative të nxjerra nga pala e paditur ndaj paditësit, ky i fundit nuk mund të përgjigjet për urdhërimet që rrjedhin nga akti, për shkak të pavlefshmërisë absolute të tyre dhe nuk mund të krijojë pasoja juridike. Konkretisht, ky vendim është marrë në kundërshtim me procedurat dhe parashikimet e dispozitave ligjore të KPA-së, neni 116, shkronja “c” e tij;

- Goditja e titullit ekzekutiv me pretendimin se ai është i pavlefshëm, detyrimi nuk ka ekzistuar ose është pakësuar apo shuar, përpara ose gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, përfshin, para se gjithash rastet kur titulli nuk ka ekzistuar apo është absolutisht i pavlefshëm, titulli ka ekzistuar, por më pas është shfuqizuar, ka humbur fuqinë ekzekutive



apo është deklaruar relativisht i pavlefshëm në një procedim administrativ, apo në një gjykim tjetër, kur pretendohet mungesa e legjitimitetit aktiv apo pasiv, sepse ekzekutimi ka filluar nga apo kundër një subjekti të ndryshëm nga ai që tregohet në titull;

- Ndërsa në rastin e vendimeve të formës së prerë, titulli ekzekutiv mund të goditet vetëm për fakte shuese apo penguese të ngjara pas marrjes formë të prerë të këtyre vendimeve, sikurse janë përmbushja, parashkrimi apo shuarja e detyrimit (debisë), falja, përzierja apo kompensimi i detyrimit, formimi i një detyrimi të ri të ndryshëm nga detyrimi original;

- Në rastin konkret, masa e gjobës së vendosur me vendim gjobë nr. 32, datë 17.12.2014, gjobë në masën 500.000 lekë të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial ka qenë e ankueshme sipas ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjen administrative”. Në këtë logjikë shkon dhe neni 30, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10279/2010, në lidhje me arkëtimin e shumave të detyrimeve të masave administrative të marra nga organet e administratës.

- Nga përmbajtja e shkronjës “b” të pikës 1 të dispozitës së mësipërme, e drejta për të kërkuar ekzekutimin e kësaj mase i lind IMKT-së, pasi vendimi i gjykatës të ketë marrë formë të prerë. Nga analiza e provave të paraqitura në gjykim rezultoi se në lidhje me komunikimin e vendimit, pala e paditur nuk paraqiti asnjë provë apo akt shkresor ku të provonte marrjen dijeni të paditësit për “Vendim për dënim me gjobë” nr. 32, datë 17.12.2014, më datë 7.3.2016. Gjithashtu, edhe për procesverbalin nr. 1, datë 12.12.2014, “Për konstatimin e kundërvajtjes”, paditësi Bilbil Behari nuk ka dijeni për këtë fakt.

- Sa më sipër, paditësi çmon se kjo shkresë përmban të dhëna jo të sakta për sa i përket njoftimit të vendimit me shkresën nr. 271, 272, 273 protokolli, datë 7.3.2016, nga përmbaruesi gjyqësor Altin Vako, urdhër për vënien e sekuestros konservative drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor të IKMT-së palës paditëse e cila, sipas shënimeve të bëra në këtë njoftim, ka refuzuar firmën, por kjo nuk provohet me dëshmitarë, siç është e përcaktuar në ligjin për kundërvajtjen administrative apo në KPA, por kjo shkresë është firmosur vetëm nga inspektorët e palës së paditur.

- Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, por edhe vendimi i Gjykatës Administrative

të Apelit, e cila ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, jo vetëm janë të paarsyetuara dhe të pambështetura në fakte e prova, por cenojnë rëndë të drejtat themelore e ligjore të paditësit, duke i mohuar të drejtën për një gjykim të drejtë në të gjitha shkallët e gjyqësorit”.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

A. Mbi nisjen e procedurës së gjykimit njëses

14. Nga aktet bashkëlidhur dosjes gjyqësore rezulton se me vendimin nr. 15196 akti, datë 2.12.2022, Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur: “*Pranimin e rekursit*” dhe nuk rezulton të jetë vënë në diskutim nëse ndaj vendimit përfundimtar të kësaj gjykate lejohet ushtrimi i rekursit në mbështetje të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

15. Kolegji konstaton se praktika e tij gjyqësore lidhur me kufizimin e së drejtës së rekursit për shkak të vlerës në paditë me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përbarimore mbi këto tituj ekzekutiv, nuk ka qenë e njëtrajtshme. Në vendimin nr. 00-2021-1850, datë 7.10.2021, ku kundërshtohet vlefshmëria e titullit ekzekutiv “Vendim dënim me gjobë” i nxjerrë prej IKMT-së dhe njëkohësisht kundërshtoheshin veprimet përbarimore, është mbajtur qëndrimi se kufizimi i së drejtës së rekursit lidhet vetëm me vlefshmërinë e aktit (titulli ekzekutiv, vendimi i dënimit me gjobë) dhe sa i përket kundërshtimit të veprimtarisë së përmbaruesit, shkaqet e parashtruara në rekurs do të duhet të shqyrtohen në themel nga ana e Kolegjit, pavarësisht vlerës së vogël të titullit ekzekutiv. Në këtë vendim Kolegji ka vlerësuar se, “*Në mosmarrëveshjen objekt gjykimi rezulton se kundërshtohet, ndër të tjera, titulli ekzekutiv, vendim gjobe nr. 29, datë 4.5.2012 në vlerë 400.000 lekë. Në kohën e ushtrimit të rekursit (datë 20.4.2017), dyzetëfishi i pagës minimale në shkallë vendi ishte në vlerë më të lartë se vlera e objektit të padisë në mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Në zbatim të VKM-së nr. 399, datë 3.5.2017 “Për përvaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga minimale në rang vendi ka qenë 24.000 (njëzet e dy mijë lekë)... Në këto kushte, Kolegji vlerëson se për pikën e parë objekt padie, shkaqet e parashtruara në rekurs nuk mund të merren në shqyrtim në juridiksionin e Gjykatës së Lartë, pasi, në kuptim të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012, vendimi nr. 2664 (86-2017-2788), datë 14.6.2017 i Gjykatës Administrative të Apelit është i paankimueshëm... Lidhur me kërkimin e dytë objekt padie, kundërshtimin e veprimeve*”



përmbartimore, Kolegji vëren se paditësi nuk ka parashtuar në rekurs asnjë pretendim konkret për të cilin kundërshton vendimmarrjen e gjykatave të faktit lidhur me veprimtarinë e përmbartuesit gjyqësor. Nga përmbajtja e rekursit rezulton se paditësi ka parashtuar se në kushtet ku padia ka për objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, nuk mund të libeshin pa u kundërshtuar edhe veprimet e përmbartuesit gjyqësor, por nuk kundërshtohet konkretisht asnjë veprim i përmbartuesit... Kolegji, nisur nga përmbajtja e kërkesëpadisë dhe shkaqet e parashtuara në rekurs, konstaton se paditësi, kundërshtimin e veprimeve përmbartimore e parashton si pasojë e kërimit të parë që lidhet me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe nuk parashton asnjë shkak ose veprim konkret që kundërshtohet përmes rekursit. Në këto kushte, lidhur me objektin e dytë të kërimit, rekursi nuk ngre shkaqe të bazuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012”

16. Në një rast tjetër të praktikës gjyqësore, vendimin nr. 00-2021-1432, datë 23.9.2021, Kolegji ka shqyrtuar kërkimin për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv “Vendim dënimi me gjobë” të nxjerrë nga Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, si dhe pretendimet për paligjshmërinë e veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, në funksion të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, duke mbajtur qëndrimin se kufizimi i së drejtës së rekursit shtrihet, jo vetëm mbi titullin ekzekutiv, por vepron edhe mbi kërkimin për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore të kryera në funksion të ekzekutimit të këtij titulli. Në këtë vendim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar midis të tjerave se, “...qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e kufizimeve të së drejtës për ankim për shkak vlerës së objektit të padisë, ka qenë shmangia e mbingarkesave të gjyqësorëve të mosmarrëveshjeve administrative me vlerë të vogël padie, duke i dhënë fund gjykimit në shkallë të parë. Çmohet se një kufizim i tillë i shërben interesit publik, efektivitetit të gjykimit administrativ, si dhe ekonomisë gjyqësore, si parim që duhet të shtrihet në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se kufizimi për shkak vlerë vepron për kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, pavarësisht faktit nëse goditet dënimi administrativ si akt administrativ apo si titull ekzekutiv pasi, në interpretim teleologjik të nenit 53, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012, qëllimi i ligjvënësit në parashikimin e këtij kufizimi ka qenë shmangia e juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë lidhur me çështje administrative, objekti i padisë së të cilave përmban një vlerë më të vogël se masa e përcaktuar në ligj”.

17. Sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se vihen re praktika të ndryshme

gjyqësore, në lidhje me çështjen nëse do të gjejë zbatim kufizimi i së drejtës së ankimit (apel/rekurs), referuar neneve 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, kur objekt i mosmarrëveshjes është “pavlefshmëria e titullit ekzekutiv dhe/ose kundërshtimi i veprimeve përmbartimore” dhe titulli ekzekutiv përfaqëson një vlerë monetare nën limitimin e parashikuar nga ligji për lejimin e ushtrimit të ankimit (apel dhe rekurs).

18. Kolegji thekson se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GJEDNJ”) në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se njëtrajtshmëria e zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike, që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (shih çështjen “Chapman v United Kingdom” vendim i GJEDNJ-së, datë 18.1.2001), duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”).

19. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me përdorueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative, duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore nomofilatike (shih çështjen “Lupaș and Others v. Romania”, ap. nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006 XV). Ajo ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të të njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ-ja ka konkluduar se ajo që përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtëm të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana: së pari, nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike; së dyti, nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe proceduralë që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë; së treti, nëse këto mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të



tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave (shih çështjen “*Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë*”, *kërkesa nr. 11260/10, seksioni i 5-të i GJEDNJ-së, vendim nr. 11.4.2019, paragrafi 40*).

20. Zbatimi i njëjtë dhe uniform i ligjit ka për qëllim të garantojë parimin e sigurisë juridike. Nga ana tjetër, nevoja për të siguruar zbatimin uniform të ligjit nuk duhet të sjellë ngurtësimin dhe kufizimin e panevojshëm të zhvillimit të ligjit dhe as të vërë në dyshim parimin e pavarësisë së gjykatës. Zbatimi i njëtrajtshëm i ligjit është esencial për garantimin e parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë të së drejtës, si pjesë e qenësishme e shtetit të së drejtës, ku qytetarët me të drejtë presin të trajtohen njësoj si të tjerët dhe të mbështeten në vendimmarrje të mëparshme për çështje të ngjashme, në funksion të parashikueshmërisë së të drejtës së tyre.

21. Paqëndrueshmëria e vendimeve gjyqësore “*në konfikt*” krijon një gjendje pasigurie, që ndikon në uljen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, i cili është një ndër elementet thelbësore në një shtet të së drejtës. Njëtrajtësia në zbatimin e ligjit kontribuon në besimin publik ndaj sistemit gjyqësor dhe rrit besimin e publikut për drejtësi (shih *Vinčić dhe të tjerë kundër Serbisë*, 44698/06, 1 dhjetor 2009).

22. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*në vijim Kolegji*), më datë 13.7.2023, pas shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës, duke shtruar për njësim pyetjen:

“Në zbatim të neneve 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, a kufizohet e drejta e ankimit/rekursit ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt ‘Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv’, si dhe për ankimin ndaj veprimeve të përmbauesit gjyqësor?”

23. Për shkak të interesit që paraqet çështja e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji, në mbështetje të nenit 62/a (7), të ligjit nr. 49/2012, kërkoi mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit për çështjen ligjore të shtruar për njësim.

24. Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 4738 prot., datë 20.9.2023, ka depozituar mendimin me shkrim, në të cilin ka mbajtur qëndrimin në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kufizimin e së drejtës së ankimit për sa i përket vlerës së titullit

ekzekutiv, i cili rrjedh nga një akt administrativ. Avokatura e Shtetit, ndër të tjera, ka parashtruar se ligjvënësi në përmbajtjen e neneve 45/a dhe 56/a të ligjit nr. 49/2012, ka përcaktuar tekstualisht pamundësinë e ushtrimit të ankimit/rekursit për kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, respektivisht me vlerë më të vogël se njëzet/dyzetfishi i pages minimale në shkallë vendi.

25. Avokatura e Shtetit ka parashtruar në qëndrimin e saj se, duke pasur parasysh këtë fakt, si dhe përmbajtjen e nenit 14/1 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, arrijmë në përfundimin se, nëse kundërvajtësi e ankimon vendimin me gjobë sipas përmbajtjes së nenit 14/1, të ligjit nr. 9780/2007, atëherë ai nuk lejohet të ushtrojë ankim/rekurs nëse gjoba është nën parashikimet ligjore të përcaktuara me nenet 45/a dhe 56/a të ligjit nr. 49/2012. Duke pasur parasysh këtë fakt, i njëjti qëndrim duhet mbajtur edhe në rastin se pranojmë që kundërvajtësi mund të kërkojë pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Kështu që kundërvajtësi nuk mund të ushtrojë ankim/rekurs, në fazën ekzekutive ndaj gjobave që janë nën parashikimet ligjore të përcaktuara me nenet 45/a dhe 56/a të ligjit nr. 49/2012.

B. Lidhur me çështjen e shtruar për njësim

B.1 Mbi paditë e ngritura në gjykimin administrativ në mbështetje të neneve 609 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile

26. Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se, në ndryshim nga gjykimi civil ku subjektet mbartës të të drejtave subjektive i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës për njohjen e kësaj të drejte të cenuar nga të tretët dhe rivendosjen e saj nëpërmjet rrugës gjyqësore, në gjykimin administrativ, mosmarrëveshja buron nga veprimtaria administrative e organeve publike, veprimtari kjo e shprehur nëpërmjet nxjerrjes së akteve administrative (individuale apo normative), kryerjes së veprimeve të tjera administrative, apo moskryerjes së veprimeve administrative nga organi publik për të ushtruar veprimtarinë përkatëse administrative në ushtrim të funksionit publik. Në mungesë të ankimit ndaj një akti të nxjerrë, apo një veprimi tjetër administrativ, vullneti i organit publik i shprehur nëpërmjet këtyre formave, bëhet i ekzekutueshëm menjëherë, mjafton që akti administrativ të ketë hyrë në fuqi.

27. Sipas nenit 164 të KPA-së, akti administrativ mund të ekzekutohet vetëm pasi ka hyrë në fuqi.



Nëse ndaj aktit nuk lejohet ankim administrativ, apo kur lejohet ankim, por ky i fundit nuk ka efekt pezullues, akti administrativ fillon të ekzekutohet menjëherë. Nëse ndaj aktit lejohet ankim administrativ, ai bëhet i ekzekutueshëm kur ndaj tij nuk është bërë ankim brenda afatit. Në të kundërt, kur është bërë ankim, akti bëhet i ekzekutueshëm pas njoftimit të vendimit që zgjidh ankimin nga organi administrativ epror, nëse ky i fundit e ka refuzuar apo nuk e ka pranuar apelimin. Pra, efektet e akteve administrative individuale, nëpërmjet ekzekutimit të tyre realizohen pasi ato të kenë hyrë në fuqi.

28. Në këtë aspekt, Kolegji e vlerëson të nevojshme t'i referohet kuptimit që jep ligji për titujt ekzekutivë. Referuar nenit 510 të KPC-së, në të cilin listohen titujt ekzekutivë, ku vendin kryesor e zenë vendimet e gjykatave e të arbitrazheve, vendase apo të huaja, por edhe disa nga aktet noteriale, apo aktet për dhënien e kredive bankare, përfshihen gjithashtu edhe aktet e tjera, që sipas ligjeve të veçanta konsiderohen si të tillë. Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 49/2012, që përcakton kompetencat lëndore të gjykatës administrative dhe nenin 17 të po këtij ligji, kuptohet që titujt ekzekutivë janë aktet administrative që përcaktohen në ligje të veçanta. Kjo nuk do të thotë se çdo akt administrativ i nxjerrë nga organi publik konsiderohet automatikisht titull ekzekutiv. Përkundrazi, titujt ekzekutiv janë vetëm ato akte administrative për të cilat shprehet legjislacioni i posaçëm. Kështu, sipas nenit 22, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative": "1. *Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përbarimor ose/ dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji...*". Edhe në nenin 30 të këtij ligji përcaktohet qartësisht se "1. *Gjoha dhe shumat, që duhet të paguhën sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhën nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur: a) është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv;*".

29. Mbi këtë analizë ligjore, duke iu referuar katër rasteve, për të cilat në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, kufizohet e drejta për ankim apo rekurs, Kolegji çmon se nuk mund të konkludohet *apriori* se aktet administrative të listuara e kanë cilësinë e titullit

ekzekutiv. I vetmi përjashtim mund të jetë për aktin administrativ të dënimit për kryerjen e një kundravajtje administrative, të cilin legjislacioni i posaçëm e konsideron titull ekzekutiv dhe që është menjëherë i ekzekutueshëm (shkronja "a"). Për rastet e tjera, ligji kërkon të kthehen në tituj ekzekutivë që të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm. Referuar nenit 609 të KPC-së, ky titull ekzekutiv i formësuar nëpërmjet vendimit gjyqësor të formës së prerë që ka njohur të drejtën e subjektit, mund të kundërshtohet për pavlefshmëri vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve gjyqësore që kanë zgjidhur ankimin e subjektit pretendues. Në kushtet që në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, lindin marrëdhënie juridike procedurale, si ndërmjet palëve që tërheqin të drejta apo mbartin detyrime nga ky titull, ashtu edhe ndaj përbaruesit gjyqësor, si subjekti që, nëpërmjet veprimtarisë së tij procedurale, përmbush ekzekutimin e titullit, KPC-ja, ka parashikuar edhe një mjet tjetër mbrojtje, siç është ankimi ndaj veprimeve të këtij të fundit.

30. Për këtë fazë përfundimtare të procesit gjyqësor, në ndryshim nga gjykimi civil, ligji nr. 49/2012, në nenet 66 dhe 67 të tij ka parashikuar disa rregulla specifike mbi ekzekutimin e vendimit gjyqësor, procedurë e cila ndiqet nga gjyqtari që ka disponuar vendimin mbi çështjen. Ndërkohë, edhe në këtë rast, ekzekutimi i tij realizohet nga përbaruesi gjyqësor, duke u njohur palëve në fazën e ekzekutimit, mundësinë që t'i kundërshtojnë veprimet e përbaruesit gjyqësor, sipas nenit 610 të KPC-së.

31. Për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor gjatë gjithë gjykimit civil/administrativ, KPC-ja ka parashikuar mjete procedurale efektive edhe në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Në respektim të parimit të ligjshmërisë, për të ndrequr gabimet që mund të bëhen nga përbaruesit gjyqësor në ekzekutimin e detyrueshëm, si dhe për të shmangur dëmet që mund t'i vijnë të interesuarve nga ekzekutimi i detyrueshëm, ligji ka ofruar mjetin procedural të pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv (neni 609 i KPC-së), si dhe kundërshtimin e veprimeve të përbaruesit gjyqësor (neni 610 i KPC-së). Procesi gjyqësor i zhvilluar gjatë fazës ekzekutive konceptohet një dhe i vetëm, si zgjatim i procesit gjyqësor njohës, ku gjyqtari i ekzekutimit, nëpërmjet vendimeve që lëshon gjatë kësaj faze, kontrollon veprimtarinë ekzekutive të përbaruesit



gjyqësor, njëloj sikurse gjyqtari i çështjes së themelit kontrollon dhe drejton procesin gjyqësor njohës nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme.

32. Lidhur me natyrën e mjeteve procedurale të parashikuara në nenet 609 dhe 610 të KPC-së, në vendimin njëses nr. 392, datë 26.10.2022, të Kolegjit Civil Gjykatës së Lartë, është theksuar:

“...64. Të dyja mjetet e parashikuara në nenet 609 dhe 610 të KPC-së, edhe pse hyjnë në rrethin e mjeteve mbrojtëse të debitorit ndaj ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kanë: (i) shkak ligjor të ndryshëm; (ii) afate të ndryshme ankimi; (iii) mënyra mbrojtjeje të ndryshme; dhe (iv) pasoja dhe efekte të ndryshme ndaj palëve të përfshira në një procedurë ekzekutimi të detyrueshëm të titullit ekzekutiv.

65. Në nenin 609 të KPC-së, është parashikuar si mjet mbrojtjeje padia për kundërshtimin e titullit ekzekutiv, që ngrihet nga debitori kundër kreditorit.

66. Titulli ekzekutiv si koncept juridik, tregon ekzistencën e një të drejte subjektive materiale, të cënuar ose të papërmbyshur. Për këtë arsye, titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimitetit të kreditorit për të iniciuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, legjitimitet i cili buron nga fakti se subjekti që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të.

67. Padia për goditjen e titullit ekzekutiv konstituon një gjykim themeli që përgendrohet mbi shqyrtimin e masës dhe sasisë së të drejtës materiale që gjendet në titullin ekzekutiv dhe si e tillë i nënshtrohet një gjykimi të zakonshëm kontradiktor. Me anë të kësaj padie, nëpërmjet vërtetimit të së kundërtës, debitori synon të kundërshtojë të drejtën e kreditorit, i cili nga ana e tij, synon të procedojë me ekzekutimin e detyrimit. Kjo padia, përmban elementet e një padie njohje negative. Shkak ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv qëndron në të drejtën e debitorit, për t’u çliruar nga një detyrim, i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht, kur e drejta e kreditorit nuk ka ekzistuar si e tillë që në origjinë ose për fakte shuese të ngjara pas formimit të titullit (shih vendim i Kolegjit Civil, nr. 214, datë 6.5.2010.)

[...]

70. Ndërkohë, kundërshtimi i veprimeve të përmbaaruesit gjyqësor është mjet që ka për qëllim të godasë vlefshmërinë e akteve të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, që realizohen nëpërmjet kryerjes ose moskryerjes së veprimeve të përmbaaruesit gjyqësor. Në këto lloj gjykimesh, gjykata nuk shqyrton më themelësinë e së drejtës së kreditorit të cilësuar në titullin ekzekutiv, por vlerëson, nga pikëpamja procedurale, nëse ankimi është ngritur brenda afatit ligjor të

parashikuar shprehimisht në nenin 610 të KPC-së dhe nëse veprimet e përmbaaruesit gjyqësor janë kryer apo jo në përputhje me ligjin. Shkak ligjor për të cilin mund të kundërshtohen gjyqësisht veprimet e përmbaaruesit lidhen kryesisht me parregullsitë procedurale që mund të vërehen gjatë kryerjes së tyre nga ana e përmbaaruesit, ose me mungesën e kushteve që duhen për të proceduar lidhur me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. (vendim nr. 658, datë 17.12.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

33. Mbi këtë analizë ligjore dhe jurisprudenciale, Kolegji vlerëson se, nisur nga objekti dhe shkak, këto dy mjete procedurale mbrojtje nuk kanë arsye të qëndrojnë së bashku në objektin e një padie, si kërkime autonome pasi, nëse kërkohet pavlefshmëria e pjesshme apo tërësore e titullit ekzekutiv, pasoja e këtij kërkimi çon detyrimisht në anulimin e një pjese apo të gjithë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm dhe, në këtë kuptim, paditësi nuk ka në fokus të drejtpërdrejt, veprime apo mosveprime të caktuara të përmbaaruesit. Ndërsa, kur kërkohet të deklarohet i paligjshëm një veprim apo mosveprim përmbaarimor, paditësi ka pretendime lidhur me mënyrën se si po ekzekutohet ai. Mjeti i mbrojtjes sipas nenit 609 të KPC-së është padi, ndërsa mjeti i mbrojtjes sipas nenit 610 të KPC-së është ankimi, në kuptim të nenit 442/a të këtij Kodi. Këto mjete janë të dallueshme nga njëritjetri dhe jo automatikisht të bashkueshme në një gjykim të vetëm.

B.2 Mbi proporcionalitetin e kufizimit të së drejtës së ankimit në paditë administrative me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe/ose kundërshtimin e veprimeve përmbaarimore

34. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës me qëllim kundërshtimin e një akti të organeve të administratës publike konsiderohet si një e drejtë themelore autonome dhe si element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe neni 42 i Kushtetutës. Në vetvete norma konventore dhe ajo kushtetuese sanksionojnë, jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë akses. Gjithashtu, e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, e parë nga këndvështrimi i nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, i cili siguron zbatimin efektiv të një procesi të rregullt ligjor, ka për qëllim t’u garantojë palëve në proces të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’i vendosur ato në çdo rast në pozita të barabarta para gjykatës, (shih vendimin nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese).



35. Duke iu referuar edhe praktikës së GJEDNJ-së në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, si element përbërës i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ-së, është pranuar se vendimet e autoriteteve administrative duhet t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë, i cili duhet të sigurojë garancitë e tjera të kësaj Konvente. Megjithatë pranohet se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute, ajo mund të kufizohet, por kufizimi nuk duhet të jetë i tillë sa të cenojë të drejtën në thelbin e saj. Gjithsesi, një kufizim nuk do të jetë i pajtueshëm me nenin 6, pika 1, të KEDNJ-së, nëse nuk ndjek një qëllim të arsyeshëm dhe proporcional, midis asaj që synohet të arrihet dhe së drejtës (*shih vendimin Stanev kundër Bullgarisë nr. 36760/06, GJEDNJ 17.1.2012*).

36. Në respektim të këtij parimi dhe në mbrojtje të interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë, të cenuara nga veprimtaria administrative e organeve publike, ligji nr. 49/2012, ka garantuar të drejtën e subjekteve për ta kundërshtuar aktin në rrugë gjyqësore. Në gjykimin administrativ, gjykata ka detyrimin të sigurojë nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike. Pjesë e procesit të rregullt, është edhe e drejta e palëve për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e drejta për ta ankimuar vendimin në një gjykatë më të lartë. Bazuar mbi këtë parim, ligji nr. 49/2012 ka garantuar të drejtën e ankimit nga palët në proces, duke përcaktuar rregulla të qarta për ushtrimin e saj, duke nisur nga mjetet e ankimit, afatet, formën që duhet respektuar, si dhe kufijtë e ushtrimit të kësaj të drejte.

37. Lidhur me të drejtën e ankimit, në ligjin nr. 49/2012, ligjvënësi ka parashikuar kufizimin e kësaj të drejte, apelit apo rekursit, respektivisht ndaj vendimit përfundimtar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, për disa padi të parashikuara shprehimisht në ligj. Kështu, sipas nenit 45 të ligjit nr. 49/2012, i titulluar “Vendime të paankimueshme”: “Nuk lejohet ankimi ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.”

38. Më tej, sipas nenit 56, të ligjit nr. 49/2012, i titulluar “Vendime të paankimueshme në Gjykatën e Lartë”: “Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi”.

39. Sipas dispozitave të mësipërme, kufizimi i së drejtës së ankimit është konceptuar ngushtësisht i lidhur me vlerën e ulët monetare të çështjes në kontekstin e një gjykimi administrativ. Në parim, e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor bazohet në rregullin se “nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit”, ose “nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë”. Si e tillë, ajo përbën një nga aspektet kryesorë të së drejtës për akses në gjykatë dhe parashikohet edhe në KEDNJ dhe në protokollet e saj shtesë. Referuar dispozitave konventore dhe kushtetuese është e qartë se “të drejtën e ankimit” për në instancat më të larta gjyqësore e gëzon çdo individ që është gjykuar nga gjykatat. Kjo garanci është konsideruar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese si një tejkallim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim KEDNJ-ja.



40. Lidhur me kufizimin e së drejtës së rekursit, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka vlerësuar se në parim, vendosja e disa kriterëve të pranueshmërisë për akses në Gjykatën e Lartë, përshtatet edhe me qëllimin e saj si gjykatë, pasi nuk mund të merret me çfarëdolloj çështjesh, por me çështje të një rëndësie të veçantë që i përshtatet rolit të saj. Kushtet e pranueshmërisë së një ankimi nga pikëpamja ligjore mund të jenë më strikte sesa për një ankim të zakonshëm (Zubac kundër Kroacisë; *Levages Prestations Services kundër Francës*, kërkesa nr. 21920/93, data e vendimit 23.10.1996). Në çështjen Zubac kundër Kroacisë (nr. 40160/12, vendimi datë 5.4.2018), ku është trajtuar çështja e kufizimit të së drejtës së rekursit për shkak vlere pranë Gjykatës së Lartë të Kroacisë, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, ka theksuar: *“...në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, nuk mbart rëndësi nëse sistemi i brendshëm i një vendi vendos kufizime për akses në Gjykatën e Lartë dhe as qëllimi i këtyre kufizimeve. Edhe pse nuk ka mosmarrëveshje midis palëve për ratione valoris e kufizimeve të aksesit në Gjykatën e Lartë, ato janë të lejueshme dhe legjitime, kur bëhen sipas qëllimit të normave. [...] Çështja është se si janë zbatuar këto kufizime për individin në rastin konkret. Në veçanti, çështja që shtrohet këtu është nëse Gjykata e Lartë, duke mos pranuar ankesën e kërkuës nga pikëpamja ligjore, ka zbatuar formalizëm të tepruar dhe nëse ky formalizëm ka ndikuar në mënyrë joproporcionale në mundësinë e saj për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjen pronësore nga gjykata, sipas legjislacionit të brendshëm përkatës. Pra, e vendos gjykatën përpara shqyrtimit/vlerësimit të mënyrës se si ka vepruar gjykata vendase, kur i ka kufizuar aksesin në gjykatë kërkuësës. E drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë efektive dhe praktike, jo një iluzion teorik. Gjithsesi, e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute, por mund të kufizohet, për shkak të natyrës së saj dhe kompetencave rregullatore që ka shteti, që mund të variojë në momente të ndryshme sipas nevojave të publikut dhe individëve. Në këtë mënyrë, shtetet anëtare gëzojnë marzh të gjerë vlerësimi. (...) Gjithsesi, kufizimet nuk duhet të cenojnë të drejtën për akses në gjykatë. Gjithashtu, kufizimi nuk mund të jetë i pajtueshëm me nenin 6 të KEDNJ-së, nëse nuk ka qëllim legjitim dhe proporcionalitet midis rregullit dhe asaj që synohet të arrihet. Neni 6 i KEDNJ-së nuk i detyron shtetet anëtare që të ngrenë gjykata apeli ose kasacioni. Kur këto gjykata ekzistojnë, atëherë duhet të garantohen rregullat procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së, me qëllim që të garantohet e drejta e aksesit në gjykatë për zgjidhjen e çështjes dhe garantohen të drejtat themelore të njeriut. Nuk është detyrë e Gjykatës që të*

kontrollojë politikën shtetërore të kufizimit të së drejtës së ankimit në gjykatat e larta, nëse janë të përshtatshme ose jo, pasi gjykata shikon nëse pasojat janë apo jo në përputhje me KEDNJ-në. GJEDNJ-ja nuk zgjidh mosmarrëveshjen, por kontrollon se si është interpretuar ligji nga gjykata vendase, në përputhje apo jo me KEDNJ-në. Pra, mënyra se si zbatohet neni 6 i KEDNJ-së nga gjykatat e apelit apo të lartat, varet nga rrethanat e posaçme të procesit gjyqësor dhe dubet parë në tërësi të gjitha procedurat gjyqësore brenda vendit dhe rolin që kanë gjykatat në sistemin juridik. Kufizimet e ankimeve nga pikëpamja ligjore mund të jenë më strikte sesa për një ankim të zakonshëm. Për kufizimin e ankimit në gjykatat më të larta, GJEDNJ-ja ka marrë në konsideratë disa faktorë, pa u kufizuar vetëm në to, si: (i) parashikueshmëria e kufizimit; (ii) nëse është individ apo shteti ai që vuan pasojat e gabimeve të moslejimit të ankimit në gjykatën më të lartë; (iii) nëse kufizimet mund të konsiderohet formalizëm i tepruar... GJEDNJ-ja vëren se kërkuësja është dëgjuar për pretendimet e saj në dy juridiksione të plota në shkallë të parë dhe të dytë dhe të dyja kanë rrëzuar pretendimet e saj, e gjithashtu nuk ka pasur pretendime për mosgjykim të drejtë. Po kështu, Gjykata e Lartë ka juridiksion rishikues, pasi kontrollon nga pikëpamja ligjore ankimet dhe jo në themel, çka nënkupton se kufizimet ligjore për ankime të këtilla janë më strikte sesa ato të zakonshmet. Sa i takon parashikueshmërisë së kufizimit me ligj, tashmë gjykata ka vlerësuar në praktikën e saj se, të tilla ankime në vlerë të vogël nuk pranohen... GJEDNJ-ja konstaton se, vlerësimi i Gjykatës së Lartë ka qenë në funksion të miradministrimit të drejtësisë dhe në përputhje me parimin e sigurisë juridike, e si rezultat nuk përbën një formalizëm të tepruar. Këtu sigurohet më tepër efektiviteti i drejtësisë sesa kemi të bëjmë me formalizmin e tepruar. Për pasojë unanimisht nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së”.

41. Kufizimi i së drejtës së rekursit, i materializuar në nenin 472 të KPC-së dhe më pas, në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, në përcaktimin në mënyrë shteruese të shkaqeve për të cilat mund të ushtrohet ky mjet ankimi, është një standard që respektohet në praktikën e Gjykatës së Lartë. Kufizimi i së drejtës së ankimit apo rekursit ndaj një vendimi gjyqësor për shkak vlere, sipas parashikimeve të neneve 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, është një risi që solli miratimi i ligjit nr. 49/2012, i cili, edhe pse në vetvete konkurren me disa parime kushtetuese, konkretisht të drejtën e aksesit që ka çdo subjekt për t’iu drejtuar gjykatës, për të pasur një proces gjyqësor të rregullt apo edhe të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, në thelb nuk i cenon ato. Neni 43 i Kushtetutës ka parashikuar se:



“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.

42. Përmbajtja e këtyre dispozitave është trajtuar edhe në vendimin njësuës nr. 3, datë 6.12.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku theksohet: *“...Me qëllim vlerësimin e zbatimit të parimit të proporcionalitetit kur me ligj vendoset një kufizim i një të drejte themelore, duhet të identifikohen interesat publikë për të cilat është vendosur masa kufizuese. Në rastin konkret, interesi publik i identifikuar ka të bëjë me nevojën e një administrimi sa më të mirë, efektiv dhe efikas të drejtësisë, duke i dhënë zgjidhje sa më të shpejtë mosmarrëveshjeve administrative dhe arritjen e paqes sociale me kosto sa më të ulët për shtetin dhe publikun”.*

43. Në zbatim të neneve 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, dhe qëndrimit të mësipërm unifikues, Kolegji ka vendosur tashmë disa standarde jurisprudenciale mbi kufizimin e rekursit për shkak vlere, duke theksuar se ky kufizim për kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, vepron pavarësisht faktit nëse kundërshtohet dënimi administrativ si akt administrativ, apo si titull ekzekutiv, pasi, në interpretim teleologjik të nenit 56 shkronja “a” të ligjit nr. 49/2012, qëllimi i ligjvënësit në parashikimin e këtij kufizimi ka qenë shmangia e juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë lidhur me çështje administrative, objekti i padisë së të cilave përmban një vlerë më të vogël se masa e përcaktuar në ligj. *(shih vendimi nr. 00-2021-1850, datë 7.10.2021 të Kolegjit Administrativ)*. Kolegji ka interpretuar më tej kufizimin e së drejtës së rekursit edhe në rastet kur objekt padie janë disa akte administrative, të cilat individualisht janë nën kufizimin financiar të caktuar në ligjin nr. 49/2012, por të marra së bashku në objektin e padisë janë mbi vlerën e këtij kufizimi. Në këto raste, Kolegji ka vlerësuar se fakti që pala paditëse i ka bashkuar në një padi të vetme të gjitha kërkimet, nuk përlligj palët ndërgjyqëse që vlerën e padisë ta përcaktojnë si shumatore aritmetike të vlerës së çdo kërkitimi. *(shih vendimi nr. 00-2023-2448, datë 23.3.2023 të Kolegjit Administrativ)*. Këto vendimmarrje tregojnë se Kolegji është prirur me fleksibilitet drejt zbatueshmërisë së kufizimit të së drejtës së rekursit për shkak të vlerës së vogël. Ky qëndrim është çmuar në përputhje me qëllimin e

ligjvënësit mbi kufizimin e aksesit në gjykimin rishikues për çështjet gjyqësore të një rëndësie të pakët financiare. Ky kufizim është bazuar mbi kriterin e vlerës së padisë, respektivisht për vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi dhe për vlerë më të vogël se dhe dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi.

44. Nga sa më sipër, referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, si dhe në analizë të neneve 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, konstatohet se ligjvënësi ka përcaktuar qartësisht se cilat janë ato çështje për të cilat, e drejta e ankimit ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe e drejta e rekursit ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk lejohet. Konstatohet se ky kufizim është i vendosur me ligj në përputhje me nenet 17 dhe 43 të Kushtetutës dhe synon të balancojë të drejtën e aksesit në gjykatë dhe procesit të rregullt, me nevojën e interesit publik për miradministrimin e drejtësisë.

45. Në analizë të dispozitave të mësipërme, konstatohet se për një kategori të caktuar çështjesh, kur akti administrativ apo vlere e padisë për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, është deri në një vlerë të caktuar (sa më sipër kriteri i kufizimit është përcaktuar qartë në nenet 45 dhe 56 të ligjit), respektivisht Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk mund të investohen nëpërmjet mjetit të ankimit, apo të rekursit, për t'i marrë në shqyrtim vendimet përfundimtare të gjykatës administrative dhe ato të Gjykatës Administrative të Apelit. Ky kufizim i përcaktuar nga ligjvënësi, nuk është bërë pa qëllim dhe në asnjë rast ai nuk cenon parimet bazë të një procesi të rregullt gjyqësor, apo shkelje të të drejtave të subjekteve që marrin pjesë në këtë proces, referuar nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

46. Në interpretim teleologjik të kufizimit të së drejtës së ankimit/rekursit, për paditë me objekt të përcaktuar qartë në nenet 45 dhe 56 të ligjit, Kolegji vlerëson se ky kufizim duhet të jetë i zbatueshëm edhe në proceset gjyqësore që mund të lindin në fazën e ekzekutimit të këtyre akteve administrative, të kthyer tashmë në tituj apo të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare që kanë



shqyrtuar ankimin individual ndaj një akti administrativ refuzues, ose mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar. Nuk mund të ketë dy qasje të ndryshme në gjykatë, kur ndaj një akti administrativ me vlerë të përcaktuar e drejta e ankimit të kufizohet, në referencë të neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 dhe ndaj të njëjtit akt administrativ, tashmë i shndërruar në titull ekzekutiv dhe i paraqitur me një kërkim tjetër të objektit të padisë, referuar nenit 609 të KPC-së në “pavlefshmëri titulli ekzekutiv”, e drejta e ankimit të mos kufizohet, referuar dispozitave të mësipërme, por të ndjekë të gjithë shkallët e gjykimit. Në respektim të *ratio* të neneve 45 dhe 56 të ligjit, Kolegji vlerëson se qëllimi i ligjvënësit është kufizimi i së drejtës së ankimit për shkak vlerë, pavarësisht natyrës ekzekutive të aktit.

47. Për një kategori të caktuar çështjesh (për shkak të natyrës që kanë dhe vlerës së vogël që ato përfaqësojnë), ligjvënësi ka gjykuar, duke e sanksionuar në ligj, se një shkallë apelimi është më se e mjaftueshme për subjektet që janë në proces gjyqësor, në mënyrë që ato të marrin një vendim përfundimtar dhe të formës së prerë, referuar nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Përfundimi i tyre në dy shkallë gjykimi do të bënte që pikërisht këto çështje të mos zvarriten pafundësisht në gjykim, por të marrin formë të prerë dhe vendimi të jetë përfundimtar. Kjo e bën procesin gjyqësor administrativ më efektiv dhe më të shpejtë. I njëjti parim vlen dhe për çështjet kur nga ligjvënësi është çmuar e përshtatshme që shqyrtimi i tyre të përfundojë brenda gjykimit njëshkallësh, pa pasur akses për ushtrimin e ankimit. Kolegji çmon këtë qëndrim në përputhje të plotë edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka theksuar se neni 6/1 i KEDNJ-së nuk i detyron shtetet anëtare të ngrenë gjykata apeli apo gjykata kasacioni. Një shtet që nuk ka ngritur të tilla gjykata, duhet t'i garantojë qytetarëve të tij përmes gjykatës së shkallës së parë të drejtat themelore të njeriut (*Zubac v. Croatia, kërkesa nr. 40160/12, data e vendimit 5 prill 2018, § 80, Platakou v. Greece, kërkesa nr. 38460/97, data e vendimit 11 janar 2001, parag. 38*).

48. Në mënyrë të posaçme, neni 56 i ligjit nr. 49/2012, ka pasur parasysh edhe natyrën e gjykimit në Gjykatë të Lartë, si një gjykatë ligji. Ligjvënësi ka

përcaktuar qartësisht se Gjykata e Lartë nuk mund të ngarkohet pa shkak, me volum pune dhe shqyrtim dosjesh, për të cilat gjykimi me dy shkallë është më se i mjaftueshëm, si dhe në kundërshtim me natyrën e gjykimit që kryen kjo gjykatë. (*shih vendimin nr. 462, datë 3.5.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e kufizimeve të së drejtës për ankim për shkak vlerës së objektit të padisë, ka qenë shmangia e mbingarkesave të gjykimeve të mosmarrëveshjeve administrative me vlerë të vogël padie, duke i dhënë fund gjykimit në shkallë të parë. Çmohet se një kufizim i tillë i shërben interesit publik, efektivitetit të gjykimit administrativ, si dhe ekonomisë gjyqësore, si parim që duhet të shtrihet në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor (*shih vendimi nr. 00-2021-993, datë 24.06.2022*).

49. Kufizimi i ushtrimit të ankimit për shkak vlere, duhet të veprojë edhe për sa i përket kërimit për kundërshtimin e veprimeve përmbare, të cilat lidhen pikërisht me ekzekutimin e aktit, për të cilin gjykata rishikuese ka akses të kufizuar. Kolegji vlerëson se me ankimin e kundërshtimit të veprimeve përmbare, të parashikuar nga neni 610 i KPC-së kundërshtohet mënyra e ligjshmëria e zhvillimit të vetë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për shkak të mosrespektimit të ligjit në vendimmarrjen dhe veprimet e përmbaresit. Këto parregullsi formale ekzistojnë në ato raste kur aktet dhe sjelljet procedurale të përmbaresit përbëjnë zbatim të gabuar të ligjit procedural civil, apo janë akte e sjellje të kryera nga përmbaresi duke zbatuar gabim ligjin procedural në çështjen konkrete që procedohet për ekzekutim.

50. Në këtë mënyrë, kundërshtimi i veprimeve përmbare është një mjet procedural (ankim) që legjitimon palët të kundërshtojnë veprimet ose mosveprimet e përmbaresit gjyqësor dhe jo mjet ankimi për të shqyrtuar themelsinë dhe bazueshmërinë në ligj të një titulli ekzekutiv. Shkaku për të cilin mund të kundërshtohen gjyqësisht veprimet e përmbaresit lidhen kryesisht me parregullsitë procedurale që mund të kryhen prej tij, ose me mungesën e kushteve që duhen për të proceduar lidhur me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. Këto parregullsi formale ekzistojnë në ato raste kur aktet dhe sjelljet procedurale të përmbaresit përbëjnë zbatim të gabuar të ligjit procedural civil, apo janë akte e sjellje të kryera në



zbatim të gabuar të ligjit procedural në çështjen konkrete që procedohet për ekzekutim.

51. Kolegji vlerëson se gjykata administrative rishikuese, ndodhur në kushtet e pamundësisë së shqyrtimit të (pa)ligjshmërisë së titullit ekzekutiv, nuk mund të gjykojë as ligjshmërinë e veprimeve përmbartimore të kryera në funksion të aktit i cili karakterizohet nga aksesit i kufizuar në gjykatë. Kolegji orientohet në këtë qasje duke pasur në vëmendje se veprimtaria administrative në kuadër të ekzekutimit të titullit ekzekutiv me vlerë të vogël, karakterizohet nga e njëjta peshë relative në kuadër të kufizimit të aksesit në gjykatë, pasi veprimtaria përmbartimore kryhet në funksion të ekzekutimit të titullit, për atë masë dhe vlerë sa titulli rezultoi i ligjshëm nga gjykimi pranë gjykatës së shkallës së parë ose gjykatës së apelit, varësisht vlerës së aktit.

52. Lidhur me vlerën e padisë në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, për shkak të kufizimit të së drejtës së ankimit/rekursit, ajo do të përcaktohet në përputhje me rregullin e përcaktuar në nenin 70 të KPC-së.

53. Në përfundim Kolegji vlerëson se, edhe për kërkimin për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, kur titulli ekzekutiv për të cilin është kryer veprimi përmbartimor është një akt individual administrativ me vlerë të përcaktuar i cili kushtëzohet nga mosushtimi i ankimit dhe rekursit sipas neneve 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, do të duhet të aplikohet i njëjti kufizim për sa i përket ushtrimit të ankimit apo rekursit si për titullin ekzekutiv.

C. Rregulli i së drejtës për çështjen e shtruar për njësim

54. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin e mësipërm, referuar çështjes së shtruar për njësim, arrin në këtë përfundim njësuës:

“Në zbatim të neneve 45 dhe 56 të ligjit me nr. 49/2012, i ndryshuar, për padi me objekt “pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv”, për tituj të përcaktuar në pikat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtyre neneve, si dhe për ankimin ndaj veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, për ekzekutimin e këtyre titujve, e drejta e ankimit /rekursit ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative do të kufizohet në përputhje me parashikimet e bëra nga ligjvënësi në këto dispozita.”

D. Në lidhje me rekursin e palës paditëse

55. Në rastin konkret rezultoi se ndaj paditësit Bilbil Behari është sanksionuar me vendimin nr. 32, datë 17.12.2014 të IKMT-së dënimi me gjobë, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, për kundërvajtjen administrative “*të ndërtimit tende me konstruksion druri e ndërtuar në hapësirë publike pa leje përkatëse*”, nga ku më pas, nga pala e paditur është kërkuar, nëpërmjet përmbartuesit gjyqësor fillimi i procedurës së ekzekutimit të këtij akti administrativ. Në padinë e paraqitur gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, paditësi ka kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, aktit nr. 32, datë 17.12.2014 të IKMT-së të shndërruar në titull ekzekutiv.

56. Në kohën e ushtrimit të rekursit (2022), në referim të VKM-së nr. 604/2022, kufizimi monetar për ushtrimin e rekursit ishte në vlerën 1.360.000 (*paga minimale sipas aktit nënligjor është 34.000 lekë*), rrjedhimisht rekursi është ushtruar për një mosmarrëveshje, e cila është nën vlerën e parashikuar në ligj për lejimin e ushtrimit të rekursit.

57. Në zbatim të sentencës njësuëse e në mbështetje të nenit 56, të ligjit nr. 49/2012, Kolegji arrin në përfundimin se pala paditëse ka ushtruar rekurs ndaj një vendimi për të cilin nuk lejohet e drejta e ushtrimit të këtij mjeti procedural, rrjedhimisht Kolegji duhet të vendos mospranimin e rekursit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 62/a dhe 63(1)(a)(2) të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse, Bilbil Behari kundër vendimit nr. 360, datë 12.10.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 23.11.2023

Kryesues: Sokol Sadushi

Anëtar: Arbena Ahmeti, Asim Vokshi, Sokol Ngresi

Anëtar (mendim paralel) : Gentian Medja

**MENDIM PARALEL**

(Gjyqtari Gentian Medja)

Në çështjen administrative me nr. 31003-00003-00-2023 akti që i përket:

PADITËS: Bilbil Behari

I PADITUR: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Zyra e Përmbartimit Gjyqësor Privat me Përmbartues Gjyqësor Altin Vako.

OBJEKTI: Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, urdhër të detyrueshëm, vendim për dënim me gjobë nr. 32, datë 17.12.2014, gjobë në masën 500.000 lekë.

Kundërshtimin e veprimit përmbartimor nr. 271 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”.

Kundërshtimin e veprimit përmbartimor nr. 272 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”.

Kundërshtimin e veprimit përmbartimor nr. 273 prot., datë 7.3.2016 “Urdhër për vënien e sekuestros konservative”.

Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe avokatore.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 153 e në vijim dhe nenet 517, 518, 519, 609, 610, të Kodit të Procedurës Civile.

1. Në zbatim të nenit 307/2, të Kodit të Procedurës Civile, neni 1/2, neni 63, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe neni 35/3, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, unë, gjyqtari Gentian Medja, me cilësinë e anëtarit të trupës gjyqësore kam të njëjtin qëndrim me shumicën e Kolegjit. Kjo për sa i përket disponimit në lidhje me rastin konkret duke vendosur për mospranimin e rekursit, si edhe për sa i përket konkluzionit në lidhje me rregullin e së drejtës për kufizimin e së drejtës së ankimit dhe rekursit për çështjet që kanë për objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv sipas nenit 609 të KPC-së. Por, ndaj qëndrim të ndryshëm me atë të shumicës në lidhje me njësimin e praktikës, për sa i përket kufizimit të së drejtës së ankimit dhe rekursit edhe për çështjet me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, sipas nenit 610 të KPC-së.

1. Në lidhje me rregullin e së drejtës për çështjen e shtruar për njësim

2. Siç u përmend më lart, nuk bashkohem me qëndrimin e shumicës për sa i përket kufizimit të së drejtës së ankimit dhe rekursit edhe për çështjet me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, sipas nenit 610 të KPC-së. Në arritjen e këtij konkluzioni mendoj se është e rëndësishme të mbahet parasysh që vendimet për këto çështje nuk parashikohen shprehimisht në vendimet për të cilët nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, kufizojnë të drejtën e ankimit për shkak të vlerës; natyra e ndryshme e gjykimit që paraqesin çështjet me këtë objekt gjykimi në raport me ato të parashikuara në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012 dhe me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv; dhe faktin që kufizimi i ankimit në një gjykatë më të lartë për këto çështje nuk respekton parimin e proporcionalitetit.

3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet kanë njohur një gamë lirish dhe të drejtash politike, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe së bashku me to kanë parashikuar instrumente që mund të shfrytëzohen nga subjektet me qëllim që këto të drejta të jenë efektive dhe konkrete. Kushtetuta, neni 42 i saj dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6, kanë garantuar të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës me qëllim kundërshtimin e një akti të organeve të administratës publike. Kjo e drejtë duhet kuptuar së bashku me të drejtën për një proces të rregullt ligjor. E drejta për një proces të rregullt, e garantuar nga neni 6 § 1, duhet interpretuar në dritën e parimit të sundimit të ligjit, që kërkon ekzistencën e një rruge gjyqësore efektive e cila lejon të kërkojnë të drejtat civile (*shih vendimin Béleš dhe të tjerë kundër Çekisë, nr. 47273/ 99, GJEDNJ 11.11.2002*).

4. E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin një gamë të gjerë elementesh që duhen respektuar, ndër të cilët edhe e drejta për ta ankimuar vendimin në një gjykatë më të lartë. Neni 43 i Kushtetutës, parashikon se “*Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, ...*”, ndërsa ligji nr. 49/2012 dhe Kodi i Procedurës Civile kanë parashikuar rregulla më të hollësishme në lidhje me vendimet e ankimueshme, rastet kur ato mund të ankimohen, aktet që i duhen bashkëngjitur, afatet dhe procedurat që duhen ndjekur.

5. E drejta për tu ankuar në një gjykatë më të lartë nuk është një e drejtë absolute, por mund të ketë edhe kufizime në rrethana të caktuara. Neni 43 i



Kushtetutës sanksionon parimin që kushdo mund të kundërshtojë një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë, ndërsa mundësinë e kufizimit e parashikon si një rast përjashtimor. Për çështjet administrative, kjo e drejtë mund të kufizohet në ato raste, kur ky kufizim parashikohet shprehimisht në ligj, për çështje administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

6. Edhe GJEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj, ka pranuar mundësinë e kufizimit të aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së. *“E drejta për t’u drejtuar gjykatës”, nga e cila e drejta për akses është njëri aspekt, nuk është absolute; ajo u nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin beshturazi veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, meqenëse nga vetë natyra kërkon rregullimin nga Shteti, i cili gëzon një kufi të caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë apo pakësojnë aksesin e një personi në një mënyrë apo shtrirje të tillë që dëmton vetë thelbin e së drejtës. Së fundi, kufizime të tilla nuk janë në përputhje me nenin 6 § 1, nëse ato nuk ndjekin qëllimin e legjitimuar ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur (shih vendimin Shkalla kundër Shqipërisë, nr. 26866/05, GJEDNJ 10.5.2011)*

7. Në përputhje me nenet 43 dhe 17 të Kushtetutës, KPC-ja, në nenin 472 të tij dhe ligji nr. 49/2012 në nenin 58, kanë kufizuar të drejtën e rekursit vetëm për shkaqet e parashikuara shprehimisht në ligj. Përveç kufizimit të shkaqeve për të cilat mund të bëhet rekurs, parashikimit të kushteve të pranueshmërisë së ankimit, ligji nr. 49/2012, në nenet 45 dhe 56, ka shkuar më tej, duke parashikuar vendime ndaj të cilëve nuk mund të ushtrohet e drejta e ankimit. Konkreisht, ka kufizuar të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit në vlerën më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi, dhe të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë në vlerën më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi, për vendime përfundimtare në lidhje me padi që kanë për objekt: a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se (respektivisht) njëzetfishi/dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se (respektivisht) njëzetfishi/dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka

refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se (respektivisht) njëzetfishi/dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se (respektivisht) njëzetfishi/dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

8. Referuar përmbajtjes së neneve të mësipërme, vlerësoj se ligji nr. 49/2012 e ka kufizuar të drejtën për të paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë, duke iu referuar, në mënyrë kumulative, dy kritereve; së pari, llojit të kërimit të padisë, i cili duhet të jetë një nga llojet e padive të parashikuara në këto nene dhe së dyti, vlerës së objektit të padisë.

9. Në përputhje me parimet që justifikojnë kufizimin e të drejtave, qëllimin e legjitimuar dhe proporcionalitetin, vlerësoj se ligji, me anë të të cilit vendosen këto kufizime, duhet të jetë i saktë dhe i qartë. Gjykata Kushtetuese, në mënyrë konsekuente, ka mbajtur qëndrimin se *“Parimi i sigurisë juridike kërkon domosdoshmërisht një formulim të qartë të normave ligjore, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i të shteg zbatuesit për t’i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasojë, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike. Është kërkesë e parimit të sigurisë juridike fakti se një ligj në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. (shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005 dhe nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese).*

10. Në rastet kur norma ligjore nuk është plotësisht e qartë është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuar t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit në praktikë. Interpretimi i normave ligjore duhet të bëhet përmes rregullave të caktuara të interpretimit gramatikor, logjik, historik, sistematik (dhe jo vetëm) me qëllim nxjerrjen e qëllimit të vërtetë të normës. Padyshim që interpretimi i normës dhe nxjerrja e qëllimit të vërtetë të saj nuk është kurdoherë një proces i thjeshtë. Përkundrazi, në raste të caktuara paraqet vështirësi dhe kërkon impenjim. Megjithatë, ajo çfarë duhet të ketë në vëmendje gjykata është që në interpretimin e një norme duhet të tregojë vetëpërmbajtje dhe të mos kalojë kufijtë e kompetencës së saj që përmes interpretimit të krijojë një normë të re.



11. Në rastin e normave ligjore që kufizojnë të drejta themelore, interpretimi i tyre duhet bërë duke mbajtur në vëmendje, së pari, që kufizimi duhet të përcaktohet shprehimisht në ligj dhe, më pas, të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe të jetë proporcional, pa ndryshuar thelbin e së drejtës. Në rastet kur ligji nuk është i qartë në lidhje me kufizimin, atëherë ai duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë, strikte, pa i dhënë atij një kuptim të zgjeruar duke mbizotëruar interpretimi në favor të mbrojtjes së të drejtës. Gjykata Kushtetuese, në mënyrë konsekuente ka mbajtur qëndrimin: *“Kriteri i parë për t’u analizuar është “kufizimi vetëm me ligj” i të drejtave dhe lirive themelore të individit. Qëllimi i këtij kriteri është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe, për këtë shkak, vetëm organi më i lartë ligjvënës duhet të jetë kompetent. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në çmim të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera. Konteksti në të cilin është përdorur toqfjalëshi “vetëm me ligj” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta. Rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret, që në këtë rast është Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla cenon kompetencat e këtij organi (shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese).*

12. Në të njëjtën linjë me shumicën e Kolegjit, jam i mendimit se kufizimi i së drejtës për të paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë, i parashikuar në nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, referuar kriterit të vlerës së objektit të padisë në raport me llojet e padive për të cilat aplikohet ky kufizim sipas neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, është në përputhje me nenet 43 dhe 17 të Kushtetues dhe nenet 6 e 13 të KEDNJ-së, pasi ndjek një qëllim legjitim, sepse synon të balancojë të drejtën e aksesit në gjykatë dhe procesit të rregullt, me nevojën e interesit publik për miradministrimin e drejtësisë. Nga ana tjetër vendos një raport proporcional mes këtyre interesave sepse pavarësisht se konflikti që shqyrtohet përfaqëson një vlerë të vogël monetare përsëri subjekteve u mundësohet që të kenë akses në të paktën një shkallë

të sistemit gjyqësor, duke e bërë atë një mjet efektiv në kuptim edhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

13. Bashkohem me qëndrimin e shumicës së Kolegjit, që kufizimi i së drejtës për të paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë, i parashikuar në nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, aplikohet edhe në paditë që kanë për objekt pavlefshmërinë e një titulli ekzekutiv, sipas nenit 609 të KPC-së, në ato raste kur e drejta që përmban titulli i nënshtrohet këtyre kufizimeve. Në arritjen e këtij konkluzioni mendoj se është e rëndësishme të mbahet parasysh titujt ekzekutiv sipas nenit 510 të KPC-së dhe natyra e gjykimit të padive me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, që parashikohen në nenin 609 të KPC-së, i cili parashikon se: *“Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas.”*

14. Në kuptim të nenit 510 të KPC-së dhe nenit 65 të ligjit nr. 49/2012, në gjykimin administrativ, titulli ekzekutiv përfaqëson ose një vendim gjyqësor i cili ka disponuar në lidhje me një të drejtë të pretenduar nga një subjekt i caktuar ose përbën një akt administrativ, në fuqi, i cili është bërë i ekzekutueshëm, sipas nenit 164 të KPA-së.

15. Lidhur me natyrën e kësaj padie, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin njëses nr. 392, datë 26.10.2022, ka mbajtur qëndrimin: *“65. Në nenin 609 të KPC-së, është parashikuar si mjet mbrojtjeje padia për goditjen e titullit ekzekutiv, që ngrihet nga debitori kundër kreditorit.*

66. Titulli ekzekutiv si koncept juridik, tregon ekzistencën e një të drejte subjektive materiale, të cennuar ose të papërmbyshur. Për këtë arsye, titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimitetit të kreditorit për të iniciuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, legjitimitet i cili buron nga fakti se subjekti që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të.

67. Padia për goditjen e titullit ekzekutiv konstituon një gjykim themeli që përqendrohet mbi shqyrtimin e masës dhe sasisë së të drejtës materiale që gjendet në titullin ekzekutiv dhe si e tillë i nënshtrohet një gjykimi të zakonshëm kontradiktor. Me anë të kësaj padie, nëpërmjet vërtetimit të së kundërtës, debitori synon të kundërshtojë të drejtën e kreditorit, i cili nga ana e tij, synon të procedojë me ekzekutimin e detyrimit.

Kjo padë, përmban elementet e një padie njohje negative. Shkak i ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv



qëndron në të drejtën e debitorit, për t'u çliruar nga një detyrim i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht, kur e drejta e kreditorit nuk ka ekzistuar si e tillë që në origjinë ose për fakte shuese të ngjara pas formimit të titullit (shih vendim i Kolegjit Civil, nr. 214, datë 6.5.2010.)”

16. Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, në kuptim të nenit 609 të KPC-së, fokusohet në vlerësimin nëse kanë ndodhur fakte të tillë që kanë shkaktuar shuarjen e kredisë së kreditorit, siç mund të jenë shuarja, falja, parashkrimi i ekzekutimit apo edhe nëse e drejta në themel nuk ka ekzistuar ndonjëherë, për shkak të pavlefshmërisë së titullit.

17. Në zbatim të nenit 609/2 të KPC-së, kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së vendimit. Sa më sipër, pretendimet që mund të ngrihen në këtë lloj gjykimi, ndryshojnë në raport me faktin se çfarë përbën titull ekzekutiv.

18. Në ndryshim nga rasti kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor, kur titulli ekzekutiv që vihet në ekzekutim është një akt administrativ, pavlefshmëria e titullit mund të kërkohej jo vetëm për fakte që kanë ndodhur pas konstituimit të titullit ekzekutiv por edhe për pavlefshmëri të vetë titullit, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat për ta kërkuar këtë dhe kur këto kërkime nuk kanë qenë pjesë e një gjykimi tjetër për të cilin gjykata të jetë shprehur me vendim përfundimtar. Në këtë kuptim, vlerësoj se kur titulli ekzekutiv është një akt administrativ dhe kërkohej pavlefshmëria e titullit ekzekutiv për shkak të pavlefshmërisë së vetë aktit administrativ, natyra e gjykimit, palët pjesëmarrëse dhe shkaku i padisë përputhen plotësisht me padinë ku kundërshtohet një akt administrativ, sipas një gjykimi të zakonshëm, vendimmarrja për të cilën i nënshtrohet kufizimeve të neneve 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012.

19. Po ashtu edhe në rastet, kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor që disponon në lidhje me të drejta subjektive nga ato të përcaktuara në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012 apo një akt administrativ dhe titulli kundërshtohet për fakte dhe rrethana që kanë ndodhur pas konstituimit të tij, natyra e gjykimit dhe fokusi i tij nuk kapërcen kufijtë e së drejtës së njohur përmes titullit por kufizohet vetëm në verifikimin e rrethanave që kanë çuar në shuarjen e kësaj të drejte apo detyrimi.

20. Sa më sipër, bazuar në natyrën e njëjtë të gjykimit që paraqesin këto çështje dhe kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të kësaj padie, e cila, në asnjë rast, nuk kapërcen kufijtë e së drejtës së njohur përmes titullit, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën e Kolegjit që kufizimet e parashikuara në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012 zbatohen edhe në paditë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv sipas nenit 609 të KPC-së, në ato raste kur e drejta që përmban titulli i nënshtrohet këtyre kufizimeve.

21. Në ndryshim nga shumica e Kolegjit, ndaj qëndrim të ndryshëm në lidhje me shtrirjen e këtij kufizimi edhe në kërkesat për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore për titujt ekzekutiv që i nënshtrohen këtij kufizimi, për arsye se vendimmarrja e gjykatës në këtë rast nuk plotëson kriterin e llojit të kërimit sipas neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 dhe as të vlerës së objektit të padisë.

22. Jam i mendimit që vendimi gjyqësor në lidhje me kërkesa për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore nuk i nënshtrohet kufizimit të së drejtës së ankimit sepse vendimi për këtë lloj kërkimi nuk parashikohet shprehimisht në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, dhe as mund të kuptohet nga interpretimi i këtyre neneve. Kjo për shkak se, natyra e çështjeve me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore nuk është as e njëjtë dhe as e ngjashme me çështjet që parashikohen në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, apo me pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv, sipas nenit 609 të KPC-së.

23. Lidhur me natyrën e kësaj padie, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin njëses nr. 392, datë 26.10.2022, ka mbajtur qëndrimin: “...kundërshtimi i veprimeve të përmbartuesit gjyqësor është mjet që ka për qëllim të godasë vlefshmërinë e akteve të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, që realizohen nëpërmjet kryerjes ose moskryerjes së veprimeve të përmbartuesit gjyqësor. Në këto lloj gjykimesh, gjykata nuk shqyrton më themelësinë e së drejtës së kreditorit të cilësuar në titullin ekzekutiv, por vlerëson, nga pikëpamja procedurale, nëse ankimi është ngritur brenda afatit ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin 610 të KPC-së dhe nëse veprimet e përmbartuesit gjyqësor janë kryer apo jo në përputhje me ligjin. Shkakun për të cilin mund të kundërshtohen gjyqësisht veprimet e përmbartuesit lidhen kryesisht me parregullsitë procedurale që mund të vërehen gjatë kryerjes së tyre nga ana e përmbartuesit, ose me mungesën e kushteve që duhen për të proceduar lidhur me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv.”



24. Sa më sipër, ky lloj kërkimi, qartazi, dallon nga gjykimet e themelit që parashikohen në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, dhe nga gjykimi për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Përmbaruesi gjyqësor nuk vlerëson të drejtën dhe as vlefshmërinë e titullit por ndjek procedurat ligjore për ekzekutimin e tij. Për rrjedhojë, në këtë gjykim, objekt shqyrtimi janë veprimet e përmbaruesit gjyqësor dhe jo e drejta në themel dhe as shuarja e saj. Në fokusin e këtij gjykimi është vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve të përmbaruesit dhe nuk vlerësohet e drejta mes palëve dhe as vlefshmëria e titullit.

25. Natyra e ndryshme e këtij gjykimi në raport me gjykimin e themelit ku shqyrtohet e drejta apo me gjykimin për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv ndikon edhe në krijimin e një ndërgjyqësie të ndryshme. Në rastin e gjykimit të themelit apo të pavlefshmërisë së titullit, meqenëse vihet në diskutim e drejta apo shuarja e saj, gjykimi zhvillohet mes mbajtësit të së drejtës së pretenduar apo kreditorit kundër personit që ka shkelur këtë të drejtë apo debitorit. Ndërsa në rastin e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, gjykimi nuk zhvillohet mes dy subjekteve që kontestojnë të drejtën apo titullin por pretendimet i drejtohen përmbaruesit gjyqësor në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të tij.

26. Përveç faktit që nuk përfshihen në grupin e çështjeve që parashikohen në nenet 45 dhe 56, të ligjit nr. 49/2012, jam i mendimit që vlera e kërimit në gjykimet për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore jo në çdo rast përputhet me vlerën e së drejtës që përfaqëson titulli ekzekutiv. Është e vërtetë që përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat ekzekutive me qëllim nxjerrjen e kredisë së kreditorit që përfaqëson vlerën e titullit ekzekutiv, por vjelja e detyrueshme e kësaj kredie mund të kalojë përmes veprimeve përmbarimore nga më të ndryshmet, të cilat në rrethana të caktuara nuk mund të konsiderohen si të një rëndësie të vogël.

27. Në KPC janë parashikuar veprimet që kryen përmbaruesi në lidhje me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, të cilat, për të përmendur vetëm disa prej tyre, fillojnë me lajmërimin për ekzekutim vullnetar, kalimin në ekzekutim të detyrueshëm, vendosjen e sekuestrove konservative dhe ekzekutive, vlerësimin apo edhe shitjen në ankand. Në ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, përmbaruesi nuk mjaftohet vetëm në gjetjen e shumave monetare apo të një llogarie

bankare dhe ekzekutimin e titullit mbi këtë shumë monetare. Në funksion të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë që të realizojë një sërë veprimesh. Pavarësisht vlerës së titullit ekzekutiv, përmbaruesi mund të vendosë sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, pavarësisht vlerës së tyre, e cila në raste të caktuara mund ta tejkalojë disa herë vlerën e titullit ekzekutiv apo edhe kufirin monetar që kufizon të drejtën e ankimit, mund të vlerësojë sendin e sekuestruar, të kërkojë pjesëtimin dhe ta nxjerrë në shitje në ankand. Në këtë kuptim, kundërshtimi i veprimeve përmbarimore në lidhje me veprime që drejtohen ndaj sendeve që kanë vlerë më të lartë se kredia që kërkohet të vilet, e në disa raste edhe disa herë më e lartë se vlera kufi për të cilën ligji kufizon ankimin, nuk mund të konsiderohet më si një çështje me rëndësi të vogël, për të cilën mund të kufizohet e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë, sipas nenit 43 të Kushtetutës. Në ndryshim nga rasti kur gjykohet themeli i së drejtës apo vlefshmëria e titullit, ku është e qartë vlera në konfliktin, në kundërshtimin e veprimeve përmbarimore vlera në konflikt mund të kalojë vlerën e kufirit monetar, pavarësisht vlerës së titullit ekzekutiv.

28. Siç është argumentuar më lart, me qëllim që të justifikohet kufizimi i së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, duhet që ky kufizim, në funksion të parimit të proporcionalitetit, të argumentohet si një balancë e drejtë mes të mirës së përgjithshme që lidhet me miradministrimin e drejtësisë me kufizimin e së drejtës për akses në gjykatë. Duke iu referuar kundërshtimit të veprimeve përmbarimore dhe duke pasur në vëmendje natyrën e këtyre veprimeve, të drejtat që mund të cenohen, vlerësoj që kufizimi i së drejtës së ankimit në këtë rast nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Jam i mendimit se në rastet kur objekt gjykimi janë vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, i drejtuar mbi sende që kanë një vlerë disa herë më të lartë se kufiri i parashikuar në ligj, balanca mes miradministrit të drejtësisë apo aksesit në gjykatë duhet të anojë nga kjo e fundit, sepse interesi i kërkuesit është më i lartë se kufiri monetar i parashikuar në ligj dhe nuk mund të konsiderohet më si një çështje me rëndësi të vogël.

II. Në lidhje me rekursin e palës paditëse

29. Ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën e Kolegjit për sa i përket disponimit në lidhje me



rekursin e palës paditëse. Për sa i përket kërimit për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, aktit nr. 32, datë 17.12.2014 të IKMT-së, të shndërruar në titull ekzekutiv, vlera e padisë është nën vlerën e parashikuar për rekurs sipas nenit 56 të ligjit nr. 49/2012, prandaj ndaj vendimit nuk mund të paraqitet rekurs. Ndërsa për sa u përket kërtimeve në lidhje me kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, pala paditëse nuk ka ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012, prandaj, në zbatim të neneve 62/a dhe 63, pag. 1/a dhe pag. 2, duhet vendosur mospranimi i rekursit.

Gjyqtar: Gentian Medja

VENDIM

Nr. 227, datë 28.10.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIA POWER CORE” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13, dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/12 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albania Power Core’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Albania Power Core” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 19.7.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 40.56 mw dhe veprave ndihmëse, në fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 31.7.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.8.2024 dhe 2.8.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.8.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1662/4 prot., datë 6.8.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie, ndërsa me shkresën me nr. 1662/3 prot., datë 6.8.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht prej saj.

- Në përgjigje, me shkresat me nr. 1662/5 prot., datë 15.8.2024 dhe nr. 1662/7 prot., datë 11.9.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 201, datë 27.9.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Albania Power Core” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim që shoqëria të sqarojë dhe të depozitojë në ERE dokumentacionin e konsideruar të munguar.

- Me shkresën me nr. 1662/9 prot., datë 4.10.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimmarrjen e bordit për zgjatjen e afatit dhe sa mbetet ende pa plotësuar dhe shoqëria me shkresën nr. 1662/10 prot., datë 14.10.2024, ka depozituar dokumentacionin plotësues për aplikimin.

- Pas analizimit të aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, rezultoi se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Albanian Power Core” sh.p.k.:



- Ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 1215 rep., nr. 1045 kol., datë 3.5.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 40.56 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Albania Power Core” shpk”.

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. marrëveshjen nr. 2560/8 prot., datë 3.7.2024, për lidhjen e centralit fotovoltaike me rrjetin e transmetimit. Referuar marrëveshjes për lidhjen e centralit fotovoltaike me rrjetin e transmetimit të depozituar në ERE, lidhja e parkut fotovoltaike do të bëhet për një fuqi të instaluar 40.56 mw, ndërsa në kontratën e nënshkruar me Autoritetin Kontraktor është përcaktuar kapaciteti prodhues 40.56 mw, për këtë arsye vlerësojmë që shoqëria të risjellë Marrëveshjen e lidhjes me OST-në me kapacitetin prodhues 40.56 mw, sikurse ka nënshkruar Kontratën me Autoritetin Kontraktor.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprahe, lëshuar më datë 7.12.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i parkut fotovoltaike Sheq Marinas”, për fuqinë 40.56 mw.

Rezulton se shoqëria disponon aktualisht një VNM të vlefshme, ndërsa për sa i përket fillimit të punimeve, ajo ka bërë me dije se është në proces për t’u pajisur me lejen e ndërtimit. Në të tilla rrethana, vlerësohet që t’i lihet kusht që të dokumentojë fillimin e punimeve jo më vonë se data 7.12.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale). Në rast se shoqëria nuk dokumenton fillimin e punimeve brenda kësaj date, ajo duhet të depozitojë në ERE një VNM të re.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit, shoqëria në dokumentacionin teknik/garanci të paneleve (pjesë përbërëse e planit të biznesit) citon se këto panele kanë jetëgjatësi të pritshme deri në 30 vjet, por nga

ana tjetër në këtë plan rezulton se vitet e parashikuara për gjenerimin e energjisë elektrike janë 25 vjet, ndaj në këto rrethana dhe afati i licencës do të jetë në përputhje me parashikimet e planit të biznesit, pra për 25 vjet.

- Shoqëria parashikon që të vendosë në punë centralin përpara afatit maksimal (27.3.2027) të përcaktuar në VKM-në nr. 180, datë 27.3.2024, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Albania Power Core” dhe kontratën nr. 1215 rep., nr. 1045 kol., datë 3.5.2024, të nënshkruar me MIE-n dhe të fillojë operimin në datën 14.6.2026. Vlerësohet që shoqëria të fillojë operimin jo më vonë se afati i fundit i përcaktuar nga aktet e mësipërme, pra brenda datës 27.3.2027.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albania Power Core” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 40.56 mw, në fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike jo më vonë se data 27.3.2027.

3. Shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaike brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprahe (brenda datës 7.12.2024), ose duhet të depozitojë në ERE një VNM paraprahe të re në rast të mos fillimit të punimeve brenda datës 7.12.2024.

4. Para vënies në operim të risjellë Marrëveshjen e lidhjes me OST-në me atë kapacitet prodhues sipas Kontratës së nënshkruar me Autoritetin Kontraktor.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kuadër të pikave 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Albania Power Core” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të



Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 228, datë 28.10.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “SLR
ALBANIA” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2152/1 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘LR Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “SLR Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2152 prot., datë 16.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gerrat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, germën “c”; për pikën 2.1, gerrat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “SLR Albania” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 114 rep., nr. 73 kol., datë 31.1.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqërisë ‘SLR Albania’ sh.p.k.”.

- Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nr. 5972/3 prot., datë 27.7.2022.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprahe, lëshuar më datë 28.7.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit fotovoltaike 2 mw, Topojë, Fier”, për shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k. Kjo VNM ka qenë e vlefshme deri më datë 28.7.2024, ndaj shoqëria duhet të dokumentojë që ka filluar punimet e ndërtimit të centralit fotovoltaike brenda kësaj date, ose duhet të depozitojë një VNM të re.

- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa “b”:** aplikuesi duhet të depozitojë të përditësuar vërtetimin për gjendjen gjyqësore për shoqërinë, i cili është lëshuar më datë 16.10.2024, më herët se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit të shoqërisë në ERE dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, pikës 3 të rregullores, vlerësohet që t’i kërkohej shoqërisë që të depozitojë vërtetimin për gjendjen gjyqësore për shoqërinë të përditësuar.

- **germa “c”:** struktura organizative duhet të depozitohet e nënshkruar dhe/ose vulosur.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal



- **germa “a”**: aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shëndetësore, ndaj për plotësimin e kërkesave të kësaj pike të rregullores, subjekti duhet të depozitojë në ERE veçmas vërtetimin që nuk ka asnjë detyrim në lidhje shlyerjen e këtyre detyrimeve ose periudhën që i korrespondojnë detyrimet sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- **germa “b”**: aplikuesi duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë për vënien në dispozicion të fondeve të saja për realizimin e projektit. Shoqëria ka dokumentuar se do ta financojë projektin përkatësisht në vlerën 80% me kredi bankare dhe 20% me fonde të veta, si dhe ka dokumentuar vlerën përkatëse për realizimin e vlerës totale të projektit, por në lidhje me financimin nga fondet e veta, ka depozituar vetëm konfirmimin e llogarisë, për këtë arsye kërkohet që shoqëria të depozitojë dhe vendimin e organeve drejtuese të saj për dedikimin e vlerës monetare të saj të vënë në dispozicion të zhvillimit të projektit.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- **germa “a”**: aplikuesi duhet të bëjë saktësimin e njërive gjeneruese, pasi rezulton se kapaciteti total tejkalon kapacitetin e përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe lejet që ka marrë shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SLR Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund

ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 229, datë 28.10.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE
2” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU
FOTOVOLTAIK “BLUE 2”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2144/1 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2144 prot., datë 16.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”, me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 50 mw.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe



afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gerrat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germen “c”; për pikën 2.1 gerrat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 9.7.2021, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike ‘Blue 2’ me kapacitet të instaluar 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. “*Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaike Blue 2*”, me nr. 2391 prot., datë 13.4.2022.

- Është pajisur me VNM paraprake (transferim vendimi nga AN051220200007 – “Blessed Investment” sh.p.k. në AN160720210002 – “SVP Blue 2” sh.p.k.), lëshuar më 3.2.2021 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “*Parku Fotovoltaike Blue 2*”, për shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. Kjo VNM ka qenë e vlefshme deri më datë 3.2.2023, ndaj shoqëria duhet të dokumentojë që ka filluar punimet brenda datës 3.2.2023, ose të depozitojë një VNM të re.

- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa “a”**: aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **germa “b”**: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vendimet e organeve drejtuese të ortakëve të saj, ku të përcaktohet vënia në dispozicion e fondeve për realizimin e projektit të parkut fotovoltaike “Blue 2”.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1

- **germa “a”**: aplikuesi duhet të bëjë plotësimet përkatëse në lidhje me numrin e njërive gjeneruese dhe kapacitetin e secilës, vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaike “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 230, datë 28.10.2024

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STAVEC”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit



Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1765/23 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Koka & Ergi Energy Stavec’ sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC ‘Stavec’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1765 prot., datë 15.8.2024 dhe nr. 1765/1 prot., datë 19.8.2024, paraqiti kërkesën dhe dokumentacion për modifikimin e kësaj licence për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Stavec”, nga 6,520 mw në 8,46 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 29.8.2024, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e kësaj licence, për rritjen e kapacitetit të instaluar të këtij HEC-i nga 6,520 mw në 8,44 mw, duke iu referuar kapacitetit të instaluar që rezulton në Raportin e Oponencës Teknike të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 31.8.2024 dhe 2.9.2024). Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjithashtu, ERE ka njoftuar MIE-n për fillimin e kësaj procedure me shkresën nr. 1878 prot., datë 6.9.2024.

- ERE ka njoftuar shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. për vendimin e Bordit nr. 173/2024 prot., nëpërmjet shkresës nr. 1765/4 prot., datë 29.8.2024, duke evidentuar dhe dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Po ashtu, ERE i është drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) me shkresën nr. 1765/5 prot., datë 6.9.2024; Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) me shkresën nr. 1765/6 prot., datë 6.9.2024, si dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. me shkresën nr. 1765/7 prot., datë 6.9.2024.

- Pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit shtesë të depozituar nga shoqëria dhe shkresave të AMBU-së dhe AKM-së është vlerësuar e nevojshme për këtë procedurë marrja e një përgjigjeje/qëndrimi të mundshëm nga MIE dhe OSSH sh.a., si dhe për të zhvilluar korrespondencën

vijuese me shoqërinë për sa përcaktuar në shkresat e AKM-së dhe AMBU-së, në mënyrë që në vendimin përfundimtar të Bordit të ERE-s të përfshihet dhe informacioni/ dokumentacioni i përditësuar nga shoqëria.

- Me vendimin e Bordit nr. 204, datë 27.9.2024, u vendos zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë e afatit e vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Stavec”.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1765/20 prot., datë 4.10.2024, duke i evidentuar dhe çfarë dokumentacioni mbetet pa u plotësuar nga ky aplikim.

- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/21 prot., datë 11.10.2024 e po ashtu ka kthyer përgjigje dhe OSSH sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/22 prot., datë 14.10.2024.

- Pas analizimit të aplikimit dhe të gjithë korrespondencës së zhvilluar në lidhje me këtë procedurë, në referencë të përcaktimeve të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, rezulton se nuk është depozituar ende:

- *Miratimi/qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë* (në lidhje me miratimin e raportit të oponencës teknike të AKBN-së për projektin e zbatimit të ndryshuar të HEC “Stavec” apo kontrata shtesë e koncesionit ku të reflektohen ndryshimet përkatëse);

- *Miratimi/qëndrimi Agjencisë Kombëtare të Mjedisit* për projektin e ri të zbatimit të HEC “Stavec”;

- *Leja e re e përdorimit të burimit ujor* (për të cilën shoqëria ka bërë aplikimin përkatës në datën 25.9.2024)

- *Qëndrimi/miratimi i operatorit të rrjetit* për kërkesën e bërë nga shoqëria për shtimin e kapacitetit të instaluar të HEC “Stavec” në 8.44 mw.

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *nëse organi publik që zhvillon procedurën përballat me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”),*



organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se marrja e vendimeve/qëndrimeve të organeve kompetente si më sipër, është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga ERE, vlerësohet që të pezullohet për 110 (njëqind e dhjetë) ditë vendimmarrja e Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin e lejes për përdorimin e burimit ujqor, për të cilën shoqëria ka aplikuar më datë 25.9.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë për 110 (njëqind e dhjetë) ditë vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec”,

2. Brenda 110 ditëve aplikuesi të depozitojë në ERE, lejen e përdorimit të burimit ujqor. Miratimin/qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Miratimin/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe Qëndrimin/miratimin e operatorit të rrjetit në lidhje me projektin e ri të zbatimit të HEC “Stavec”.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 247, datë 18.11.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË SHOQËRISË OST SHA PËR PERIU DHËN RREGULLATORE 2025–2027

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “e”, dhe 60, pika 5, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 6, 7, 8, 10 dhe 11, të “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 135, datë 6.9.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2098/4 prot., datë 15.11.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit të investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025–2027”,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me shkresën nr. 6943 prot., datë 10.10.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2098 prot., datë 11.10.2024), ka dorëzuar “Planin e investimeve për periudhën rregullatore 2025–2027”, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

- OST sh.a. deklaroi se, në përgatitjen e planit të investimeve për periudhën rregullatore 2025–2027, ka respektuar kërkesat e rregullores së ENTSO-E, siç evidentohet në dokumentacionin e dorëzuar. Gjithashtu, thekson se programi 10-vjeçar i zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 2015–2025, i miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 212, datë 28.12.2017, i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 228, datë 20.12.2019 dhe me vendimin nr. 125, datë 17.5.2021, mbetet ende në zbatim, me pjesën më të madhe të investimeve të finalizuara dhe disa projekte ende në proces realizimi.

- OST sh.a. ka përcjellë komunikimet lidhur me OSSH sh.a. sa i takon koordinimit të projekteve që janë në kufirin e pronësisë mes dy operatorëve.



- OST sh.a. nuk ka paraqitur të dhëna konkrete apo analiza të detajuara mbi efektivitetin dhe koston e ulët të investimeve, por ka ofruar deklarime të përgjithshme për projektet. Aktivitetet e saj janë të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe përfshijnë kryesisht garantimin e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, duke vlerësuar kriteret e sigurisë, eficiencës dhe reduktimit të humbjeve në sistemin e transmetimit.

- Nga dokumentacioni i dorëzuar nga OST sh.a., nuk janë dhënë sqarime apo prova mbështetëse që tregojnë lidhjen e drejtpërdrejtë të zërave specifike me çështjet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik.

- Në mbështetje të nenit 6, germa “P” të “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, OST sh.a. është e detyruar të publikojë planin e investimeve në faqen e saj zyrtare dhe të kryejë konsultime me palët e interesuara dhe institucionet përkatëse. Deri në marrjen e këtij vendimi, nuk ka të dhëna që OST sh.a. ka publikuar planin për periudhën rregullatore të ardhshme ose që ka realizuar këto konsultime. Për të përmbushur kërkesat e rregullores, OST sh.a. do të duhet të paraqesë informacion mbi publikimin e planit dhe procesin e konsultimit të ndjekur.

- Në nenin 8 të Rregullores së sipër cituar, përcaktohen kërkesat që OST sh.a. duhet të plotësojë lidhur me planin e investimeve. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni theksojnë rëndësinë e përputhshmërisë së planit të investimeve me planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit. Plani 10-vjeçar aktual është ai i miratuar për periudhën 2015–2025, me vendimin nr. 212, datë 28.12.2017, të Bordit të ERE-s. Meqë periudha rregullatore 2025–2027 kalon përtej kësaj periudhe 10-vjeçare, bazat krahasuese të planit të ri të paraqitur nuk përputhen me planin 10-vjeçar aktual, duke krijuar një boshllëk në vlerësimin e përputhshmërisë.

- Në dokumentin e paraqitur të planit të investimeve, OST sh.a. ka marrë në konsideratë përmirësimin e treguesve teknikë sipas specifikave të secilit projekt. Sa i takon uljes së humbjeve, OST sh.a. thekson se plani i investimeve përfshin përgjithësisht sigurimin e energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe për rezervën e energjisë dhe

shërbimet ndihmëse të nevojshme për operimin e sigurt të sistemit. Ky proces bazohet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe koston minimale, duke përfshirë realizimin e analizave periodike për sasinë dhe koston e humbjeve, si dhe hartimin dhe zbatimin e masave për reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë.

- Lidhur me analizat kosto përfitim, OST sh.a. ka paraqitur vetëm në formë deklarative përfitimet për projektet/zërat përkatëse pa shoqëruar me një analizë kosto-përfitim e cila justifikon efektivitetin e projekteve të cilat pritet të realizohen në periudhën e ardhshme rregullatore 2025–2027. Sa i takon implementimit të detajuar të planit/skedulit të kryerjes së investimeve shoqëria ka ndarë në formë tabelare kohën e komisionimit dhe futjes në operim por nga ana tjetër nuk ka përcjellë studime fizibiliteti, studimet e impaktit në mjedis apo të drejtat pronësore dhe të shfrytëzimit.

- Duke marrë parasysh rëndësinë e procesit të shqyrtimit të planit të investimeve dhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur deri më tani, vlerësohet se janë përmbushur kushtet minimale për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OST sh.a., për periudhën rregullatore 2025–2027.

2. Shoqëria OST sh.a. duhet të depozitojë në ERE, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi, dokumentacionin e plotë sipas kërkesave të përcaktuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike,” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 6.9.2017.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesit për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime



materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 248, datë 18.11.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “MOUNTAIN’S GREEN
ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2346/1 prot., datë 14.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Mountain’s Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2346 prot., datë 5.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau Dejës, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 1975 kW.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,

rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.1, germat “b”, “c”, “d” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.:

- Me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 3222/2 prot., datë 26.7.2021, ka marrë miratimin për transferimin e të drejtës për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike me kapacitet prodhues 1975 kW, në zonën Gomsiqe, Vau i Dejës, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Miratimin Përfundimtar nr. 400913 prot., datë 4.10.2017 dhe kontratave të nënshkruara me MIE, nga shoqëria “IN FOOD” sh.p.k. tek shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.

- Ka depozituar në ERE shkresën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. “Miratim pikë lidhje Central Fotovoltai” me nr. 7247/3 prot., datë 3.8.2024, drejtuar shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., në të cilën përcaktohet se referuar kërkesës së shoqërisë, për transferim të së drejtës për ndërtim dhe ndryshim të emërimit në miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltai me adresë në Gomsiqe, Vau i Dejës, me kapacitet 1975 kW, miratohet lidhja e këtij centrali në rrjetin e shpërndarjes.

- Ka depozituar një VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në datën 7.9.2017, për personin juridik “IN FOOD” sh.p.k. për të zhvilluar projektin: “Central diellor fotovoltai”, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau i Dejës, qarku Shkodër. Në këtë dokument nuk është përcaktuar një afat kohor për vlefshmërinë e kësaj VNM-je, por në pikën 3.2. përcaktohet se: *ky vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratimin nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti*, ndërsa në pikën 3.4 përcaktohet se: *ky vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bëjë ndryshimin e statutit të tokës nga tokë arë në tokë truall sipas akteve ligjore në fuqi*.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:



NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **germa “a”**: shoqëria duhet të bëjë saktësimin e njësisë gjeneruese dhe kapacitetin e secilës prej tyre, duke mbajtur në konsideratë kapacitetin total të centralit të miratuar në kontratën me MIE-n.

- **germa “e”**: shoqëria duhet të dokumentojë në ERE për plotësimin e kushtit të VNM-së paraprake, për ndërrimin e statusit të tokës nga tokë arë në tokë truall. Po ashtu, vlerësohet që shoqëria të bëjë me dije si është vepruar nga ana e saj me zbatimin e afateve të vendosura nga MIE në lidhje me ndërtimin dhe vënien në operim të centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 1 975 kW, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau Dejës, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 6492, datë 22.10.2024, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Deda, me atësi Ali dhe me amësi Aishe, i datëlindjes 13.3.1981, duke përcaktuar si datë zhdukjeje datën 1.1.2020.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 320 lekë